



Rruga e Arbërit

www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (100). GUSHT 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



AKTUALITET

Rajoni ka nevojë për një plan zhvillimi

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 7

BOTIME

Meditime që na japin mësim të gjithëve

Nga **PROF.DR. HAJRI SHEHU** - FAQE 17

INTERVISTË

Toska: Talentet shfaqen në fusha, jo në salla interneti

Nga **SASHENKA NDREKA** - FAQE 9

BLOGGER

- Ç'kemi asaj Dibre!
- Miqtë e Facebook-ut
- Krijohet Lëvizja Qytetare Dibranë

FAQE 12,13

Shenim

100!

Ky është numri i 100-të i gazetës. Muaj pas muaji kemi ardhur midis jush, duke sjellë në vatrë tuaja sadopak aromë Dibre. Jemi përpjekur të sjellim nga Dibra më të mirën e mundshme nga kultura, arti, historia, por edhe nga problematika e përditshme që ndeshemi.

Disa çështje jetike për komunitetin jo vetëm në Dibër, por kudo ku ndodhen dibranët, jemi përpjekur t'i mbajmë të hapura dhe t'i pasurojmë vazhdimisht me lajme dhe informacione.

Rruga e Arbërit, minierat e Bulqizës, devijimi i ujërave të Radikës, ndërtimi i hidrocentraleve të Skavicës apo tani së fundi edhe i Valikardhës, mbrojtja e pyjeve, zhvillimi i turizmit, etj., janë disa çështjet që kanë gjetur vazhdimisht hapësirë në gazetë, duke u trajtuar me seriozitet dhe vërtetësi.

Ne jemi te numri i 100, pasi kemi pasur mbështetjen e lexuesve dhe bashkëpunëtorëve. Janë me qindra ata që kanë shkruar në gazetë, duke kontribuar me shkrime origjinale dhe serioze, që i kanë dhënë asaj një natyrë studimore, shkencore, ku botohen vlera.

Deri këtu kemi arritur edhe falë mbështetjes së financuesve të saj, të cilët, çdo muaj, vazhdimisht, kanë hequr nga buxhetet e tyre të biznesit apo të familjes për të mbështetur një media të lirë.

Gjatë punës sonë jemi përpjekur maksimalisht të respektojmë çdo kontribut, sado i vogël të jetë, duke respektuar të drejtën e autorit. Ne kemi ardhur falas në vatrë tuaj, duke e bërë gazetën muaj pas muaji, një mik të familjes suaj.

Të gjitha këto kanë ardhur deri këtu falë sakrificave të bashkëpunëtorëve dhe financuesve, të kontributorëve dhe lexuesve.

Ndaj kemi vendosur, që duke filluar nga numri i ardhshëm, ne do të shkojmë vetëm te lexuesit që pajtohen. Sepse kështu do të jemi më afër lexuesve, sepse mendojmë se kështu respektojmë lexuesin serioz, që e kupton se përgatitja dhe botimi i gazetës, veçse punë e mundim i madh intelektual, është edhe shpenzim material për të cilin duhet paguar, që gazetën ta ketë në dorë lexuesi. Të gjithë ata që na ndjekin çdo muaj, që kanë paguar për të pasur gazetën, i kemi konsideruar dhe do të vazhdojmë t'i konsiderojmë kontribues të përpjekjes sonë për vazhdimësinë e botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", duke marrë përsipër gjithashtu që të përcjellim më së shumti shqetësimet e tyre.

Redaksia po harton një platformë të re, duke sjellë për lexuesit shkrime ekskluzive, serioze, trajtime të çështjeve në mënyrë të pavarur dhe të saktë, rubrika nga personalitete dhe studiues të letërsisë e kulturës, që do ta bëjnë gazetën më të mirë, numër pas numri.

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë! Kontribuo edhe ti për lirinë e saj! Vetëm me një pajtim!

VALIKARDHA, FSHATI I TRAZUAR NGA NDËRTIMI I NJË HIDROCENTRALI

Liqeni i Zi "nxin" mbi të ardhmen e Zerqanit!



SPECIALE / Pse banorët e Zerqanit kundërshtojnë ndërtimin e Hidrocentralit të Valikardhës? A rrezikohet Liqeni i Zi dhe a do jetë funksional Liqeni Artificial i Fushës së Zogut? Çfarë thonë banorët dhe çfarë shkruajnë dokumentet zyrtare? A janë reale të dhënat e viteve 1976-1979 për sasinë e ujit me sasinë reale në terren? Çfarë e pengon komunën, firmën ndërtuese, Ministrinë e Energjetikës, Mjedisit dhe Bujqësisë të bëjnë transparencën? Kush i nxit protestat dhe kush pengon transparencën? Çfarë ruan policia private dhe pse po priten pyjet? A kërkohet për krom apo po hapen kanale që do të sjellin ujë në Liqenin e Zi? Nga lajmet e pavërteta për djegien e hidrocentralit, te falsifikimet mbi sasinë e ujit. Nga protestat - te peticioni, nga korrespondencat zyrtare - te përpjekja për të fshehur të vërtetën, një histori konspirative mes banorëve - firmës ndërtuese - institucioneve qeveritare dhe komunës që komunikojnë për të njëjtën gjë, përdorin të njëjtat shifra, por dalin me konkluzione të ndryshme. E vërteta e kësaj historie shihet vetëm në terren, aty ku pyjet po priten dhe digjen, Liqeni i Zi po thahet dhe Liqeni i Fushës së Zogut i mban sytë nga qielli në pritje të reshjeve pa pushim!

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 2,3,5

Reportazh / Ndal devijimit te lumit Radika!

Në Fushë të Lukovës, atje ku po projektohet tharja e Radikës

Aksion sensibilizues në Dibër të Madhe: "Për të shpëtuar një jetë – dhuroj gjak, e mbrojmë Radikën për të shpëtuar shumë jetë"

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 4-5



Pse banorët e Zerqanit kundërshtojnë ndërtimin e Hidrocentralit të Valikardhës? A rrezikohet Liqeni i Zi dhe a do jetë funksional Liqeni Artificial i Fushës së Zogut? Çfarë thonë banorët dhe çfarë shkruajnë dokumentet zyrtare? Nga lajmet e pavërteta për djegien e hidrocentralit, të falsifikimet mbi sasinë e ujit. A janë reale të dhënat e viteve 1976-1979 për sasinë e ujit me sasinë reale në terren? Çfarë e pengon komunën, firmën ndërtuese, ministrinë e Energjetikës, Mjedisit dhe Bujqësisë të bëjnë transparencën? Çfarë ruan policia private dhe pse po priten pyjet? A kërkohet për krom apo po hapen kanale që do sjellin ujë në Liqenin e Zi? Një histori konspirative mes banorëve-firmës ndërtuese- institucioneve qeveritare dhe komunës që komunikojnë për të njëjtën gjë, përdorin të njëjtat shifra por dalin me konkluzione të ndryshme. E vërteta e kësaj historia shihet vetëm në terren, aty ku pyjet po priten dhe digjen, Liqeni i Zi po thahet dhe Liqeni i Fushës së Zogut i mban sytë nga qielli në pritje të reshjeve papushim!



Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (100). 1 - 31 Gusht 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Njoftojmë zotërinjtë: F.Gjabri, R.Gjini, A.Keta, F.Xhani, S.Mëziu, R. Ajazi, H.Përnezha, M.Buci, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:

Hysen LIKDISHA
Laurant BICA
Hajri SHEHU
Sejdi M.GASHI
Sashenka NDREKA
Xhafer MARTINI
Dedë Llesh DOÇI
Faik XHANI
Dukagjin HATA
Hysen REPA
Mentor HOXHA
Ilmi DERVISHI
Beqir SINA
Mevlud BUCI

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearbërit.com**.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. Ilog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearbërit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohej riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Të shkosh në Valikardhë, një fshat në Zerqan, pranë rrugës së Arbërit, është shumë thjesht. Rruga është e asfaltuar, por në kafënë e parë të fshatit ndeshesh me trazimin që po përjetojnë për më shumë se 6 muaj rreth 1000 banorët e këtij fshati.

Kafja është në pronësinë e Sabah Hoxhës, 37 vjeç, i kthyer nga emigracioni rreth tre vite më parë. Ai është njëri nga aktivistët kundër hidrocentralit dhe shpesh njerëzit takohen aty për të biseduar mbi problemin që u ka rënë dhe lajmet e reja që qarkullojnë. Makinat që kalojnë aty ndalojnë pak dhe pyesin Sabahin: “Ka ndonjë të re?” Dhe pastaj zhduken rrugës gjarpëruese drejt zemrës së Zerqanit, një ndër qendrat historike të Dibrës. Ndërsa te kafja vazhdojnë bisedat, herë me zë të ulët e herë me zë të lartë, por në të shumtën e herëve me teori konspirative për hidrocentralin që po ndërtohet pak metra më tutje dhe që ka ngjallur pasiguri mbi të ardhmen e jetës në këtë fshat.

Sipas një tablele të vendosur në rrugë, por që era e ka kthyer mbrapsht, thuhet se aty do të ndërtohet hidrocentrali “Tërnova Hidropower 03”, me investitor “Teodori 2003” dhe bankat Societe General Group dhe EBRD (Berzh). Ndërtimin e saj do ta realizojë firma “Alb American CS” dhe fillimi i punimeve daton më 30 prill 2011 dhe mbarimi duhej të ishte më 30 maj 2013. Investimi për këtë vepër energjetike është 18 milionë e 500 mijë euro.

Sabahi ka marrë një eksperiencë nga emigracioni, ku banorët nuk janë indiferentë ndaj investimeve në fshatrat e tyre. “Pyetëm në fillim se çfarë po bëhej, por nuk dinte askush asgjë. Më vonë pamë se po bëheshin punime në pyje, po hapeshin rrugë drejt Liqenit të Zi si dhe po bëheshin punime për të mbledhur rrjedhat ujore”, - thotë Sabahi.

“Ne mendojmë se nuk ka ujë edhe për hidrocentralin, edhe për vaditjen, - thotë Pëllumb Toska, ish agronom. Në qoftë se mblidhen ujërat dhe do të futen në tubacione, atëherë rrezikohen burimet ujore të zonës që shërbejnë jo vetëm për vaditje, por edhe për ujë të pijshëm”.

Muharrem Gjoka është më i zemëruari nga banorët. Ai, së bashku me fëmijët e tij, ka qenë i arrestuar nga policia gjatë protestave kundër hidrocentralit. Ai e ka marrë vesh për herë të parë që do të ndërtohet një hidrocentral rreth vitit 2008. “Një vit pasi kanë filluar punimet është marrë vendimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit dhe nuk përmendet asnjëherë ‘Liqeni i Zi’”, - thotë Muharremi.

“Firma nuk na ka mbledhur ndonjëherë dhe të na shpjegojë se çfarë po bën ajo në tokat tona, në pyjet tona, me ujërat tona, - thotë Muharremi. Ajo ka ardhur në fshat si uzurpatore”.

Banorët mendojnë se ideja fillestare ka qenë për ndërtimin e hidrocentralit të Tërnovës, por më vonë e kanë ndryshuar me hidrocentralin e Tërnovë-Valikardhës.

“Në vitin 2011 kanë filluar punimet për hidrocentralin, - thotë Gëzim Hoxha, që ka punuar për disa muaj në ndërtimin e digës në Fushën e Zogut. Në atë kohë flitej për digën e Fushës së Zogut, punimet e së cilës patën filluar në vitet 2008-2009, dhe më pas vazhdimin e punimeve i mori firma “Teodori”. Ndërtimi i digës vazhdoi 2 vjet dhe gjatë kësaj kohe nuk e dinim se për çfarë bëhej liqeni artificial. Unë kam punuar 6-7 muaj në fillim dhe më pas e lashë punën. Atëherë flitej se do të ndërtohej një tunel 24 km që do të merrte ujë nga Liqenet e Martaneshit dhe do t’i sillte në Liqenin e Zi.”

Pas protestave të para në fillim të vitit, banorët thonë se ka qenë në një takim me ta, dikush që u prezantua si Drejtori i Përgjithshëm i Konkencioneve. Ai hapi hartën dhe filloi të na shpjegojë liqenet. Aty ne vëmë re, se Liqeni i Fushës së Zogut, ku është ndërtuar diga, figuronte i mbushur me ujë. “Ne i thamë atij se ky liqen nuk ka ujë, ndaj harta juaj nuk është e saktë”, - thotë një banor.

“Ata nuk vuajnë për dokumentacion, por dokumentacioni i tyre nuk tregon realitetin, - thotë Sabah Hoxha. Ky dokumentacion është një piramidë dhe kjo piramidë tani kërkohet t’u vihet në kurriz banorëve”.

“Ne kërkojmë me çdo kusht që të mos ndërhyhet aspak në Liqenin e Zi, pasi ajo është një rregullator i gjithë ujërave të zonës, që mbulon një sipërfaqe prej 600 ha”, - thotë Ylli Hoxha. Ai ka punuar për 25 vjet si gjeolog dhe e njeh



Pamje nga Liqeni i Zi. Gusht 2014. Foto: © B.Karoshi

mirë zonën dhe strukturën gjeologjike të saj.

Banorët nuk kanë asnjë informacion mbi atë se çfarë do të ndodhë me mjedisin rreth tyre. Ata kanë frikë se firma premtan se nuk do të prekë rezervat ujore, por ata mendojnë se qëllimisht hidhen dherat që nxirren nga galeria për të mbushur me inerte dhe për të rritur nivelin.

Një përfaqësues i firmës ndërtuese u ka thënë banorëve se për sa i përket transparencës mjedisore një gjë të tillë duhej ta bënte kryetari i komunës, pasi ai e ka marrë përsipër këtë zë. Banorët mendojnë se rreth 600 mijë euro i janë dhënë komunës për shpronësime dhe dëmshpërblim për dëmtimet në mjedis, ndërsa asnjë familje nuk është kompensuar.

Mbi 10 protesta janë organizuar deri më tani dhe me gjithë bërjen e problemit publik, duket se zgjidhja nuk është e afërt dhe as e kënaqshme për të gjitha palët.

Për një nga protestat e fundit, Televizioni “News 24” transmetoi një lajm se është djegur hidrocentrali, por kjo nuk është e vërtetë, - thonë banorët. Gazetari nuk ka qenë fare në vendngjarje dhe lajmet i ka marrë nëpërmjet telefonit, siç u ka thënë me vonë banorëve. Po kush ia dha lajmin e rremë të djegies? Disa banorë po mendojnë se firma ndërtuese po përdor një pjesë të protestuesve për të nxitur shkatërrime dhe pasiguri, që më pas të marrë dëmshpërblime për ndalimin e punës.

Ylli Hoxha ka takuar Ministrin Damian Gjiknuri gjatë një takimi të këtij të fundit në Bulqizë. “Pse, ju qenkeni ata që i keni vënë zjarrin hidrocentralit”, - citojnë t’u ketë thënë ministri atyre. Ne ia shprehëm shqetësimin tonë ministrit, - thotë Ylli. Ne duam që zyrtarët dhe qeveritarët të vijnë në terren dhe të verifikojnë dokumentacionin që ata kanë në zyra dhe që është përdorur për të marrë lejen e ndërtimit, me atë çka në të vërtetë është në terren. Ne nuk na pranohet realiteti i thjeshtë dhe i qartë: ku është uji që do të vaditë tokat tona dhe ku është uji që do të përdoret për hidrocentralin?

Muharrem Gjoka e shpreh hapur zhgënjimin nga Ministria e Energjisë, pasi ajo e shpreh hapur mbështetjen ndaj firmës, por nuk merr parasysh asnjë interes të banorëve.

PSE REAGJOMË TANI?

“Ne nuk dinim se çfarë po ndërtohej, - thotë Sabah Hoxha. Nuk kemi pasur asnjë informacion apo tentativë për transparencë nga askush, as nga pushteti lokal, as nga institucionet përgjegjëse në Ministrinë e Ekonomisë, Energjetikës apo Mjedisit. Ne filluam të shqetësohemi vetëm kur pamë punimet që po drejtoheshin drejt Liqenit të Zi. Firma ka bërë punime në Fushën e Zogut, atë rezervuar ta gëzojë bashkë me ujin që do të mbledhë. Liqenin e Zi nuk lejojmë ta prekin”. “Ka shumë njerëz që na thonë të njëjtën gjë:

Pse nuk keni kërkuar të informoheni më parë, kur sot mundësitë e informacionit janë të mëdha”, - thotë Ylli. Ne si banorë nuk kishim asnjë sinjal për këtë që po ndodhte. Mos harrojmë se në fillim është folur për hidrocentralin e Tërnovës, jo për të Valikardhës, dhe Tërnova është në anën tjetër të malit dhe ne nuk dimë se si është situata andej. Kur filluam të kërkojmë informacion, atëherë kuptuam se diçka fshihej, pasi edhe sot e kësaj dite ne nuk na thuhet e vërteta e thjeshtë: Ku është uji për tokat tona dhe ku është uji për hidrocentralin?”

PETICIONI PËR KRYEMINISTRIN: PRESIM ZGJIDHJE!

Në shkurt të këtij viti, rreth 150 banorë të Valikardhës kanë nisur një peticion kryeministrit Edi Rama dhe për dijeni ministrave Gjicknuri, Koka, Panariti, Cani dhe Avokatit të Popullit, ku shprehnin shqetësimin për punimet që po bëhen për hidrocentralin, kërkojnë transparencë për dokumentacionin për këtë ndërtim si dhe zgjidhje të problemit të tyre.

“Ky liqe i bekuar nga Zoti, na ka mbajtur gjallë në shekuj, ...dhe tani vijnë dhe na e marrin, duke na lënë si “peshku në të thatë”. Ky liqe nuk ka kapacitet të mbulojë vaditjen, jo më të ketë ujë për hidrocentralin”, - thuhet mes të tjerash në peticionin drejtuar qeverisë.

“Firma ndërtuese po shkatërron pyjet dhe po kërkon për krom, duke dëmtuar kurorën e Liqenit të Zi, Liqenit të Bardhë dhe atij të Sopotit”. Ndërsa kur vjen puna që një banor i fshatit të bëjë dru për dimër për të ngrohur familjen, një postblllok policie nuk i lejon, me pretekstin se po e ruan; ndërsa policia pyjore është inekzistente.

Sipas tyre postblloku është vetëm një maskim që po mban larg syve të publikut atë që po ndodh me Liqenin e Zi dhe pyjet përreth.

Në peticion ata akuzojnë edhe kryetarin e komunës, Defrim Fiku, i cili ka dhënë me qira tokën ku po ndërtohet hidrocentrali, ndërkohë që edhe ish-reparti ushtarak është privatizuar duke përfshirur nga procesi pronarët e tokës. “Kryetari i komunës ka bllokuar të gjitha rrugët e luginës së lagjeve të poshtme të Valikardhës për të shkuar në kullotat e fshatit me bagëti, duke na izoluar si në kohën e diktaturës”, - thuhet në peticion, duke aluduar kështu për një aferë të pastër korruptive në kurriz të qytetarëve.

Nga ndërtimi i hidrocentralit preken mbi 1000 banorë dhe mbeten në rrezik të thatësirës mbi 300 hektarë tokë bujqësore.

Në fund të peticionit banorët kërkojnë ndalimin e punimeve, lirinë e rrugëve që të çojnë në kullota, takimin me ministrat e energjisë, mjedisit dhe bujqësisë me banorët, ballafaqim me kryetarin e komunës dhe të vihen para përgjegjësisë ata që projektuan dhe ndërtuan nëpërmjet abuzimit në ndërtimin e këtij hidrocentrali.

reportazh

VALIKARDHA, FSHATI I TRAZUAR NGA NDËRTIMI I NJË HIDROCENTRALI

Banorët: Në rrezik Liqeni i Zi dhe vaditja e tokave tona!

Të paktën një ministër, bashkë me burokratët e tij, duhet ta zhvillojnë takimin e radhës në mal, pranë Liqenit të Zi dhe Fushës së Zogut. Të verifikojnë rezervat ujore dhe në qoftë se ka ujë për të gjithë, të gjithë ta gëzojnë, por në qoftë se uji nuk është, atëherë ata që kanë firmosur dokumente joreale apo kanë marrë të dhëna para 30 vitesh dhe i kanë deklaruar si të sotme, të përgjigjen para ligjit.

Avokati i Popullit u ka kthyer një përgjigje më datë 20 shkurt 2014 dhe u rekomandon banorëve që të gjejnë një avokat privat për të mbrojtur çështjen e tyre, ndërkohë që institucioni, megjithëse është një institucion kushtetues që mbrojnë qytetarë nga veprimet e paligjshme, nuk e shqyrton rastin për të verifikuar se veprimet e deritanishme të institucioneve janë dhënë në kundërshtim me ligjin apo jo.

Pas kësaj përgjigje banorët u janë drejtuar edhe deputetëve të Dibrës, prej të cilëve kërkojnë të interesohen pranë institucioneve përgjegjëse dhe ta zgjidhin çështjen e tyre.

NGA VERIFIKIMI NË TERREN TE TAKIMI NË PREFEKTURË

Një përfaqësi e banorëve të Valikardhës prej 7 vetësh kanë zhvilluar më 6 mars 2014 një takim në Prefekturën e Dibrës dhe kanë shprehur shqetësimet e komunitetin në lidhje me rreziqet që u kanosen banorëve nga ndërtimi i hidrocentralit. Ata i kanë theksuar Prefektit se vendimet e këshillit komunal në vitet 2007-2009 për ndërtim HEC-esh janë marrë në kundërshtim me ligjin. Banorët i kanë kërkuar prefektit që të ndërhyjë për të pezulluar ndërtimin si dhe i kanë shprehur atij edhe kërcënimet që kanë marrë nga firma ndërtuese. Pas këtij informacioni, prefekti i ka kërkuar me shkresën prot. nr. 331/1 datë 10 mars 2014 Ministrin të Energjisë dhe Industrisë, z. Damian Gjinkuri për trajtimin dhe zgjidhjen ligjore të këtij rasti.

Disa ditë më parë, në fund të muajit shkurt, disa banorë të fshatit Strikçan dhe Valikardhë kanë bërë një ekspeditë në terren, së bashku me drejtoreshën e Ujërave dhe Kanalizimeve të qarkut të Dibrës, znj. Lutfie Meta, dhe katër specialistë të ujërave.

“Me gjithë kushtet e vështira të motit shkuaam në Liqenin e Zi dhe verifikuam gjendjen në terren”, - thotë Naxhi Hasa, ish-mësues.

“Ne nuk po merremi me të vërtetat e dokumentacionit që ka në letra, ajo është detyrë e institucioneve ta verifikojnë, por ne si komunitet, mund të themi, së pari, se për ndërtimin e hidrocentralit nuk është marrë asnjë mendim i komunitetit, asnjë konsultë, asnjë takim. Së dyti, është ndërtuar vepër mbi vepër, pasi kanali vaditës është funksional që nga viti 1979. Së treti, është tjetërsuar vendndërtimi nga Tërnova në Valikardhë, me një distancë rreth 85 km. Në dokumente thuhet Hidrocentrali i Tërnovës, ndërsa ndërtohet në Valikardhë. Së pesti, ne konstatuam se janë hedhur inerte në Liqenin e Zi, nga punimet që po kryhen. Dhe së fundi, konstatuam se liqeni këtë vit, për shkak të punimeve është lënë i hapur deri me 23 nëntor 2013, duke shkuar dëm rreth 2.2 milionë metër kub ujë”, - thekson Naxhiu.

“Ky problem nuk është vetëm çështja jonë, por është çështje shtetërore dhe ligjore, - thotë Naxhiu. Për këtë problem u ngritën një përfaqësi prej 5-10 vetash nga fshati Strikçan dhe Valikardhë të ndiqnin problemin në komunikimet

INTERVISTË ME ADMINISTRATORIN E FIRMËS KONTRAKTUESE “TEODORI 2003” SHOIPTARO-KANADEZIN, LULZIM LALOSHI

Problemi ynë: Nuk kemi komunikuar shumë me komunitetin

- Mbetët të kënaqur nga rezultatet e këtij takimi që patët me banorët protestues.

- Po, jam shumë i kënaqur me rezultatin e këtij takimi që zhvilluam me banorët këtu në Strikçan. Këtu ka një problem se ka patur një mungesë komunikimi edhe për të sqaruar popullin se investimi që bëhet nuk është kundër popullit, por është për të gjithë.

- Përfundimisht, si u ra dakord në këtë takim që patët me banorët protestues?

- U ra dakord se ne do të komunikojmë me popullin dhe do të zgjidhim të gjitha problemet dhe populli nuk do të cënohet për vaditjen e tokave.

- Motivi i protestave të banorëve është “larg duart nga Liqeni i Zi”, pra që të mos preket uji i Liqenit të Zi.

- Me sa kuptova unë, motivi i banorëve është që të ketë ujë të mjaftueshëm për vaditje të tokave bujqësore.

- Dhe ju e garantoni këtë?

- Po, në qoftë se do të ketë reshje, se në qoftë se dikur nuk ka ujë për asnjë njeri s'kam çfarë bëj unë, se unë nuk jam...

- Pra, përfundimisht vaditja e tokave do mbetet në varësi të reshjeve?!

me ministrinë, deputetët, komunën dhe firmën ndërtuese. Megjithatë, më 14 shkurt të këtij viti, në komisaratin e Bulqizës u bë një ballafaqim mes përfaqësuesve të fshatrave dhe firmës, në praninë edhe të kryetarit të komunës. Firma përfaqësohej nga një avokat, por më vonë ai doli se ishte një menaxher i firmës dhe herë prezantohej si kanadez, dhe herë si shqiptar. Në atë takim, - thote Hysa, - ne kërkuam dokumentacionin e hidrocentralit, lejen e ndërtimit, vendimet e KKRRT, hartat dhe skicat; gjithçka që kishte të bënte me ndërtimin. Tre ditë më vonë, më datë 17 shkurt, komuna na vuri në dispozicion disa dokumente, jo të plota, por që ne kuptuam se ky objekt është tërësisht i parregullt, dhe vendimet për të janë marrë në fshehtësi të plotë. Hidrocentrali është mbështetur në skemën e kanalit vaditës Liqeni i Zi - Strikçan - Gollobordë i vitit 1976-1979. Ballafaqimi i firmës me popullin deri më tani ka rezultuar i dështuar, pasi firma nuk garanton dot paprekshmërinë e ujit për vaditje.”

Tokat e vaditura nga Liqenin i Zi zënë një sipërfaqe në total prej 290 hektarë, pa përfshirë edhe rreth 40 ha te fusha e Gurrës, të cilat kanë

- Po, domethënë ne kemi një detyrim kontraktual që të mos cënojmë ujin që përdoret nga komuniteti lokal për vaditjen e tokave, kjo është e qartë, nuk kam asnjë dyshim në këtë drejtim unë. Ne kemi pasur një problem të vogël se nuk kemi komunikuar shumë me komunitetin pasi kanë filluar investimet lokale, për tu sqaruar me komunitetin lokal dhe për tu thënë atë që mendojmë. Unë mendoj që një pjesë e madhe e komunitetit lokal këtu nuk e kanë idenë se çfarë po bëjmë ekzakt, apo dikush që nuk e kupton ekzakt se çfarë po bën dhe ata kanë opinionet personale pastaj.

- Pra ka qenë sipas jush një mungesë komunikimi dhe transparence mes jush dhe banorëve që ka çuar në nisjen dhe vijimin e protestave?

- Kryesisht kjo ka qenë. Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim që ka investuar për realizimin e këtij projekti, nuk ka investuar se ka ndonjë fitim, por BERZH-i ka investuar sepse e shikon këtë si një vend që duhet favorizuar.

Intervista është marrë më 6 mars 2014 nga gazetari Hysen Likdisha, pas një takimi të zhvilluar në fshatin Strikçan mes banorëve protestues dhe përfaqësuesve të kompanisë kontraktuese për ndërtimin e HEC-it nga “Teodori 2003” në Valikardhë.

nevojë për një shtrirje tubacioni plastik prej 1500 metrash, që u është premtuar vazhdimisht në fushata elektorale. “Deputetet jo vetëm që nuk po e mbajnë premtimin, por edhe nuk po na ndihmojnë që të gjendet e vërteta dhe e drejta jonë në lidhje me hidrocentralin”, - përfundon ish-mësuesi Hysa.

LETRA E ZYRTARIT QË I “HEDH BENZINË ZJARRIT”

Ajo që i ka hedhur benzinë zjarrit ka qenë një përgjigje e z. Dael Dervishi, drejtor ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Në shkresën e tij nr. prot. 2618/1, datë 7 maj 2014, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, thekson se “kjo çështje po trajtohet politikisht nga një grup njerëzish ndoshta edhe për arsye personale”.

Dervishi thotë se “nga ana jonë u bë verifikimi i dokumentacionit në dosjen e koncesionarit, ku rezultoi se në studimin për shfrytëzimin e ujërave të liqeneve të Tërnovës janë marrë në konsideratë studimet dhe skemat që janë zbatuar

në vitet 1980 për bujqësinë, kryesisht ujitja e Gollobordës, ku është ndërtuar kanali i vaditjes me një kapacitet 500-600 l/sek.”

“Duke u nisur nga kjo kërkesë dhe duke shfrytëzuar gjithë pellgun ujëmbledhës të kësaj zonë, është kryer studimi për shfrytëzimin hidroenergetik të burimeve ujore të zonës Martanesh - Tërnovë, duke shfrytëzuar edhe liqenin e Tërnovës për këtë qëllim”.

Studimi, thotë në shkresën e tij Dervishi, është miratuar nga grupi i oponencës teknike në nëntor të vitit 2004 si dhe ka marrë miratimin nga organet shtetërore duke u pajisur me leje ndërtimi. Në këtë projekt është parashikuar që për nevojat e bujqësisë të krijohet Liqeni i Fushës së Zogut me një kapacitet 1 milion e njëqind mijë metër kub ujë, duke përcaktuar punimet që do të kryhen si dhe vlerën e investimit, gjë e cila sot është realizuar nga ana e shoqërisë koncesionare. Ky liqen do të zëvendësojë Liqenin e Zi, i cili në këtë projekt do të shërbejë si rregullator i prurjeve të pellgut ujëmbledhës dhe si furnizues me ujë i HEC-it të Tërnovës. Por për nevojat e bujqësisë do të mbetet siç ka qenë Liqeni i Sopotit me një kapacitet prej 300 mijë metër kub ujë.

Sipas llogarive të Dervishit, për nevojat e bujqësisë do të jenë në dispozicion 1 milionë e katërqind mijë metër kub ujë, e mjaftueshme për sipërfaqen e tokës që mbulon prej 600-700 hektarë.

Dervishi më pas, duke pasur parasysh investimin e deritanishëm të firmës në shumën prej 13 182 535 000 lekë, shtron pyetjen: pse ky shqetësim del sot, kur janë kryer të gjitha këto punime ndër vite?

Dhe në emër të Drejtorisë Hidroenergetike shpreh konsideratat se “problemet sociale të krijuara mes firmës sipërmarrëse dhe komunitetit duhet t'i zgjidhë shoqëria koncesionare, akuzat ndaj kryetarit të komunës i quan si të nxitura politikisht, shpronësimin e tokave e quan të zgjidhur me ligj, por deri më tani nuk ka pasur asnjë problem sipas të dhënave nga koncesionari dhe për pyjet dhe ndërtimin e rrugëve të brendshme, është kompetencë e ndërmarrjes pyjore, e cila ka një marrëveshje për rehabilitimin e tyre pas përfundimit të punimeve.

Rekomandimet e drejtorisë së AKBN janë:

Për sezonin e ujitjes për vitin 2014 duhet të funksionojë si Liqeni i Fushës së Zogut edhe Liqeni i Zi, pasi ky HEC do të fillojë nga puna në fund të vitit 2014 dhe në këtë mënyrë bëhet kolaudimi i saktë i kësaj vepre.

Rekomandimi tjetër është se shoqëria koncesionare dhe komuna duhet të hartojnë një kontratë për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore për vitin 2015 e në vazhdim, ku të përcaktohen koha që do të duhet për ujitjen e kësaj sipërfaqeje në qoftë se del e domosdoshme, marrja e ujit nga Liqeni i Zi.

Dervishi garanton se kuota e Liqenit të Zi do të jetë ajo ekzistuese, kështu që nuk do të ketë asnjë ndikim në prurjet e burimeve të ujit

(Vijon në faqen 5)



Pamje nga Liqeni Artificial i Fushës së Zogut, investim i firmës “Teodori 2003”. Gusht 2014. Foto: © B.Karoshi



Ndal devijimit të lumit Radika!

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Aktivistë shqiptarë të dhjetra shoqatave civile në Dibër të Madhe, Strugë, Ohër, Gostivar, Tetovë, Shkup, etj, më njoftojnë për tu bërë pjesë e një udhëtimi që ata do të ndërmarrin në dhjetëditëshin e fundit të gushtit, më saktë më 23 gusht, në Fushën e Lukovës, për të sensibilizuar qytetarët e Dibrës, kundër devijimit të lumit Radika, për ndërtimin e një hidrocentrali në këtë fushë.

Dibër e Madhe, e shtunë 23 gusht.

Mëngjes, ora 07.10 minuta, Dogana e Bllatës pa fluks udhëtesh krejt e zbrazur edhe pse është ditë pazari. Ndoshta është heret. Na dy doganat kalojmë pa vështirësi. Teksa po prisja që të vinin të më merrnin, me vjen një mesazh që për të udhëtuar drejt Dibrës së Madhe për t’iu bashkangjitur grupit, më duhej të merrja taksì. Dielli sapo ka dalë në horizont mbi malin në Dibër të Madhe, por qyteti nuk duket pasi është i zhytur në një si mjegull. Nga vjen kjo mjegull, pasi është ditë me diell – pyesim taksistin, me të cilin po udhëtojmë drejt Dibrës së Madhe. –Nuk është mjegull, por re tymi nga djegia e mbeturinave. Në hyrje të qytetit shohim se u është vënë flaka mbeturinave, njëlloj siç ndodh edhe tek ne këndej kufirit.

Drejtohem për tek Pallati i Kulturës, ku më ishte thënë se do merrja takim me një nga organizatorët e inkursionit për në Fushën e Lukovës, Shuip Marku. Sheshi para Pallatit të Kulturës, krejt i zbrazur, asnjëri. Vetëm një qen i madh rruge para tij, që ende duket se vijon të dremisë, duke na kujtuar se nata ka qenë e lodhshme për të. Nuk mund të komunikoj me asnjëri pasi telefoni nuk punonte më. Ashtu, i topitur, në pamundësi për tu lidhur me aktivistët e shoqërisë civile me të cilët do të udhëtonim drejt Fushës së Lukovës, gjendem në qendër të qytetit, pranë heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

I ulur në një stol, përfitoj për të soditur qytetin historik të Dibrës, në një ditë të shtunë, që është njëherësh edhe ditë pazari. Ngjitur me mua një i moshuar imcak që vetëm më vështron dhe buzëqesh. Përpiqem të komunikoj me të, por është e pamundur. Ai vetëm se vijon të buzëqeshë dhe të lëvizë kokën, sikur të

kërkojë diçka. Në rrugë ende nuk ka gjallëri lëvizjeje. Qyteti çapitet me ngadalësi. Një pastrues i komunales me një karrocë dore, nxjerr fshesën dhe nis të pastrojë letrat e papastërtitë e shetitorës, që ishin të bollshme dhe karroca e vogël e tij nuk mund t’i nxëjë. Një zonjë sheherlie teksa kalon në boulevard, përballet me dorën e shtrirë për lëmoshë të komshiut që kisha pranë stolit. Zonja ndalon, hap çantën për të nxjerrë kuletën nga e cila i bie në tokë një kartmonedhë metalike. –Urdhëro, merre dhe

atë që ranë tokë, -i thotë lypësit që nuk kishte fjalë, por vetëm buzëqeshje. Më pas po një tjetër zonjë, por jo si e para. Pasi dorës së shtrirë të lypsarit, i përgjigjet me një gjestikulacion që përkthehej; -të lutem më ler rehat se nuk kam terezinë tëndë.

Ora po shkonte rreth 09.00, kohë kur isha njoftuar se do nisej grupi. Kështu i dyzuar, në pamundësi që të lidhem me pjestarët e grupit, këmbët më çojnë përsëri tek sheshi para Pallatit të Kulturës. Nga kjo gjendje më nxjerr një bori

PER TE SHPETUAR NJE JETE – DHUROJ GJAK, E MBROJME RADIKEN PER TE SHPETUAR SHUME JETE

Shoqata qendra per zhvillim te qendrueshem te komunitetit ne partneritet me kryqin e kuq ne Diber, i perkrahur prej inicijatives per mbrojtejen e Radikes dhe kafe bar Liburn, organizuan aksion humanitar per te dhuruar gjak me moton “Per te shpetuar nje jete –dhuroj gjak, e mbrojme Radiken per te shpetuar shume jete”.

Aksionin e perkrahen shume qytetare human prej moshave dhe gjinive te ndryshme, dhe perkatesive te ndryshme etnike, te gjithë jane te brengosur per fatin e rajonit, prej

rezikut te devijimit te ujrave te lumit te Radikes, dhe si gjithmone ne menyra te ndryshme humane shprehin dashurine e tyre per njerzimin dhe natyren.

Shpresojme qe gjaku i dhuruar te shkoje tek personat qe kane nevojë duke shpetuar jeten e tyre, e njekohesisht mesazhi yne te shkoje tek ata qe sjellin vendime. Te nderpriten te gjitha aktivitetet dhe sa me shpejt te silltet vendim ne stopimin e projektit per ndertimin e pendave ne Fushe te Lukoves dhe Uren e Boshkut.



Për më shumë rreth lajmeve mbi Radikën ndiqni faqen ne FB “Të mbrojmë lumën Radika”

makine prapa meje, ku drejtuesi i saj ma bën me dorë që të ndaloj. – Shuip Marku jam, kryetar i Shoqatës për Zhvillim të Qendrueshëm -më thotë ai. Pasi më prezanton edhe me Qeram Lleshin, drejtor i gjimnazit të Dibrës së Madhe dhe Dritan Lleshin koordinator i organizimit të shoqatave, na fton për të pirë një kafe në Bar-Restorantin “Gramozi”, në anë të Pallatit të Kulturës. Këtu ishte caktuar për tu grumbulluar grupi që do udhëtonte drejt Fushës së Lukovës. Teksa po pijmë kafe, aktivistët janë grumbulluar gati për nisje. Madje grupit i bashkohet edhe Rexhep Manuka, i ardhur nga Belgjika ku jeton e punon, nipi i Markeve. Rexhepi edhe pse i lindur dhe rritur në Belgjikë, flet mirë shqipen dhe thotë se prindërit ja kanë kultivuar dashurinë për vendlindjen e prindërve. – Vij vazhdimisht në Dibër. –Këtë herë kam ardhur për t’iu bashkangjitur grupit të aktivistëve të shoqërisë civile, për t’i thënë jo projektit për devijimin e lumit të Radikës.

NISJA DREJT FUSHËS SË LUKOVËS.

Para lokalit ku pijmë kafetë ishte parkuar mikrobusi që kompania “Gazmendi Travel” kishte vënë në dispozicion për udhëtimin e aktivistëve të shoqërisë civile. Nën kujdesin e Shuipit, organizatorit të këtij inkursioni, njëherësh dhe menaxher i shoqatës Iniciativa për Mbrojtjen e Radikës, akomodohemi në mikrobush dje aty nga ora 09.30 minuta nis udhëtimi për tek vendburimet e Radikës. Sapo lëmë qytetin, futemi në të famshmen “Gryka e Radikës”. E para që të bie ndërmend sapo futesh në këtë Grykë, është dhe mbetet historia e belasë që gjeti këtu 170 vite më parë, pashai turk Hajredin Pasha, që siç thotë kënga la këtu 12 mijë të vranë për të nënshtruar Dibrën. Atëherë ishte Sali Markja një nga udhëheqësit e kësaj lufte që nuk lejoi që Dibra të nënshtrohet.

Bisedat brenda në mikrobush janë diskrete. Por që të gjitha në finale fokusohen tek mbrojtja e Radikës. Aty nga mesi i rrugës nacionale Dibër e Madhe-Mavrovë, në vendin e quajtur “Sastavreka”, mikrobusi devijon majtas, ku një tabelë në anë të rrugës bën me dije se po futesh në zonën e parkut nacional “Mavrova”, ku dhe vijon rrjedhja e Radikës. Pikërisht këtu Radika në rrjedhjen e saj bashkohet me një tjetër degë rrjedhje uji që vjen nga Mavrova. Pas një pushimi të shkurtër këtu, ku grupit i bashkangjiten edhe aktivistë nga shoqëria civile e rajonit të Rekës, rinisemi në udhëtimin tonë, që vijon përgjatë rrjedhjes së Radikës herë në të djathtë dhe herë në të majtë të saj, në grykë male madhështore që duken pambarim. Pyje të paprekur nga sëpata dhe motosharra, që bien për mirë në sytë tanë. Ecim drejt rrugës që të çon në Strazimir, e cila ka qenë njëherësh edhe rruga e vjetër për në Prizren, -thotë Shuipi. Madhësinë e këtyre grykëmaleve, e rrisin dukshëm edhe shkëmbjetë që i mveshin ata në të dyja anët e tyre, që ngjajnë me kala të pamposhtura natyrore. Rruga është e ngushtë dhe e pa asfaltuar. Si rastësisht na parakalon në rrugë e sipër një makinë policie. – Duket se janë njoftuar për lëvizjen tonë dhe vijnë për “shoqërim”, -më thotë buzagaz Shuipi. Dhe vërtet, pa bërë mirë as gjysmën e rrugës drejt objektivit tonë, bllokohemi nga policia pyjore maqedonase, që e kishin kthyer kryq makinën e tyre për bllokimin e rrugës. – Nuk mund të kaloni më lart me makinë, pasi ndotet ambienti, -thonë policët pyjorë. Këmbënguljes tonë për mosbindje ata i përgjigjen:

-Ju lutemi, kemi urdhër për të mos lejuar makinat të lëvizin më lart. Një nga pjestarët e grupit, thotë të përmbysim makinën. Por, Shuipi nuk lejon, pasi mendon se bllokimi i rrugës nga policia maqedonase nuk është gjë tjetër, por veçse një provokim i tyre. – Nuk do të biem në këtë provokim të ulët policisë, por do të vazhdojmë në këmbë në rrugën tonë për mbrojtjen e Radikës, rrugë kjo që nuk ka për tu ndalur kurrë derisa qeveria maqedonase të heqë dorë nga projekti për devijimin e Radikës, që është dhe do i mbetet Dibrës dhe dibranëve, -thotë Shuipi.

Bindemi të gjithë dhe nisim në këmbë rrugëtimin tonë për tek Fusha e Lukovës. Për të arritur objektivin duhej të bënim më shumë se 10 kilometra në këmbë. Grupi i aktivistëve pjesmarrës edhe pse kishte në përbërje të tij pjesmarrës të të gjitha grupmoshave, vijon

Piknik to "Lukovo Pole" by Bardhyl Marku



lëvizjen drejt bjeshkëve të Korabit. Sa më lart që ngjitemi rrjedhja e Radikës sa vjen dhe zvogëlohet deri sa shteron fare.

– E shikon, -më thotë Shuipi. –Edhe në gjendjen aktuale Radika është e tharë pasi uji i saj shkon në Mavrovë, ja shikoje ky është tubacioni që e dërgon atje. – Radika aktualisht në Dibër sjell vetëm ujrë që rrjedhin në të nga zona e Rekës. Në këtë rrugëtim ndalojmë shpesh që të rigrupohemi së bashku, ku organizatorët na ofrojnë lëngje dhe ushqime të thata, kjo edhe për tu lehtësuar nga mbartja e tyre, pasi pas bllokimit të mikrobussit, na është dashur për ti transportuar vetë ato.

Thuhet se çdo e keqe e ka edhe një të mirë. Kështu gjatë udhëtimit në këmbë, pata mundësi të përcjell nga afër mjaft nga bisedat që zhvilloheshin nga pjesëmarrësit e këtij udhëtimit. Pata fatin që një pjesë të mirë të rrugës ta kaloj me Shpëtim Pollozhanin, kryetar i Shoqatës të Burgosurve Politikë Strugë, një burrë vërtet fisnik, që binte në sy për inteligjencë dhe kulturë të lartë deri edhe në veshje me ngjyrat kombatare të flamurit shqiptar kuq e zi.

– Fajti për marrjen e ujit të Radikës, nëse ky projekt do të realizohet, padyshim që do bjerë mbi politikanët shqiptarë të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, thotë krejt bindje ai. – Kjo sipas tij argumentohet me faktin se projekti i qeverisë maqedonase parashikon ndërtimin e një ujëmbledhësi në trekëndëshin Kosovë-Maqedoni-Shqipëri, ku dhe do të ndërtohet një hidrocentral. -Ndaj kush më tepër se politikanët shqiptarë këndeje dhe andej kufirit, mund dhe duhet të ngrenë zërin që ky projekt të mos realizohet.

–Pa bela kjo nuk zgjidhet, -thotë Lulzim Fejzullau nga Gostivari, që nënkupton bashkimin e gjithë shqiptarëve në mbrojtje të kësaj çështje. Pasi kemi udhëtuar për më shumë se 2 orë, kur kemi hyrë në zonën e zhveshur alpine në krahun lindor të bjeshkëve të Korabit, shfaqet stationi që ndan ujin e Radikës në dy pjesë, ku gjysma e ujit shkon në liqenin e Mavrovës.

– Ja shikoni, pikërisht këtu i është bërë atentati i parë Radikës, ku me një vendim të qeverisë maqedonase më 1957 këtu u bë marrja e parë e ujit të Radikës, ku sipas këtij vendimi gjysma e këtij uji ju dha liqenit të Mavrovës, ku u ndërtua edhe një hidrocentral, thotë Bashkim Mashkulli, kryetar i këshillit komunal Dibër. – E shikoni që edhe pse sipas vendimit gjysma duhet të shkojë në rrjedhjen natyrale të Radikës, aktualisht është krejt e bllokuar. Disa nga pjesëmarrësit nisin dhe rrotullojnë saraçineskën duke e çuar ujin në rrjedhën e tij natyrale, ku Radika nis dhe gjallërohet. Por, organizatori i këtij inkursioni, Shuip Marku si gjithmonë i kujdesshëm në shmangie të incidenteve, udhëron që rrjedha e ujit të shkojë ashtu siç dhe ishte.

– Banka Botërore, e cila është financon projektin, është shumë e ndjeshme sa i përket impaktit që kanë projektet e saj mbi stabilitetin gjeopolitik në Ballkan, -thotë Shuipi. BB ka kërkuar një rivlerësim në mjedis të këtij projekti dhe ka një tërheqje në heshtje prej tij. Por, përkundër kësaj qeveria maqedonase dhe konkretisht Ministria e Ekologjisë ka nxjerrë vendimin për fillimin e punës. Normalisht, vijon në fjalën e tij Shuipi, urdhëri për fillimin e punimeve del kur garantohet fondi, por ndofta qeveria mund të sigurojë fonde nga Rusia apo Kina, për realizimin e këtij projekti.

Gazmend Cami, arkitekt, thotë se strukturat

shtetërore duhet të gjejnë mirkuptimin, të dëgjojnë zërat e qytetarëve, shoqatave, që janë kundër këtij projekti për shumë arsye. Ndër ta ai rendit; shkatërrimin e biodiversitetit, bukurive natyrore, si dhe mundësive për zhvillimin ekonomik të zonës Dibër, Rekë, duke patur parasysh turizmin malor, bujqësinë, blegtorinë, dhe degët e tjera ekonomike. Reagimet tona kundër këtij projekti do të vijnë si lobimi me të gjitha strukturat endimmarrëse, pushtetin lokal, ministritë përkatëse, si dhe qeveritë e tre vendeve, pasi ky projekt ka ndikim edhe përtej kufijve shtetërorë, në kuptimin e arsyetimit ekonomik. Në këtë kuptim, arsyetimin ekonomik të këtij projekti e bën më të zbehtë fakti se uji që planifikohet të devijohet me qëllim prodhimin e energjisë elektrike, i njeiti në rrjedhën natyrore prodhon energji elektrike në 5 HEC-e të kaskadës së Drinit. Kjo hap shtegun e dyshimeve se prapavija e këtij projekti synon zvogëlimin e pasurive ujore të zonës në llogari të zmadhimit të nivelit të rrjedhës së ujit në Pellgun e lumit të Vardarit, e përfundon fjalën e tij arkitekti Gazmend Cami.

Ndërsa Flamur Molladarito, biolog, thotë se me ndërtimin e Pendës në Fushë të Lukovës, çrregullohet lëvizja e lirë e shtazëve në Parkun Nacional të Mavrovës, pasi u reduktohen kushtet normale të jetesës, si dhe rrezikohet një pjesë e madhe e faunës pjestarë të së cilës janë edhe endemite (jetojnë vetëm këtu). Mbi të gjitha e rrezikuar mbetet Struulla e Reqeuballit, kur numri i kësaj specie është më 600 çifte në këtë park. Ndërron mikroklima, që ndikon gjithashtu edhe në florën e parkut Nacional e përfundon fjalën e tij për gazetën biologu Cami.

Në kthim për tek vendi ku na priste makina e bllokuar nga policia, na rastis të udhëtojmë me një tjetër aktivist të shoqërisë civile mjaft aktiv, Bardhyl Marku, që së bashku me dy fëmijët e tij vinte nga Shkupi. Ai kishte marrë me vete edhe një temus me kafe, që na e shërvir në pushimet gjatë rrugës për të na nxjerrë lodhjen.

-Të tregojmë se Radika nuk është as e qeverisë së Maqedonisë, as e ndërmarrjes ELEM, por Radika është e banorëve dibran dhe të Rekës dhe do të jetë ashtu siç është”, thotë ai. Ne, vijon ai, do ta kundërshtojmë këtë projekt shkatërrues elektroenergjitik “Fusha e Lukovës” dhe “Ura e Boshkos”deri në fund, duke hedhur me këtë rast edhe idenë e organizimit të një referendumi për këtë qëllim.

NË VEND TË MBYLLJES

Në kthim edhe pse një ditë e lodhshme, kjo nuk ndjehet fare, madje as edhe nga Besari, Dafina, Visari dhe Yllka, nxënës të shkollës 9-vjeçare. Po kështu lodhje nuk ndjej as unë, thotë Fiknetja, një e re në emigracion e ardhur nga Italia, e cila ka marrë pjesë edhe në protestat e zhvilluara në Itali kundër këtij projekti.

Gjithsesi ajo që mbetet në mendje nga ky udhëtim është mesazhi sensibilizues për tu bërë bashkë të gjithë, për t’i thënë stop devijimit të Radikës.

“Shqiptarët të dëgjojnë njëri-tjetrin më shumë se sa të huajt. Kjo nuk është lëvizje kundër akujt, por lëvizje për tu bashkuar së bashku. Një mesazh i qartë me këtë rast vjen edhe për një reagim të qeverisë dhe Kuvendit të Shqipërisë, që të mos lejojnë zyrtarizmin e një projekti të tillë, që diskriminon Dibërën dhe dibranët, me uzurpimin e ujrave të Radikës.

Banorët: Në rrezik Liqeni i Zi dhe vaditja e tokave tona!

(Vijon nga faqja 3)

të pijshëm, ndërsa ngre shqetësimin se që nga dhjetori 2013 që kanë filluar protestat, kane influencuar në grafikun e punimeve, kështu që del e domosdoshme zgjidhja e kësaj situatë për t’i qëndruar korrekte kontratës së koncensionit në lidhje me afatin e punimeve.

Kjo përgjigje i ka irrituar banorët dhe kanë shtuar dyshimet se ky ndërtim dhe dokumen-tacioni mbështetës ka kaluar nëpër një zinxhir veprimesh korruptive dhe të kundraligjshme.

“Për të verifikuar se argumentet e zotit Der-vishi nuk qëndrojnë, duhet të shkojmë në ter-ren, - thotë Ylli Hoxha. Dhe atje shohim edhe Liqenin e Zi, edhe Liqenin e Fushës së Zogut, edhe liqenin e Sopotit. Dhe pastaj të shohim se ku është uji”.

RRUGËS DREJT LIQENEVE, ME POLICINË PRIVATE NGA PAS

Drejt Liqenit të Zi nisemi me Yllin, Sabahun, Muharremin dhe Xhemal Toskën, shoferin e fugonit, i cili ka edhe një zdrukthëtar. Ai e ka “pësuar” nga mbështetja që u ka dhënë pro-testave, pasi taksat lokale këtë vit i kanë shkuar një milionë e dyqind mijë lekë, më shumë se vitet e kaluara, megjithëse nuk ka fare punë.

Një postbllok i një policie private është ngritur në rrugë. Me germa të mëdha është shkruar “NDAL RUHET ME ROJE”. Ndërsa në një tabelë tjetër të ndryshkur shkruhet: “Kujdes Kantier Ndërtimi. Ndalohet hyrja e personave të paautorizuar & të pashoqëruar”.

Një polic të ndalon të ngresh traun. “Nuk lejohet”, - thotë. Pas këmbënguljes sonë, ai u largua disa metra më tutje dhe mori në telefon shefin e tij. Pastaj erdhi dhe na tha se do të lejoheshim të kalojmë, pasi të shënojmë në një bllok të gjithë emrat. E pyes ndërkohë policin dhe i them se cilin kantier ndërtimi ruan. “Nuk ka kantier”, - thotë ai, ndërsa për tabelën thotë se kështu ka qenë që në fillim.

Zona është park natyror dhe i reklamuar si e përshtatshme për turizmin malor, por zor se turistët do ta preferonin një postbllok në rrugë. Asnjë postbllok policie private nuk të ndalon të shkosh në Theth, Valbonë apo Korab. Banorët e fshatit që më shoqërojnë mendojnë se poli-cia është vendosur aty për të penguar njerëzit të shohin punimet që po bëhen. Gjithashtu, kanë nën kontroll edhe prerjen e paligjshme të pyjeve. Pas nesh një makinë tjetër udhëtoi për të Liqeni i zi, por kur u kthyem e pyetëm policin nëse i kishte shënuar emrat e tyre dhe targën e makinës, por ai tha se i njihte dhe nuk ishte e nevojshme”. Ndërsa një makinë e policisë private na ndoqi gjatë gjithë udhëtimit tonë pranë liqeneve.

Rrugës për të Liqeni i zi shihen se janë bërë punime për hapjen e rrugëve që do përdoren për shtrirjen e tubacioneve. Pemë të prera që shtrihen kryq anësh rrugës.

NË KËRKIM TË UJIT

Pasi arrijmë te Liqeni i Zi shohim se trunje pemësh, madje edhe një kioskë e shëmtojnë pamjen e bukur të liqenit. Ylli ndalon te diga dhe thotë: “Çdo investim në Liqenin e Zi është bërë në kohën e monizmit. I vetmi investim i firmës ndërtuese është rruga për të shtrirë tuba-cionin drejt digës së liqenit. Gurët e nxjerra nga një galeri që është hapur në anën perëndimore të liqenit janë hedhur në liqe.”

Liqeni i Zi ndodhet në lartësinë 1650 metra mbi nivelin e detit, ndërsa maja më e lartë e kurorës rreth liqenit është 1720 metra. “Pra, thekson Ylli, kemi të bëjmë me një disnivel prej 70 metrash që shërben për mbledhjen e ujit nga reshjet dhe bora. Dikur pyjet ruanin më shumë borën, por tani që pyjet janë prerë rezervat ujore nga shkrija nuk presin pranverën”.

Këtë vit Liqeni i Zi është hapur me 15 kor-rik, një muaj e gjysmë me vonesë dhe ka rënë niveli rreth një metër e gjysmë. Liqeni nuk ka ujë më shumë se edhe tre javë të tjera, duke shkuar kështu në kufirin e periudhës së vaditjes.

“Në dokumentacionin për hidrocentralin, shënohet kapaciteti maksimal i liqenit, por që kur është bërë shtesa e digës në vitet ‘76, nuk ka pasur asnjëherë derdhje natyrore, pra liqeni nuk është mbushur asnjëherë në kapacitet të plotë dhe me këtë prurje dhe rezervim uji, na është dashur për vaditje?”

“Ne duam rezervada deri në këtë nivel, tregon

me gisht Ylli pak mbi mbushjen maksimale të këtij viti, pasi po nuk qe gjithmonë në këtë nivel, ne nuk kemi ujë. Me letra na thonë se do ta ruajnë nivelin, por si do ta ruajnë? - bën pyetjen Ylli.

“Nga 5-8 metra që duhet të mbushet liqeni nga shtatori në maj, është mbushur vetëm 1 metër, si rezultat i punimeve të firmës dhe mungesës së reshjeve”, - thotë Muharrem Gjoka.

Më pas shkojmë te galeria në anën perën-dimore të Liqenit. Ne nuk hyjmë brenda, pasi nuk duam të krijojmë asnjë shkak për konflikt me policët privatë që na ndjekin nga pas. Por shihet dukshëm se mbetjet e nxjerra nga galeria e kanë pasur rrugën më të shkurtër për në liqen.

Rrugës për të Liqeni i Fushës së Zogut shohim pyje të prera. Disa pemë të djegura të vetmuara qëndrojnë si lapidar, sikur duan të dëshmojnë masakrën që është kryer më parë në këto anë.

Ndalojmë te Liqeni i Sopotit, i cili është pa ujë. Një kanal në veri të tij tregon se aty janë bërë punime për të çuar ujin në liqenin e Fushës së Zogut.

“Sot është 4 gusht. Ky liqen nuk ka ujë. Ku do ta marrin ujin që do ta çojnë atje”, - bën pyetjen retorike pyet Ylli Hoxha?

Pasi arrijmë te Fusha e Zogut, shohim digën e ndërtuar. Por ujë ka fare pak, aq pak sa nuk mbulon dot edhe barin e fushës.

“Ky liqen, - thotë Ylli, - nuk plotëson asnjë kusht, siç thuhet në shkresën e z. Dervishi. Ai jo vetëm që nuk ka hyrë në funksion, megjithëse ka mbi dy vjet i ndërtuar, por nuk ka për të hyrë kurrë, pasi Liqeni i Fushës së Zogut, ndryshe nga Liqeni i Zi, nuk ka burime të brendshme ujore, nuk ka asnjë burim ku furnizohet, përveç reshjeve”. Ylli kujton se në shkresën e z. Dael Dervishi, ky liqen duhet të ishte vënë në funksionim këtë vit, madje do kishte rezervada mbi 1 milionë metër kub ujë. Ku është uji?

Duke vazhduar argumentet kundër shkresë së zotit Dervishi, Ylli thotë se në vitin 1976 sistemi i vaditjes u ndërtua për fshatrat Va-likardhë, Strikçan, Sopot, Tërnovë e Madhe, Tërnovë e Vogël dhe Smollik, dhe me pers-pektivë disa fshatra të zonës së Ostrenit. Por ndërkohë, duke parë sistemin hidrik dhe kushtet ekologjike të zonës ujëmbledhëse për atë kohë, megjithëse u ndërtua edhe një fon kalues, nuk u vu në funksion për mungese uji. Liqeni i Zi sot është në pikën e shkarkimit, ku për këtë vit dhe në vitet në vazhdim nuk garanton me mbushjen 4-5 metra mbi tubin e shkarkimit. Si rrjedhim, funksioni i ujit për fshatrat e lartpërmendur nuk i plotëson dhe nuk ka për t’i plotësuar kurrë nevojat për vaditje, ashtu edhe për ujësjellësat, dhe jo me këtë ujë për hidrocentralin që po ndërtohet.

Gjithashtu, në letrën e tij Dervishi i referohet Liqenit të Tërnovës, por ndërkohë ne po flasim për Valikardhën. Liqeni i Bardhë kurrë nuk ka shërbyer si rezervë ujorë për vaditje, dhe kjo e hedh poshtë argumentin e zotit Dervishi. Dhe kështu Ylli shtron pyetjen: Nga do ta marrin ujin?

Dhe si për ta mbyllur argumentin, drejtohet drejt digës dhe thotë: I vetmi investim i firmës deri më tani është ndërtimi i kësaj dige në Fushën e Zogut. Atë investim e kanë bërë, atë ujë ta marrin dhe ta gëzojnë!

“Ne nuk e kemi takuar ndonjëherë z. Dael Dervishi ose ndonjë përfaqësues të agjencisë së tij, kështu që përgjigja e tij është e bazuar vetëm në dokumentacionin që ka ai në zyrë”, thotë Muharremi.

* * *

Pas gjithë kësaj panorame, veç një zgjidhje mbetet: Të paktën një ministër, bashkë me burokratët e tij, duhet ta zhvillojnë takimin e radhës në mal, pranë Liqenit të Zi dhe Fushës së Zogut. Të verifikojnë rezervat ujore dhe në qoftë se ka ujë për të gjithë, të gjithë ta gëzojnë, por në qoftë se uji nuk është, atëherë ata që kanë firmosur dokumente joreale apo kanë marrë të dhëna para 30 vitesh dhe i kanë deklaruar si të sotme, të përgjigjen para ligjit.

Zerqani, së pari është i banorëve që sigu-rojnë mbijetesën me atë pak pasuri që kanë, pastaj i të tjerëve, kushdoqoftë ai.

B. Karoshi

Për fotografitë ilustruese të këtij shkrimi, ndiq faqen në FB të gazetës “Rruga e Arbërit” <https://www.facebook.com/rruga.arberit?fref=ts>

Martanesh, shembet galleria, humbin jetën dy minatorë.
Pas hetimeve, Policia e Matit arreston administratorin e kompanisë, Shemsi Ballabani.

Shembet galleria, humbin jetën dy minatorë

Shembja e një masivi shkëmbor nga tavana i një galerie private në Martanesh, në vendin e quajtur “Fusha e Lopës”, u ka marrë jetën dy minatorëve duke shënuar kështu një tjetër tragjedi në minierat shqiptare. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në mëngjesin e ditës së martë 19 gusht, rreth orës 09.00, duke sjellë një sërë reagimesh politike, ndërsa Ministria e Industrisë ka deklaruar se po bëhet monitorim i rreptë që subjektet të përmbushin detyrimet ligjore. Në orët e vona të kësaj nate policia ka vënë në pranga administratorin e kësaj firme që vepron që nga viti 1999.

AKSIDENTI NË MINIERË

Burimet policore të cilat kanë shkuar në vendngjarje, thanë se aksidenti i rëndë është regjistruar rreth orës 09.00 të së martës, në një nga galeritë private që ndodhet në vendin e quajtur “Fusha e Lopës”. Mësohet se minatorët kanë humbur jetën teksa punonin në galeri , thellësia e së cilës shkonte në rreth 200 metra. Burime nga vendngjarja bëjnë me dije se si për çdo ditë në këtë galeri ka hyrë për të punuar grupi i punës prej 7 minatorësh. Nuk ka zgjatur shumë kur nga tavana i galerisë është shkëputur një masiv shkëmbor duke zënë poshtë dy minatorë, të cilëve u ka shkaktuar vdekjen e menjëherëshme. Mësohet se për nxjerrjen e viktimave nga shembja e galerisë, punuan veç 5 minatorëve pjesë e grupit të punës në këtë galeri edhe grupi i avari shpëtimit. Viktimat u identifikuan si Donald Barçi, 32 vjeç, që kryente punën e vagonistit dhe Xhemal Selaj, 50 vjeç, minator shembje, që të dy banorë të fshatit Koms i në rrethin e Matit. Menjëherë sapo ka marrë njoftim,në vendngjarje ka shkuar edhe policia dhe grupi hetimor e cila ka nisur punën për zbardhjen e kësaj ngjarje të rëndë. Trupat e pajetë të viktimave janë sjellë në morgun e spitalit të Bulqizës për ekspertizë



mjeko-ligjore. Ndërkohë burime nga policia bëjnë me dije se për këtë ngjarje janë shoqëruar për në Komisariatin e Policisë Bulqizë, drejtuesit teknikë dhe minatorët që punonin në këtë galeri, shokë të viktimave, për tu marrë në pyetje rreth kësaj ngjarje.Ndërkohë mësohet se drejt vendngjarjes është nisur nga Tirana edhe një grup pune nga Reparti I Inspektim Shpëtimit të Minierave, për të kryer veprimet proceduriale në lidhje me plotësimin e kushteve të sigurisë teknike në punë për minatorët e kësaj galerie.

PRANGA ADMINISTRATORIT

Pas shoqërimeve dhe mbërritjes së ekspertëve nga Tirana, policia ka marrë në pyetje të shoqëru-

arit, ndër të cilët ka qenë edhe Shemsi Ballabani, i cili rezulton pronar i kompanisë ku ishin të punësuar dy minatorët. Sipas të dhënave kompania “Alba Co”, ishte hapur që në vitin 1999 dhe funksiononte në kërkim, përgatitje, shfrytëzim dhe përpunim të mineraleve të ndryshme. Në përfundim të hetimeve, grupi i punës ka vendosur arrestimin e Shemsi Ballabanin, 56 vjeç për shkelje të rregullave të sigurisë në punë. Kohëve të fundit është folur shumë për mungesë të kushteve të sigurisë teknike në punë për minatorët e kromit në të gjithë zonën krombajtëse të pellgut Bulqizë-Martanesh, por përkundër kësaj,puna ka vijuar krejt normalisht edhe pse aksidentet me humbje të jetëve të minatorëve pasojnë njëri tjetrin. Kështu vlen të kujtojmë se vetëm dy ditë më parë aksidenti më i fundit u regjistrua në mi-

nierën e kompanisë ACR në Bulqizë, ku nga një aksidenti i radhës u plagos në gjendje të rëndë një minator i cili aktualisht ndodhet për mjekim të specializuar ne Tirane.

REAGIMI I GJIKNURIT

Menjëherë pas këtij aksidenti të rëndë, që tashmë hetohet nga policia, ka reaguar Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, e cila ka deklaruar se ka monitorim të rreptë të subjekteve për përmbushjen e detyrimeve ligjore. “MEI shprehu pikëllim për ngjarjen që ndodhi në mëngjesin e kësaj dite dhe u shprehu ngushëllimet e sinqerta familjarëve të viktimave dhe të afërmëve të tyre për këtë ngjarje tragjike, u tha në njoftimin e dhënë prej saj. Më tej MEI sqaroi se grupet e punës të Repartit të Inspektim Shpëtimit të Minierave, paralelisht me grupet e tjera të ndihmës që ndodheshin në zonë, kanë ndërhyrë për të bërë të mundur nxjerrjen e trupave të dy viktimave.

Ngjarja ka ndodhur në galerinë nr.7 në Fushë Lopë, ku operon subjekti Alba Co me leje nr. 548, datë 06.04.2000. Pas nxjerrjes së trupave të viktimave nga galeritë drejtuesit e Repartit të Inspektim Shpëtimit të Minierave, punuan për të zbardhur rrethanat dhe mënyrën se si ka ndodhur ngjarja. Ndërkaq Ministria e Energjitikës dhe Industrisë garanto i qytetarët me këtë rast se është e vendosur për të monitoruar rreptësisht përmbushjen e kriterëve të kushteve të sigurisë në punë nga ana e subjekteve të licensuara në fushën minerare. Nga kontrollat e ushtruara deri më tani janë revokuar mbi 160 leje minerare për të cilat është konstatuar mospërmbushje e detyrimeve ligjore. Edhe në vijim MEI garanton se do të vazhdojë inspektimin në të gjitha zonat minerare, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për minatorët.

HYSEN LIKDISHA

Fundkorriku i këtij viti që përko i me seancën e fundit të këtij sesiioni parlamentar, ka shënuar miratimin në Parlament të reformës administrative territoriale, një nga reformat më të rëndësishme, por njëherësh edhe më të debatueshme e të kundërshtueshme nga banorë e qeveritarë lokalë në mbarë vendin. Miratimi në Kuvend i kësaj reforme startoi kështu me nisjen e protestave të banorëve edhe në mjaft komuna kryesisht të djathta të rretheve Mat dhe Dibër, ku u kundërshtua me mjaft forcë ndarja e re administrative territoriale sipas të cilës qarku i Dibrës do të ketë vetëm 4 bashki, Burrel, Klos, Bulqizë dhe Dibër, nga 33 njësi vendore që ka aktualisht.

Kështu në paraditën e 31 korrikut, datë kjo që ndër vite të kaluara ka qenë festuar nga matjanët si dita e çlirimit nga pushtuesit nazi-fashistë, këtë vit ka përkruar me një protestë që 3 komuna, të këtij rrethi kanë zhvilluar kundër reformës së ndarjes territoriale administrative të qeverisë. Protesta ku morën pjesë banorë të komunave Suç, Gurrë dhe Xibër, është zhvilluar në Suç pranë rrugës nacionale Burrel-Klos e cila u bllokua nga protestuesit për rreth 30 minuta, duke shkaktuar kështu vështirësi në lëvizjen e automjeteve në të dy krahët e kësaj rruge.

Protestuesit mbanin në dorë parrulla ku i bënin thirrje qeverisë dhe kryeministrit Rama që të tërhiqet nga varianti i dhënë prej tyre që e ndan këtë rreth në dy njësi administrative, konkretisht në bashkinë Burrel dhe Klos, nga 11 njësi admistrative që ka aktualisht. Sipas banorëve, shkak i kësaj proteste është bërë fakti se në asnjë rsat rast nuk është marrë mendimi i tyre për këtë problem kaq të rëndësishëm. Kjo u konfirmua edhe nga nënkryetari i komunës Suç, Ilir Çeliku, pjesmarrës në këtë protestë, i cili në fjalën e tij tha se komuniteti i kësaj zone nuk ndjehet i përfaqësuar në këtë ndarje.

Protestuesit thanë se nuk jemi kundër Reformës Territoriale, por duhet të merren parasysh edhe mendimet tona në këtë drejtim, pasi me këtë largësi dhe infrastrukturë rrugore që kanë fshatrat tone, me këtë ndarje nuk mund tu shërbehet qytetarëve. Ka fshatra, thanë ata, në zona të thella malore si Xibri dhe Macukulli që për të shkuar në qendra të bashkive, u duhen mbi 4 orë rrugë.

Në këtë protestë ra në sy mungesa e kryeko-

Mat dhe Dibër, banorët protestojnë kundër Reformës Territoriale



munarëve të këtyre komunave, por në mbështetje të saj ishte vënë edhe kryetari i Degës së Partisë Demokratike për rrethin e Matit, Alfred Ahmet-cenaj, i cili tha se protestat tona do vijnë dhe do përshkallëzohen, por do të shkohet deri ne referendum, pasi në demokraci format e protestës dhe zgjidhjeve nuk shterojnë.

Vetëm një ditë pas miratimit të reformës administrativo-territoriale në Kuvend, banorët e 5 komunave po në rrethin e Matit, kanë reaguar me bllokim të rrugës nacionale Peshkopi-Tiranë, në shenjë proteste për ndarjen e re territoriale. Kështu më 1 gusht banorë të komunave Lis, Macukull, Derjan, Koms i dhe Rukaj, kanë protestuar pranë Urës së Matit, në afërsi të qytetit të Burrelit. Mbi 1 orë, protestuesit kanë bllokuar të gjitha

anët e lëvizjes në këtë vend, ku si pasojë dhjetra automjete në dy krahët e rrugës u bllokuan. I vetmi tolerim që kanë bërë organizatorët e kësaj proteste, ishte lënia e lëvizjes për urgjencat dhe dasmorët. Drejtuesit e këtyre komunave kundërshtojnë reformën, pasi sipas tyre nuk i shërben komunitetit. Kryetari i Komunës Lis, Agim Selita, tha se reforma e kësaj qeverie është jo vetëm diskriminuese për Matin dhe qarkun e Dibrës.

Ndërkohë, ashtu si në rrethin e Matit edhe në Dibër, po më 31 korrik, banorë të Maqellarës qendër e po kësaj komune në rrethin e Dibrës, janë tubuar në protestë kundër kësaj ndarjeje sipas të cilës Dibra mbetet vetëm me 1 njësi vendore nga 14 të tilla që ka aktualisht.

Në këtë protestë e cila u zhvillua në rrethrotul-

limin e doganës së Bllatës, përveçse bonorëve të fshatrave të Maqellarës, morën pjesë edhe banorë të ardhur nga komunat Kastriot dhe bashkia e Peshkopisë, që aktualisht administrohen nga PD-ja.

Protestuesit kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për ndarjen e re territoriale që sipas tyre e diskriminon ndjeshëm Dibrën dhe dibranët. Krahësuar me qarqe të tjera në Shqipërinë e Mesme apo atë të Jugut, diskriminimi bëhet evident, pasi edhe pse Qarku i Dibrës ka një sipërfaqe shumë më të madhe, ka mbetur vetëm me 3 njësi vendore, thanë oratorët që morën fjalën në këtë protestë. Po kështu edhe Maqellara duhet të mbetet njësi administrative më vehte, thanë ata, edhe për shkak të pozicionit gjeografik strategjik pasi është dhe mbetet një nyje e rëndësishme lidhëse me Dibrën e Madhe dhe më gjërë. Dibrës si përherë po i bëhen shumë padrejtësi pasi shihet me syrin e njerks, siç edhe ka ndodhur me ndërtimin e Rugës së Arbërit, e braktisur nga qeveria që iku, por e harruar edhe nga premtimi i bujshëm për ndërtimin e saj nga qeveria e re e Rilindjes, thanë në fjalën e tyre protestuesit. “Me këtë ndarje komuna jonë humb identitetin e saj, pasi historikisht asnjëherë nuk ka qenë në një njësi vendore apo pushteti me Peshkopinë apo komuna të tjera të rrethit Dibër, - tha Bardhyl Agolli, kryetari aktual i komunës së Maqellarës.

Foli në këtë tubim edhe kryebashkiaku aktual i Peshkopisë, Ilir Krosi, i cili ndër të tjera theksoi pakënaqësinë ndaj mënyrës së dhunshme që qeveria kërkon për realizimin e kësaj reforme. Një reformë e tillë kaq e rëndësishme nuk mund të realizohet vetëm me takime klienteliste të dyshes Rama-Meta, duke shmangur kështu në mënyrë të qëllimshme takimet e hapura me publikun, grupet e interesit dhe drejtuesit aktual në 33 njësitë vendore të këtij qarku.

HYSEN LIKDISHA

Rajoni ka nevojë për një plan zhvillimi

Nga **BUJAR KAROSHI**

Në prezantimin e projektit të “Lungomare-s”, Kryeministri Edi Rama tha në Vlorë se pas këtij projekti të tjera projekte madhore do të çelen për zona të tjera në jug. Më pas, në rrjetin social, Twitter dhe Facebook, ai shkroi se “Pas projektit të Vijës Bregdetare të VL së shpejti konkursi për projektin e integruar Vija Bregdetare e Orikumit - Parku Kombëtar i Llogorasë”. Pak orë më vonë, ai shtoi se “në shtator çelet dhe konkursi ndërkombëtar për bregun e Himarës së Re e për rehabilitimin e fshatrave të saj të bukur. Projekti RAB një bazë për programin e tij të zhvillimit ekonomik të Himarës së Rilindur nga ndarja e re territoriale”.

Menjëherë pas këtyre postimeve në rrjetet sociale, “miqtë” e Kryeministrit nxituan të kujtojnë se Shqipëria nuk është vetëm Jug. Shumë nga komentet i kujtonin Kryeministrit premtimet për Rugën e Arbërit, madje disa prej tyre e akuzojnë atë se ai e ka harruar premtimin. Disa nga komentet e shprehin hapur dëshirën që “Edi Rama të mos e mbajë premtimin”, pasi kështu ata e kanë parashikuar që në fillim se “Edi Rama nuk e do Dibër”. Dhe kësaj dëshire nuk i shpëtoi as artisti i njohur Bujar Kapexhiu, karikatura e të cilit u bë hit në rrjetet sociale këto ditë gusht.

Që para fushatës së fundit elektorale, një fushatë e gjithanshme për sensibilizimin e opinionit vendimmarrës për ndërtimin e rrugës së Arbërit nuk ka reshtur së pushuari. E zhgënjyer nga premtimet e qeveritarëve për 20 vite me radhë për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, një grup intelektualësh dibranë janë përgatitur për një ballafaqim të vazhdueshëm dhe të drejtëpërdrejtë me qeverinë shqiptare për vazhdimësinë e ndërtimit të rrugës së Arbërit.

Nuk kërkohet vazhdimi i ndërtimit, por kërkohet një këndvështrim krejt i ri i ndërtimit të saj. Të gjithë bien dakord se segmentet e ndërtuara deri më tani të rrugës së Arbërit nuk kanë asnjë standard bashkëkohor ndërtimi: janë të rrezikshme për përdoruesit e rrugës, drejtuesit dhe këmbësorët, parashikojnë shpejtësi të ulët lëvizje dhe nuk përmbushin asnjë element të sigurisë së lëvizjes.

Qëndrimi i Kryeministrit Edi Rama gjatë fushatës elektorale, në një takim me banorët e Klosit më 12 gershor 2013 se “Rruga e Arbërit është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurtton lëvizjen thjesht, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn tek projektet strategjike, që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet” - ishte një nga premtimet më premtuese gjatë fushatës elektorale. Ky qëndrim i tij nuk i përmbysi raportet elektorale në Dibër në favor të Partisë Socialiste, por pavarësisht nga kjo, një opinion qytetar më i drejtë dhe më i pavarur e vlerësuan qëndrimin e Edi Ramës si një vështrim krejt ndryshe nga çfarë ishte propaganduar. Sikur të mos mjaftonte qëndrimi në fushatë, Edi Rama tashmë e ripërsëriti premtimin e tij gjatë prezantimit të programit të qeverisë në parlament më 11 shtator 2013, ku theksoi se “Projekti i zhvillimit në infrastrukturë nis nga Rruga e Arbrit si prioritet...”.

Nisur nga ky këndvështrim për të ardhmen e rrugës, dy organizata të shoqërisë civile, pas një ekspedite në terren iu drejtuan me një letër Ministrit të Transporteve dhe deputetëve të Dibrës, me kërkesën që të rishikojnë standardin e ndërtimit të rrugës në segmentin Ura e Vashës - Qafa e Tujanit, pasi projektet e publikuara nuk premtinin një standard bashkëkohor të ndërtimit të Rrugës.

Në letër konstatohet se një pjesë e Rrugës së Arbërit është shmangur nga projekti i miratuar, duke u kthyer në një rikonstrukcion të rrugës aktuale. Gjithashtu, në letër shtrohej problemi i Tunelit të Qafës së Bualit dhe Qafës së Murrizës, i pari tentuar për të mos

Dibra nuk kërkon një rrugë, por po kërkon një ndërtim me standarde bashkëkohore të saj, në mënyrë që të shndërrohet në një çelës për investimet në rajon, që nga bujqësia, blegtoria e frutikultura deri të investimet në industri, miniera, ujëra, turizëm. Dibra ka nevojë për një plan strategjik zhvillimi që të shohë në 50 a 100 vitet e ardhshëm, dhe jo të zgjedhjet e afërta lokale apo ato të radhës parlamentare.

u ndërtuar, ndërsa i dyti ndryshuar projektin duke ulur gjatësinë e tij, me argumentin “se ka dalë uji”.


Gjithashtu, në përpjekjet për të vendosur për herë të parë një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe qeverisë, u bënë përpjekje për të takuar Kryeministrin Rama dhe, krahas dorëzimit të vullnetit të qytetarëve për një ndërtim sa më të shpejt dhe me standarde të rrugës, synohej edhe vendosja e një koordinimi të përbashkët në këtë proces.

Shqetësimi kishte të bënte kryesisht me rolin e shoqërisë civile për të ndjekur me rigorozitet progresin e Qeverisë për të mbajtur premtimin elektorat për ndërtimin e Rrugës së Arbrit si dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve që do të akordoje Qeveria për këtë projekt, në mënyrë që ato të mos keqmenaxhohen, siç ka ndodhur deri më tani me këtë projekt.

“Në takimin me Ju dhe në bisedat që do të zhvillojmë në studio me disa televizione dhe me ente të tjera mediatike në Tiranë dhe jashtë Shqipërisë do të kërkojmë depolitizimin e çështjes së ndërtimit të Rrugës së Arbrit, në mënyrë që theksi të vihet në rëndësinë e këtij projekti në planin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ne kemi ndjekur me interes dhe jemi të kënaqur nga prononcimet që Ju dhe drejtues të tjerë të mazhorancës, si gjatë edhe pas zgjedhjeve të qershorit, kenë bërë në lidhje me rëndësinë strategjike që ndërtimi i Rrugës ka për ekonominë e vendit dhe përmirësimin e infrastrukturës midis Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës dhe Bullgarisë, duke mundësuar integrimin e mëtejshëm të kësaj pjese të Ballkanit në Evropë”, - shkruhej në një nga letrat e drejtuar Kryeministrit nga njëri prej anëtarëve të grupit të intelektualëve dibranë, duke shprehur edhe bindjen se takimi me ishte një rast i shkëlqyer për një dialog konstruktiv dhe mirëdashës midis Kryeministrit të Shqipërisë dhe përfaqësuesve të intelektualëve dibranë.

Takimi nuk u realizua, por gjatë takimeve me Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe debateve në tryezat e rrumbullakëta në Tiranë dhe Peshkopi, u vu re se një nga pengesat kryesore në ecurinë pozitive të çështjes kanë

Që para fushatës së fundit elektorale, një fushatë e gjithanshme për sensibilizimin dhe opinionit vendimmarrës për ndërtimin e rrugës së Arbërit nuk ka reshtur së pushuari. E zhgënjyer nga premtimet e qeveritarëve për 20 vite me radhë për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, një grup intelektualësh dibranë janë përgatitur për një ballafaqim të vazhdueshëm dhe të drejtëpërdrejtë me qeverinë shqiptare për vazhdimësinë e ndërtimit të rrugës së Arbërit.



Karikaturë e Prof. dr. Bujar Kapexhiu (Mjeshtër i Madh), kushtuar si një thirrje proteste dhe alarmi për ndërtimin sa më shpejtë dhe mbajtjen e premtimit për Rugën e Arbërit, botuar në gazetën MAPO, date 19 gusht 2014

të bëjnë me mungesën e financimit.

Disa negociata për këtë projekt kanë vazhduar gjatë vitit dhe pritet të vazhdojnë, por që nuk kanë dhënë rezultat.

“Jemi në negociata me disa vende dhe sinjalet duken pozitive, por të shohim se çfarë do të ndodhë në përfundim të negociatave”, - iu përgjigj një pyetje Kryeministri Edi Rama gjatë një komunikimi online me qytetarët në mes të gushtit.

“Rruga e Arbrit është një nga kontratat e lëna hapur nga qeveria e mëparshme, - thotë ai. Deri tani janë ndërtuar rreth 26 km nga Bulqiza deri tek Ura Çerenecit. Në proces ndërtimi janë edhe 19 km të tjera. Mbetet për t’u ndërtuar pjesa më e vështirë 27 km, tuneli Qafë Murriz-Ura e Vashës, me vlerë 290 milionë USD, për të cilën, thekson ai “kanë filluar negociatat me partnerë të interesuar për marrjen me koncension të këtij segmenti, për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tij.”

Dhe kjo është një përgjigje që nuk i kënaq dëshirat tona. Jo vetëm se është një kthim mbrapa nga premtimet e tij elektorale, por është edhe një vështrim i vjetër për rrugën, me të cilën jemi mësuar 20 vjet me radhë.

ÇFARË PRESIM NGA KRYEMINISTRIT?

Duke qenë të ndërgjegjshëm se riviera shqiptare ka nevojë vërtet për një plan zhvillimi, po për të njëjtat arsye edhe Dibra ka nevojë për një plan strategjik zhvillimi. Ashtu si projektet që presin të studiohen nga Vlorë në Sarandë, edhe për Dibër presim projekte që fillojnë nga Tirana në Klos, Burrel, Bulqizë e Peshkopi, pse jo edhe matanë kufirit.

Dibra ka nevojë për një plan zhvillimi të bujqësisë, të sistemit të vaditjes, kulturave bujqësore të përshtatshme për mjedisin dhe të vlefshme për tregun.

Dibra ka nevojë për një plan zhvillimi të blegtorisë, frutikulturës, zhvillimit të kultivimit të bimëve mjekësore.

Dibra ka nevojë për një plan strategjik për ruajtjen, shfrytëzimin dhe rigjenerimin e pyjeve e kullotave.

Dibra ka nevojë për plan investimesh në industrinë e kromit, në kërkimin dhe shfrytëzimin e vendburimeve të reja jo vetëm të kromit, por edhe të mineraleve të tjera si manganit, hekurit pa nikel, bakrit apo edhe mineraleve e shkëmbinj industriale jo metalore, shumë të rëndësishëm për ekonominë e tregut si: gurët dekorative, shkëmbinj të gëlqerore, të gipseve e anhidriteve, argjilat, bojërave të dheut etj.

Dibra ka nevojë për një plan zhvillimit të burimeve ujore të freskëta, squfurore, për të pirë, por edhe për prodhimin e energjisë.

Pra, Dibra nuk kërkon një rrugë, por po kërkon një ndërtim me standarde bashkëkohore të saj, në mënyrë që të shndërrohet në një çelës për investimet në rajon, që nga bujqësia, blegtoria e frutikultura, deri të investimet në industri, miniera, turizëm etj. Dibra ka nevojë për një plan strategjik zhvillimi që të shohë në 50 a 100 vitet e ardhshëm dhe jo të zgjedhjet e afërta lokale apo ato të radhës parlamentare.

Financimi i Rrugës së Arbërit është vetëm një çështje, që edhe pa planet e mësipërme të zhvillimit, nuk është vështirë të gjenden, por me krijimin e hapësirave për të investuar në fushat e mësipërme, gjetja e parave për rrugën do të jetë çështja më e lehtë.

Duke parë se planet e pjesshme të zhvillimit nuk kanë dhënë rezultat në zona të ndryshme të vendit, dibranët e kanë konsideruar çështjen e Rrugës si një çelës magjik për investime në të gjitha fushat, kështu që çdo plan i shpejtë strategjik zhvillimi për rajonin, do ta lehtësonte dukshëm gjetjen e investimeve për rrugën.

Emri Lurë përmendet që në shekullin II p.e.s. nga Polibi...

Lura ka bukuri të rrallë. Liqenet i japin pamje madhështore dhe tërheqin mjaft turistë të huaj. Liqeni i Luleve është më i bukuri dhe me histori të rrallë. Zambakët që rriten janë të lidhur me legjendat për trimëritë e lurjanëve në shekuj. Lura është perla e maleve tona, por nga Lura kanë dalë burra që kanë kontribuar në historinë e vendit tonë. Është koha për të kontribuar për Lurës si vend turistik.

Nga **DEDE LLESH DOÇI**

Është zonë malore që shtrihet nga 595 m deri në 2121 mbi nivelin e detit ka shumë male me pyje të dendura e shumë lloj drurësh.

Lura ka këto fshatra: Fushë-Lura, Lura e Vjetër, Borie-Lura, Arthi, Gjer-Lura, Krejë-Lura, Pregjë-Lura, Vlashej, Arrëmolla dhe Sumej.

Tre fshatrat Lurë e Vjetër – Fushëlurë e Borie Lurë janë rreth 1040 m mbi nivelin e detit. Malet e Lurës janë Runja, Rroveshi, Bakullena, Nezha, Pllau, Kështemi, vargu i buzës së Breshtës. Lura shtrihet në gjerësinë gjeografike 41 gradë e 40” dhe në gjatësinë gjeografikë 29° e 19’.

Emri Lurë përmendet që në shekullin II p.e.s. nga Polibi. Për lashtësinë mbështetja qëndron së pari në rrënojat, së dyti në historinë e studiuesit si Herodoti, Polibi, Mark Skura, Shtjefën Gjeçovi etj.

Në periudhën e Skënderbeut edhe lurasit kanë kontribuar. Lurasit kanë vajtur në ndihmë të Skënderbeut në Kalanë e Stelushit, për këtë u ngeli “xhypt e Skënderbeut”. Në pushime Skënderbeu dërgonte ushtrinë në Lurë edhe problemet e ndryshme e zakone të diskutonte me burrat e dheut në Lurë. Skënderbeu, thoshte për vrasjet, duhet vlarë vetëm dorësi, ndërsa Leka Dukagjin kishte mendimi ndryshe.

Lidhjen me Skënderbeun për Lurën e tregojnë dhe toponimet, p.sh. dybeku i kafes së Skënderbeut një gur i sheshtë me një gropë në mes. Në Sheun e Thatë ndodhet kalaja e Skënderbeut dhe në anën tjetër Karakolli i Skënderbeut ka gojëdhëna për fluturimin me kuaj nga Guri i Kuq në Qafë-Lurë ku është një gur duket gjurma e kalit,dhe doli një.

Në defterin turk Lura del më 23 shtëpi në vitin 1467. Guri me katër shtëpi dhe Pregja me dhjetë shtëpi. Pushtimi i gjatë turk i shkaktoi prapambetje të theksuar vendit tonë. Sipas historisë më 1432 territori i Sanxhakut të Shqipërisë u nda në 335 timare që iu dhanë zotëruesve feudalë.

Si në Dibër edhe nga Lura ka patur përpjekje për gjuhën etj.

Në lidhjen shqiptare të Prizrenit kanë marrë pjesë nga Lura Kol Bib Doçi, Hasan Kaci, Ali Mena etj.

Lura është mal më vete dhe nuk futet në nëntë malet e Dibrës por me të Gegërisë. Lura ka luftuar kundër shovinistëve serbo-malazes. Beteja e Kariqit, Lura printe si bajrak i parë. në vitin 1916 u bë masakra e Lurës: 108 luras të pafajshëm. Të parët Kolë Bib Doçi etj. Lura ka dy fe myslimanë e katolikë.

Në vitin 1878 lurasit i drejtojnë memorandum



Kongresit të Berlinit për autonomi nën kryesimin e Preng Bibë Dodës, të cilën e refuzoi Berlioni më 5 korrik 1878. Lura kontriboi në shpalljen e pavarësisë Nikoll Kaçorri, nënkryetari i qeverisë së Ismail Qemalit i cili tha nëse do vdesim nesër më mirë sot dhe u ngrit flamuri më 28 nëntor 1912.

Periudha e regjimit të Ahmet Zogut ishte një shkëlqim dhe për Lurën. Zabiti i Lurës, Zef Bib Doçi dhe Halit Mena, bajraktari ishin të lidhur me Zogun, Zef Doçi disa vite krahinar i Lurës, ndërsa Hakik Mena ishte mik i Zogollit. Edhe në dasma te Zogolli Zef Doçi krushk i parë.

Gjatë pushtimit fashist nga Lura u internuan Zef Doçi, Hakik Mena, Dalip Kaci, Ibrahim Gjeçi, Met Hoti. Zef Doçi vdiq në Tiranë në internim më 1941. Gjatë luftës Nacionalçlirimtare Lura dha heroin e popullit Gjokë Doçin, dëshmorët Ali Çupi e Dylejman Skura. Ndiheuan luftën shumë luras.

Në vitin 1944 u strehuan shumë partizanë në Lurë, në shtëpinë e Gjon Bib Doçit ishin rreth 80 partizanë. Në Lurë u bë mbledhja e dheut dhe i dha besën frontit nacionalçlirimtar. Por çlirimi i vendit u bë në Lurë me dhimbje dhe kundërshtime nga njerëz që nuk e donin komunizmin. Në Lurë bëhet mbledhja e krerëve në zbatim të mbledhjes së Mukjes. Në Lurë morën pjesë krerë të rëndësishëm të Shqipërisë si Medi Frashëri, Hysni Dema, Muharrem Bajraktari e shumë nacionalistë nga tërë Shqipëria. Nga Lura ishin Menet, Doçët, Hoti etj.

Regjimi komunist dogji dhe vrau familjet e parisë, u vranë 11 Mene, u vranë 2 Doçe, pothuaj nuk mbeti fis pa u dënuar si Rajtet, Gjoçet, Bruçi, Xhoxhegjet, muratet, Hoti, Kaci, Buci, Vladët etj. U burgosën shumë Luras. Llesh Bib Doçi, në momentet e fundit të jetës ka thënë: “Kush të rrojë, torturat e komunizmit, të mos i harrojë”. Këtë amanet e dëshmojnë ish të burgosurit e vitit 1946.

Sistemi komunist prishi gjithçka në Shqipëri e Lurë. Me idenë e edukimit të njeriut të ri, si sistem çrrënjosi gjithçka që ishte kultivuar më parë dhe vendosi normat e moralit komunist që ekzistonte ideja asgjë për vete por për të përgjithshme.

Varfëria arriti kulmin në Lurë në kohën e kolektivizimit të bujqësisë. Shfrytëzimi i njerëzve, zhdukja e pronës dhe lufta e klasore e bënë të padurueshme jetën, shumë njerëz u detyruan të largoheshin dhe të merrnin kurbetin. Nga Lura gjatë regjimit komunist pati të pushkatuar dhe të burgosur pothuaj të gjitha ato familje që ishin të zhvilluara. Lufta e klasave bëri kërdinë sidomos për disa familje.

Lura që kishte tradita të shkëlqyera vuajti. Por ardhja e demokracisë, rrëzimi i pushtetit të komunistëve solli një jetë të re. Njerëzit morën pronën e tyre, toka e tyre, u bënë zot të vetes, të lirë për të jetuar kudo. U hap perspektiva e jetës dhe pothuajse për një kohë të shkurtër jeta ndryshoi, njerëzit fituan lirinë dhe menduan të krijojnë një jetë të re, u hoq radha për çdo gjë dhe listat, u krijua tregu i lirë dhe jeta ndryshoi.

Edhe në Lurë jeta ndryshoi, u rivendos rregulli dhe respekti i zakoneve të mira të të parëve. Fiset trashëguan të drejtën zakonore dhe rikthyen si dikur vetëqeverisjen. Lura i ruajti 12 pleqtë duke aktivizuar trashëgimtarët e tyre. Lura ruajti kararet dhe normat, Lura respektoi Teqen e Murat Dedes dhe kishën katolike. Sot njerëzit jetojnë më mirë.

Po të hedhim një vështrim historisë në ngjarjet e viteve '30 të shekullit 17 në zonat sidomos në Lurë del se për Lurën ishte prijës Llesh Nikoll Doçi. Në atë kohë pushtuesi turk do t'i martonte me vajza shqiptare.

U mblodhën dibranët (zona e Çidhnës dhe e Kastriotit). Llesh Nikoll Doçi tha që në vend të nuseve do të dërgonin një mijë luftëtarë. Treqind djem do të vinin duvakë si nuse, treqind të tjerë do të tërhiqnin kuajt, treqind të tjerë do t'u rrinin në anën e djathtë nuseve, ndërsa 100 vetë do të ishin si miq të nderuar. Ishte caktuar dita dhe ora e dasmës. Në krye Llesh Nikoll Doçi, pastaj Jovan Noka dhe i treti Pal Kastrioti. Në këtë moment thërret Llesh Nikoll Doçi “Për hajr miqësia” dhe plasi lufta Fusha e Kastriotit u mbush me gjak, ajo u tha dhe quhet Fusha e Thatë.

Kështu që zgjuarsia e Doçit të Lurës e mbyti në gjak ushtrinë e Selim Pashës. Në Lurë bashkëjeton në mënyrë të përsosur feja, myslimane e të krishterë në harmoni të plotë dhe në disa raste edhe në një familje. Në familjen e Ali Haziz Doçit në kohën e ramazanit përgatitjen e ushqimit për syfyr e bënte e krishtera Mrikë Ndreca Doçi, ajo pothuajse për 30 vite u shërbente myslimanëve në netët e muajit të madhërueshëm të Ramazanit. Këtë shembull e ka përsëndetur dhe Sheh Murati i Cerenit, një figurë shumë e madhe dhe e nderuar në zonën e Lurës.

Lura ruan kararet edhe sot:

Nuk vihet zjarri në shtëpi, kasolle, stan e deri në barrë dur.

Djali po nuk vu armë nuk vritet për gjak.

Gruaja nuk vritet për gjak.

Hyzmeqari nuk vritet për gjak.

Nuk mund të qëllosh kur ka gra e fëmijë, brenda apo jashtë.

Pleqëria e Lurës ishte e ndarë në këtë mënyrë:

Doçi (zabit) e plak

Pleqtë e tjerë: Vladi (dy)

Ajazi, Haldeda, Mena, Përleka, Gjoçi, Skana, Nezha, Kaci, Xhexhegja.

Mena gëzon titullin bajraktar.

Dheu përbëhet nga gjithë populli:

6 dhetarët zgjidhen për probleme të veçanta, kur merret mendimi për zbatimin e vendimeve të pleqve.

Fiset në Lurë ndahen në grupe:

Doçe, Ajaz, Haldeda, Bushkala, Merkola, Nikolli, Bibçupi, Gjikota (Duka i mbështetur jo fis)

Tollët, Mena, Buci, Përleka, Koçeku, Cuku, Butalli.

Vladët, Peka, Marlleshi, Gjoçi, Rajta, Skana, Koçeku.

Guri i Lurës, Nezha, Xhexhegja, Murati, Deda, Kalia, Kallaba.

Borie Lura: Kaci, Hoti, Loka, Bruçi, Dedgjini.

Lura ka bukuri të rrallë. Liqenet i japin pamje madhështore dhe tërheqin mjaft turistë të huaj. Liqeni i Luleve është më i bukuri dhe me histori të rrallë.

Zambakët që rriten janë të lidhur me legjendat për trimëritë e lurjanëve në shekuj. Lura është perla e maleve tona, por nga Lura kanë dalë burra që kanë kontribuar në historinë e vendit tonë. Me të drejtë thuhet se kush njeh Lurën, njeh historinë shqiptare.

Është koha për të kontribuar për Lurës si vend turistik. Lura ka trashëgimi të lartë. Për të gjitha vlerat është mirë dhe e drejtë dhe për historinë që ka, duhet të mbetet bashki turistike me vlera të larta kulturore.

Lura shtrihet në veriperëndim të Dibrës, ka një sipërfaqe prej 125.5 km2. Tani ka një popullsi prej rreth 1700 banorë. Lura ka qenë qendër krahine e qendër komune nga 1929-1947 kur u bë lokalitet. Në vitin 1912 u bë këshilli i bashkuar.

Në vitin 1912 u hap shkolla e parë shqipe me mësues Kolë Bib Doçin. Më 1947 u hap shkolla e pasçlirimit.

Spitali në Lurë u ndërtua më 1970.

Lura u elektrizua më 1970 (11 tetor).

Lura ka 5 shkolla fillore, shkollë 9-vjeçare e të mesme në qendër. Nga viti 1993 Lura është qendër Komune nga Lura, janë arsimuar djem e vajza dhe shërbejnë kudo në atdheun tonë në sektorë të ndryshëm. Figura të dalluara në arsim e shëndetësi në Lurë janë: Kasem Hoti, Sali Ajazi, Ndrec, Vladi e Preng Doçi etj.

është koha për t'u pajtuar...

KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com

vetëm
600 lekë
në vit

intervistë

Intervista me ish sportisin e Korabit, Shpëtim Toska, është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të gazetës "Rruga e Arbërit" me faqen sociale në FB "Peshkopi, Dibrë, Albania". Ajo do botohet edhe në faqen në internet <http://peshkopidiberalbania.wix.com>.

Bisedoi: SASHENKA NDREKA

- Ju jeni cilësuar si futbollisti më i mirë dibran i gjithë kohërave. Si ka nisur kjo karriera e madhe në një qytet të vogël?

- Që në moshën 12 vjeçare loznim në fushat e lagjes. Nga këto fusha u hapën klasat sportive. Aty u përzgjedha për një spartakjatë në Durrës, ku zura vendin e nderit.

Në këtë aktivitet u përzgjedha si lojtar pranë skuadrës së të rinjve të Korabit. Atë vit Korabi doli në kategori të parë. Që aty nisi karriera si futbollist me të rriturit e Korabit, ku për 9 vjet rresht pretendonim të lëviznim nga kategoria e dytë në të parën. Gjatë kësaj periudhe me pasion të madh kam punuar gjithë kohës jashtë stërvitjes.

- Mund të sillni për lexuesin kujtimet e ndeshjes së parë të rëndësishme për karrierën tuaj, si dhe emocionet e golit të parë?

- Në moshën 17 vjeçare u aktivizova në grumbullin e kategorisë së tretë në Shijak, ku u përballëm me Krujën.

Arrita të shënoj një gol, që na kualifikoi për në kategori të dytë. Ndër 280 gola që kam realizuar në karrierën time, ky është goli që më ka dhënë emocionet më të veçanta.

- Keni ndërprerë karrierën futbollistike për shkak të një dëmtimi në këmbë. Si e pritët lajmin që ju nuk mund të luanit më?

- Gjatë e karrierës futbollistike kam patur jo vetëm fitore, por edhe dëmtime. Në një ndeshje kupe me Vllazninë e Shkodrës theva këmbën e djathtë. Për tre muaj prita rigjenerimin e këmbës. U ktheva përsëri pas tre muajsh me Korabin, por s'isha më i njëjti.

- Ju kanë kërkuar në formacionin e tyre skuadra me emër, shqiptare dhe ato të vendeve fqinje. Pse nuk e tradhëtuat asnjëherë Korabin?

- Në periudhat e sistemit komunist ndikonte ana biografike në karrierë. Gjatë kësaj kohe kam qenë afruar me Dinamon, Partizanin etj. Për arsye biografike më kthenin përsëri me Korabin. Pastaj me ardhjen e demokracisë, në vitet '92-'94, u aktivizova pranë ekipit të Korabit të Dibrës së Madhe në Maqedoni.

- Nëse do mundnit të kthenit kohën mbropa, çfarë do të ndyshonit?

- Për shkak të problemeve në biografi në sistemin e atëhershëm nuk m'u lejua të ndiqja arsimin e lartë. Po të mundja të ktheja kohën mbropa do bëja të pamundurën që të mbaroja universitetin.

- Pas aksidentit që ju largoi nga futbolli, ç'drejtim mori jeta juaj profesionale? Me ç'merreni aktualisht?

- Pas futbollit jam marrë me biznesim tim privat dhe kam trajnuar ekipin e Korabit për futboll. Aktualisht jam zëvendës trainer i Korabit.

- Cili është vlerësimi juaj për gjenden aktuale të skuadrës së Korabit?

- Ekipi i Korabit ka si lojtarë djem shumë të rinj në moshë, ku mosha mesatare është 18 vjeç. Pavarësisht nga mosha i japin një vlerësim maksimal stërvitjes. Në krahasim me punën që bëhet me ekipin e Korabit futbollistët nuk shpërblehen aspak. Mbase kjo ka ndikuar që Korabi të jetë në mes të tabelës.

Talentet në futboll shfaqen në fusha, jo në salla interneti



Për shkak të problemeve në biografi në sistemin e atëhershëm nuk m'u lejua të ndiqja arsimin e lartë. Po të mundja të ktheja kohën mbropa do bëja të pamundurën që të mbaroja universitetin.

Ndër 280 gola që kam realizuar në karrierën time, goli i parë kundër Krujës më ka dhënë emocionet më të veçanta.

- Nga eksperiencia juaj e konsiderueshme në fushën e futbollit, cili mendoni se do ishin pikat kyçe që do mund të shpëtonin sportin dibran nga venitja që po pëson vitet e fundit?

- Që të arrish të krijosh gjenerata të ndryshme të futbollit duhet patjetër të kesh fusha të vogla pranë lagjeve ku fëmijët të mund të shpëputen nga interneti dhe teknologjia e të shfaqin talentet e tyre në

fusha të ndryshme të sportit. Gjithashtu, hapja e klasave sportive në shkollë, gjë të cilën na e kanë premtuar dhe shpresojmë të realizohet së shpejti, është një faktor kyç në zhvillimin e sportit.

- Djali juaj po ecën në hapat e tu, ishte dëshira juaj, apo zgjedhja e tij personale?

- Ishte dëshira e tij personale. Talenti nuk dhurohet, nuk fitohet por lind me personin. Por që të shfaqet ky talent duhet shumë punë. Besoj vetëm në këtë pjesë mund të jetë shtypa ime.

- Çfarë mesazhi do ju drejtoje të rinjve të apasionuar pas sportit?

- Për sportistët e rinj, sa më shumë vullnet, punë e palodhur dhe stërvitje.



Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearbërit@gmail.com >

Mes veteranëve dhe pasardhëseve të Brigadës së XVIII Sulmuese

reportazh

Nderimi për ata që dhanë jetën

Nga FAIK XHANI

D ata shënon 22 gusht 2014. Nga Tirana nisen për Sllatinë të Dibrës 80 partizanë e pasardhës veteranësh për të festuar bashkërisht 70-vjetorin e formimit të Br. XVIII S dhe çlirimin e Peshkopisë. Në krye ish-partizani i kësaj brigade me kontribute të veçanta, ushtaraku i nderuar Selim Pira. Ai e ka të 15-tin përvjetor që kryeson dhe drejton së bashku me grupin e punës me përfaqësues nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Shqipërisë.

TE URA E TOPOJANIT

Kur ora shënonte 13 u ndodhëm pranë Urës së Topojanit. Ajo qëndron mbi lumin Drin, pikërisht në atë pikë ky lumi futet në kanionet e ngushta dhe të bukura të Topojanit e Hoteshit derisa del në Katundin e Ri të krahinës së Luznisë. Tek përfundon ura, në të majtë të saj, ngrihet një lapidar kushtuar përpjekjeve të partizanëve të çetës së Dibrës të udhëhequr nga Heroi i Popullit Haxhi Lleshi, në shtatorin e vitit 1942. Është ndër aksionet e para kundër fashistëve Italian. Përpjekjet qenë të ashpra. Ndërsa forcat partizane u sulën furishëm mbi armikun, atij i vijnë përforcime të shumta. Partizanët luftuan me heroizëm të rrallë. Në përpjekjet e fundit, para tërheqjes plagoset edhe komandant Haxhi Lleshi. Ai për dy javë rresht u strehua në familjet e fshatit Shpukth, një fshat që ka qenë bazë e LNÇL.

Në këtë vend, ku u end lavdia dhe heroizmi u pritëm me shumë entuziazëm e hare. Tingujt e një orkestre me lodër e cule gjëmonin e jehonin gjithë trevën. Urimin e mirëseardhjes na e bënë përfaqësuesi i komunës Maqellarë z. Mehdi Shehu, kryetari i komitetit të Veteranëve të Dibrës z. Ilmi Cani dhe ai i Maqellarës z. Xhevat Dani si dhe disa ish-partizan të Br. XVIII dhe veteranë e pasardhës veteranësh të Dibrës.

Pranë këtij lapidari folën z. Selim Pira dhe z. Medi Shehu, i cili i ftoi të pranishmit për t'u çlodhur e për të pirë një kafe në qendrën e Maqellarës.

Në këtë përvjetor nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe Emin Lleshi e Nazmi Kurtishi përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Dibrës së Madhe, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, pinjoll i derës së Lleshajve, Asllan e Hazis Keta, Ymer Berexha, Shefki Lleshi etj. Pas disa bisedave në kujtim të luftës së partizanëve të Dibrës dhe historisë së lavdishme të Br.XVIII S autokolona e makinave dhe autobuzave ndaloi në qendër të Maqellarës, ku u pritën me lodër e cule, këngë e valle dhe me plot përzemërsi e bujari.

Tingujt e një orkestre me lodër e cule gjëmonin e jehonin gjithë trevën. Urimin e mirëseardhjes na e bënë përfaqësuesi i komunës Maqellarë z. Mehdi Shehu, kryetari i komitetit të Veteranëve të Dibrës z. Ilmi Cani dhe ai i Maqellarës z. Xhevat Dani si dhe disa ish-partizan të Br. XVIII dhe veteranë e pasardhës veteranësh të Dibrës.



Prane lapidarit te brigades 18 S ne Sllatine 23 gusht 2014

MAQELLARA E DIBRËS STACIONI I DYTË I MIKPRITJES DIBRANE

Maqellara kishte marrë pamje festive. Kudo ndihej atmosfera e festës. Pushimi u bë në lokalin “Rexha” me pronar Xhevat Rexhën. Të pranishmit i përshëndeti dhe i pritën: sekretaria e përgjithshme e Prefekturës z. Donika Hyseni, Medi Shehi përfaqësues i komunës dhe kryetari i veteranëve për Maqellarën Xhevat Dani.

Afro një orë mjediset e këtij lokali gjëmuar nga vallet dhe këngët. Qe një atmosferë shumë e ngrohtë miqësore, me njohje, përshëndetje e çmallime.

Një pjesëz kujtese e homazhi për kontributin që ka dhënë edhe Maqellara e Dibrës në Luftën NÇCL. Kjo trevë i dha luftës 70 partizan dhe 18 Dëshmorë të Atdheut.

Nën tingujt e orkestrës me lodër e cule dhe këngës së Elez Isufit kolona vazhdoi rrugëtimin drejt Peshkopisë.

EDHE MELANI BËRI TË VETEN

Edhe Melani ishte në festë. Banorët e komunës, veteranë e pasardhës kishin dalë me na prit. Mandej dëshironin të na mbanin siç ishim për darkë, por agjenda nuk na premtonte. Përfaqësues të komunës si dhe të organizatës së veteranëve të Luftës të kësaj komune, kryetari Irfan Fida na uruan mirëseardhjen si dhe shtruan një koktejl për të pranishmit. Edhe Melani bëri të veten, rrezatoi një pjesëz të mikëpritjes e bujarisë së Dibrës.



Prane varrezave te deshmorëve, dibrë 2014

NË PESHKOPI, PARA BUSTIT TË ELEZ ISUFIT

Sapo lëmë pas kodrat e veshura me pemë frutore të Trenës, karburantin dhe kthesën e madhe para nesh shpaloset qyteti i bukur i Peshkopisë. Kalojmë nëpër Dëbrovë, lagje e qytetit Peshkopi, ku dikur ishte fusha e Sportit dhe ekipi i “Korabit” trondiste edhe skuadrat më me zë të vendit tonë. Tashmë kjo lagje e qytetit ka ndryshuar plotësisht. Është zmadhuar e zbukuruar, janë bërë shumë ndërtime të bukura, janë asfaltuar rrugicat dhe ka shumë gjallëri, thuajse është ngrit një Peshkopi e dytë. Kalojmë Përroin e Llixhave, godinën e dikurshme me shumë zë “Vapori”, njësi e tregtisë, kati i parë Mapo dhe kati i dytë Bar-Restaurant, sheshin me mizërinë e mjeteve dhe njerëzve dhe nga e djathta njësitë e shërbimit të tregtisë e banesat që vijnë shkallë-shkallë shpatit, ngjisim maloren dhe futemi në bulevardin e bukur të kësaj qyteze, ndalojmë përballë godinës së Prefekturës dhe pranë bustit të Elez Isufit.

Sekretaria e kësaj prefekturë z. Donika Hyseni, një zonjë plot përkushtim e mençuri na shoqëroi gjatë gjithë intinerarit dhe tani në shtëpinë e saj, përshëndeti të pranishmit. Ajo përcolli konsideratat më të larta për ata që kontribuan për lirinë dhe çlirimin e vendit. Gjithashtu gjatë fjalës saj theksoi: “Institucioni i Prefekturës vlerëson dhe nuk harron kontributin e të rënëve për lirinë e atdheut. Ai përgëzon të gjithë ju partizanët, veteranët dhe pasardhësit

Institucioni i Prefekturës vlerëson dhe nuk harron kontributin e të rënëve për lirinë e atdheut. Ai përgëzon të gjithë ju partizanët, veteranët dhe pasardhësit që ruani me fanatizëm amanetin e traditat e tyre. Nderon dhe përulet me respekt ndaj dëshmorëve të atdheut. Sakrificat dhe gjaku i tyre nuk harrohen.

që ruani me fanatizëm amanetin e traditat e tyre. Nderon dhe përulet me respekt ndaj dëshmorëve të atdheut. Sakrificat dhe gjaku i tyre nuk harrohen. Institucioni ynë shpërfill të gjithë ata që baltojnë Luftën Nacionalçlirimtare, sakrificat supreme dhe gjakun e të rënëve për lirinë e begatinë e Shqipërisë.”

Për kontributin e dibranëve që morën pjesë në Br. XVIII foli ish-partizani Selim Pira. Në emër të familjeve të Dëshmorëve të Atdheut përshëndeti z. Ilir Shkëmbi. Sheshi i qytetit Peshkopi ushtoi për disa minuta nga këngët dhe vallet. Për çudi, banorët e qytetit të Peshkopisë nuk ishin në Shesh.

Drejtuesit e Bashkisë mungonin. Aty vendin e haresë e kishte zënë muzgu. Vetëm të ardhurit nga Tirana e zgjuan Peshkopinë dhe i dhanë peizazhin e festës. S’e kuptojmë pse Dibra e bashkuar historikisht, ndahet në kohën moderne, kur Shqipëria pret t’i bashkohet familjes europiane? Na duken element anakronik me rrënjë atavizmash bajraktariste, që nuk i shërbejnë as demokracisë së vërtetë dhe as vlerave të mëdha e të ndritura të Dibrës e dibranëve.

Pastaj nën valëvitjen e duarve dhe tingujve të orkestrës u përçollëm në drejtim të Slllovës. Teksa ndjekim rrugëtimin nëpër rrugën e re të bërë rishtas, të shtruar me asfalt, vështrojmë peizazhin mahnitës nga ku duket sikur prek qiellin maja e Korabit, Grama gëlqerore, maja e Pepenikut, ndërsa fshatrat shtrihen radhë-radhë nga Tomini, Pilafe, Kastrioti, rrëzë maleve: Dipjaka, Venisht, Sllatina e më tej qendra e komunës, Slllova me fshatrat për rreth: Vleshë, Kall e Radomir. Janë sektori i fshatrave malore nga ku janë zhvilluar dhjetëra beteja nga partizanët e Br. XVIII S.

Krenar qëndron Venisht, ku më 18 qershor 1944 formohet Këshilli NÇCL i qarkut të Dibrës, i cili zhvilloi një punë shumë të dendur dhe konkrete si për banorët e kësaj treve ashtu edhe për mbështetjen e luftës me luftëtarë dhe me gjithçka u nevojitej.

Kur po afrojmë mbërrija u ndodhëm në qendrën e Komunës Slllovë. Në Slllovën e rrethuar nga malet, me plot bukuri e pastërti, e dalluar për bujari e atdhetari. Qendra ka marrë pamje festive. Flamuj, banderola, këngë e e valle, dhjetëra makina e plot pjesëmarrës që na pritën e na uruan mirëseardhjen. Zyrtarisht pritë z. Dashuri Leka n/kryetar i Komunës Slllovë. Nën kujdesin e tij dhe të komisionit organizator u shpërndamë nëpër lokalet e qendrës të Slllovës ku na pritën me shumë respekt e bujari. Në të gjithë lokalet që pushuam na servirën sipas dëshirës kafe, pije alkoolike e lëngje frutash. Aty jo vetëm u çlodhëm, por edhe u njohëm me veprimtarinë luftarake e atdhetare të popullit të kësaj treve nga thellësitë e shekujve.



Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës vlerësoi me titullin e lartë “Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ”: z. Imer Pira, Liman Gjoni, Xhevat Dani dhe Halil Tupen.

për çlirimin e atdheut është legjitim

Veçanërisht ndaj pushtuesve turq, serbë dhe nazi-fashistë, ku populli i Sllovës dhe i fshatrave përreth ka mbajtur një peshë të madhe dhe ka qëndruar i papërkulur.

Në gjurmë të traditave të vyera të kësaj treve që edhe shpërndarja nëpër shtëpitë e banorëve të kësaj komune. Brenda një kohe të shkurtër të gjithë të pranishmit u sistemuan. Ata u pritën me shumë nderim e respekt dhe u trajtuan me shumë kujdes e bujari të gjithë të ardhurit nga Tirana.

Sllatina priti pjesën dërmuese të tyre. Emin Lleshi e Nazmi Kurtishi nga Dibra e Madhe, Asllan e Azis Keta nga Bulqiza, Enver Hasa nga Vila e Kukësit, Xhevdet Çelmeta, nip i Bab Myslimit nga Peza e Madhe, Faik Xhani nga Lisi i Matit, Hydbi Hysenllari, Vesel Mustafallari nga Skrapari dhe z. Sulejman Burgu u gjendën nën bujarinë e familjes Berexha, ku atdhetaria, bujaria dhe humanizmi ka pasur dhe kanë djepin e tyre.

Të parët e kësaj familje, Ibrahim e Tafil Berexha për rezistencën e fortë dhe mospajtim me pushtuesin u torturuan dhe u vranë nga serbët. Babai i Ilmiut dhe kushëriri i Ymerit, Selim Berexha ka qenë partizan i Br. XVIII dhe ka dhënë një kontribut të veçantë si partizan dhe si familje. Edhe nëna e tij, Fidaija ka kontribuar denjësisht për Luftën Nacionalçlirimtare. Ajo që një nën trime, një nënë burrëreshë, jo vetëm bujare, por edhe e mençur e humane, e cila që infermiera e parë, që mjekoi e shpëtoi dhjetëra partizanë të plagosur e të sëmurë. Aq punë kishte ajo sa nuk i premtonte asnjë minut kohë, prandaj që të plagosurit e të sëmurët ta kishin më të mundur lëvizjen, i fiksonte me lidhëse litari. Për nënë Fidainë bëmat s’kanë të sosur. Asaj i është kushtuar edhe një botim me titull: “Nëna e partizanëve”. E ndërsa bëmat e saj nuk mbarojnë dhe kontributi i saj është vlerësuar me dhënien e një pensioni për merita të veçanta, na lë pa mënd fakti që pranë këtij vendi, pranë kësaj shtëpie që ka strehuar e kuruar qindra partizanë e partizane nuk ka një Pllakë Përkujtimore ose aty ku i thonë “Aku i Kuq”, ku që ngritur Spitali Partizan.

E rëndësishme është se kontributi i Selim dhe Fidaie Berexhës nuk ka shkuar kot. Ai jo vetëm që është vlerësuar, por po ruhet e çohet më përpara edhe nga pasardhësit z. Ymer e Ilmi Berexha, por edhe nipat e mbesat: Ermali, Qatipi e Xhelsimja.

Është kjo traditë e bukur e mikpritjes dhe e sakrificës së të parëve që kanë bërë Ymerin dhe Ilmiun të sakrifikojnë e t’i mbrojnë më së miri, mandej edhe t’i çojnë më përpara, edhe sot në tranzicionin e brishtë shqiptar. Ymeri në Domje Tiranë e Ilmiu në Sllatinë japin shembullin më të mirë si persona dhe si familje për ruajtjen dhe pasurimin e traditave më të mira të të parëve të tyre trima e atdhetarë.

Është kjo traditë që e ka pas në themel familja Berexha që e bënë Elezin edhe pse i moshuar të mos qëndrojnë asnjë herë pa ardhur me nderuar formimin e Br. XVIII S dhe çlirimin e Dibrës.

I veçantë për kohën që po jetojmë është edhe Ilmi Berexha. Ai ka qëndruar në themelet e të parëve dhe ka ndërtuar jetën si më mirë. Ka ndërtuar banesa të reja për strehimin e familjarëve, por edhe për të prit e përcjell partizanë, veteranë e miq nga të katër anët e vendit. Së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët kanë krijuar edhe një tufë bagëtish prej 250 krerë duke dhënë shembull edhe në këtë drejtim për ruajtjen dhe mbarështimin e blektorisë së imët e sidomos, deleve. Zemra e tij është e madhe. Dëshirën e kishte t’i merre të gjithë të ardhurit nga Tirana, partizanë, veteranë e pasardhës veteranësh në shtëpinë e tij. E luti përfaqësuesin e komunës dhe i premtoi se nuk do ta zhgënjente, por vetëm 11 veta qemë miqtë e asaj nate të këndshme, që s’do ta harrojmë kurrë. Interesimi i Ilmiut që në kulm. Asgjë nuk la pa na bërë e servirur, mbi të gjitha bisedën e larmishme në evokimin



Në familjen e Ilmi Berexhes. Sllatinë, Dibër 22 gusht 2014

Në këtë shesh ngrihej një lapidar i madh, i lyer që ndriste si kristal.

Në mesin nga koka lart shkruhej: “Këtu me urdhër të Shtabit të

Përgjithshëm të Ushtrisë NÇL u formua Br. XVIII S.”

e së kaluarës së lavdishme të kësaj familjeje dhe fshatit Sllatinë, por edhe problematikat që ndeshen sot. Ai e përjeton me shumë dhimbje çdo nënvleftësim e çdo pakujdesi, qoftë të individëve të veçantë, drejtuesve vendorë, apo edhe të qeverisë e presidentit të Republikës për Dëshmorët e Luftës, Veteranët, të moshuarit, shtresat në nevojë. E pa pranueshme nga Ymeri, Ilmiu, por edhe të gjithë veteranët e familjet e Dëshmorëve të Luftës ANÇL është edhe rehabilitimi i disa figurave që jo vetëm nuk kanë dhënë kontribut për çlirimin e vendit, por edhe i janë kundërvënë fuqishëm atij duke bashkëpunuar ngushtë me armiqtë pushtues, nazifashistë.

Dielli i 23 gushtit sapo preku majat e Korabit dhe i dha dritën e ngrohtësinë e duhur edhe Sllatinës, u zgjuam. Dolëm në bahçen e bukur të Ilmiut edhe për të parë, por edhe për të thithur ajrin e freskët e të pastër të Sllatinës. Prej atje shtruhej i gjithë territori deri në malet e Arnit, Lurës, Muhrrit, Selishtës dhe Luznisë. Një gotë qumësht të ngrohtë delje dhe një kafe Dibre pimë të gjithë.

Qëndruam aty nën freskun e bujarinë e Sllatinës, zhvilluam një bisedë shumë të këndshme e të larmishme dhe nisëm rrugën për te lapidari i Sllatinës. Rrugën e bëmë në këmbë duke shijuar freskun e mëngjesit si dhe bukurinë mahnitëse të natyrës së atyre bjeshkëve. Me xha Ymerin nuk u ndava për asnjë minut. Ai ishte si një gurrë e pashtershme që për çfarë ta pyesje, ishte gati të të kthente përgjigje. Mbi të gjitha njihte shumë mirë terrenin, traditat e krahinës dhe historinë e kësaj treve. Bashkërisht qëndruam në qendër të Komunës Sllovë. Ishte dita e dytë që Sllova ishte në festë. Aty lodra e culja gjëmonte. Kënga e vallja vazhdonte pa pushim. Takime të përzemërta. Një kuriozitet i madh, për të ditur si kishin kaluar shokët tanë, kishte drejtuesi i grupit të Tiranës, biri i kësaj ane, Selim Pira. Të gjithë ishin tepër të kënaqur dhe shumë të emocionuar nga mikëpritja e bujaria e rrallë e këtyre malësorëve.

Për një moment lëmë tavolinën, vizitojmë qendrën e Sllovës. Aty ndodhen zyrat e Komunës, Shkolla e bashkuar 9-vjeçare dhe e mesme, një godinë e madhe dykatëshe dhe shumë e mirëmbajtur, një xhami e bukur, një objekt kulti me një minaret të lartë dhe të punuar me shumë shije dhe disa njësi tregtie private. Ndërsa viziton Sllovën të zë syri edhe një lapidar i punuar bukur dhe me

shije. Është mirëmbajtur si më mirë. I afrohemi dhe vëzhgojmë për disa minuta. Në krye të tij shkruhet: “Në kujtim të dëshmorëve të vrarë nga okupatori gjerman në Sllatinë më 24 nëntor 1943.” Lexojmë: Ismail R. Strazimiri, Mersim E. Ndreu, Dalip T. Corja, Telat T. Çorja, Sulejman M. Xhepa, Bijë M. Plaku, Fiqiri G. Shehu, Dije H. Shehu, Aqif Z. Gjoka, Islam Ll. Ndreu, Naxhi H. Corja, Xhavit T. Sulollari, Hysë Xh. Maliku dhe Sulejman M Dranga.

Ora shënon 10 e 23 gushtit. Lëmë qendrën e Sllovës dhe drejtohemi për tek lapidari i Sllatinës. Autokolona e makinave ndalon dhe të pranishmit i drejtohen sheshit ku është ngrit lapidari. Ishte një shesh i madh, plot dritë e bukuri që përshkohej më së miri nga dielli, mbi rrugën automobilistike.

Para nesh kishin shkuar disa vetë që merrreshin me qendrën e zërit. Brenda disa minutash sheshi u mbush plot e përplot me të ardhurit nga Tirana, Peshkopia dhe fshatrat për rreth. Këngët e vallet ushtuan. Tashmë udhëtimin dy ditor po i vinte kulmi.

Në këtë shesh ngrihej një lapidar i madh, i lyer që ndriste si kristal. Në mesin nga koka lart shkruhej: “Këtu me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇL u formua Br. XVIII S.” Ora po i afrohej 11-tës. Nis ceremonia zyrtare. Në tribunë: Prefekti i Dibrës Melaim Damzi, deputeti i zonës Ulsi Manja, Rustem Peçi kryetar i Komitetit Kombëtar të Veteranëve, Selim Pira ish-partizan i Br. XVIII dhe ushtarak i nderuar, Bukurosh Leka, n/kryetar i Komunës Sllovë, Ilmi Cani kryetar i Komitetit të Veteranëve të Luftës për rrethin Dibër, etj.

Fjalën përshëndetëse e mbajti z. Bukurosh Leka, n/kryetari i komunës Sllovë. Për evokimin e kontributit të dibranëve në luftën për çlirimin e vendit e mbajti prefekti, z. Melaim Damzi. Për kontributin dhe rolin që dha dhe luajti Br. XVIII foli z. Selim Pira-ish partizan i kësaj brigade. Ai vuri në dukje se Sllova me fshatrat përreth që e vemja zonë që u bombardua me avion. Brenda një dite u vranë 22 veta, pa folur këtu për dëmet e mëdha që u bënë në këtë trevë. Populli i Sllovës jo vetëm nuk u thye, por përkundrazi u lidh si mishi me thuan me luftën dhe shkroi faqe të lavdishme në luftë për çlirimin e vendit. Në Br.XVIII ku drejtoi biri i kësaj ane, gjeneral Dali Ndreu dhe komisari Tuk Jakova morën pjesë 1850 partizanë e partizane dhe shkruan akte trimërie e heroizmi që nuk do të harrohen kurrë.

Nga Peshkopia u ndamë me përshtypjet më të mira dhe me besimin për t’u takuar në përvjetorët e ardhshëm në Dibrën e trimërisë e të bujarisë, të asaj Dibre që nuk ka ngjarje madhore të vendit e popullit tonë që mos të ketë qenë e pranishme dhe kontributore.

Me shumë vëmendje u ndoq në këtë ceremoni përkujtimore fjala e Kryetarit të Komitetit Kombëtar të Veteranëve z. Rustem Peçi. Ai u përqendrua kryesisht në kontributin që dha Br. XVIII S , e cila ashtu si njësitë e tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare i kreu me nder të gjitha detyrat e ngarkuara. Ajo çliroi Kërçovën, Prizrenin, Peshkopinë, Dibrën e Madhe dhe Kukësin në bashkëveprim me Br.V S.

Gjithashtu z. Rustem u ndal në punën që duhet bërë për të ruajtur vlerat e Luftës Nacionalçlirimtare, të kontributit dhe veprës së Dëshmorëve të Atdheut dhe të partizanëve trima që luftuan për liri. Askush nuk duhet ta ketë për turp se mbron Luftën Nacionalçlirimtare, veprën e ndritur të Dëshmorëve të Atdheut, sakrificat e panumërta që kanë shokët tanë, prindërit tanë partizanë e partizane. Është krenari dhe vlerë të kujtosh dhe të nderosh të rënë për çlirimin e vendit. Nderimi për ata që dhanë jetën për çlirimin e vendit dhe lirinë e popullit është legjitim. Në përfundim të fjalës së tij, e cila u ndërpre disa herë nga duartrokitjet dhe ovacionet.

Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës vlerësoi me titullin e lartë “Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ” : z. Imer Pira, Liman Gjoni, Xhevat Dani dhe Halil Tupen.

Gjithashtu Komiteti i Veteranëve të LANÇ i rrethit Dibër u dha titullin: “Nderi i Organizatës së Veteranëve” pas vdekjes: Haxhi Lleshit, Shefqet Peçit dhe Esat Ndreut si dhe Selim Pirës e Shefki Devës. Gjithashtu komiteti i Veteranëve të Rrethit Dibër u dha Mesazh Mirënjohje: Ali Manjanit, Irfan Ushтеленzes, Feta Varfit, Durian Kamberit, Ramadan Dukës dhe Lavdie Gjoni.

Pas shpërndarjes së këtyre titujve e vlerësimesh autokolona u nis drejt Peshkopisë. Pjesëmarrësit siç ishin bënë homazhe pranë varrezave të Dëshmorëve.

Më pas, për të pranishmit u shtrua një drekë nga prefekti i Dibrës Melaim Damzi. Aty u bënë edhe disa përshëndetje që vlerësuan kontributin e popullit të Dibrës në Luftën Nacionalçlirimtare si dhe theksuan nevojën e bashkimit për mbrojtjen e kontributit dhe gjakut të rënëve për çlirimin e vendit dhe lirinë e popullit. Në këtë drekë punë përshëndeti prefekti i Dibrës, z. Melaim Damzi si dhe nipi i Babë Myslimit, intelektual i pezak Xhevdet Çelmeta, i cili midis tjerash vuri theksin në lidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë të Bab Myslimit me Haxhi Lleshin, të çetave respektive dhe popujve të dy krahinave. Një miqësi që sa vjen e forcohet edhe në ditët e sotme.

Nga Peshkopia u ndamë me përshtypjet më të mira dhe me besimin për t’u takuar në përvjetorët e ardhshëm në Dibrën e trimërisë e të bujarisë, të asaj Dibre që nuk ka ngjarje madhore të vendit e popullit tonë që mos të ketë qenë e pranishme dhe kontributore.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga BUJAR KAROSHI

Po e nis me një lajm, që është edhe i mirë, edhe i keq. Lajmi i mirë është se kemi zbuluar një rrugë të re për në Dibër, që i bie nga Rrësheni! Është i keq, se na ka dalë “pilafi” jashtë agjendës së udhëtimit, por shqyr që dalim nga misrat në Klos dhe shuajmë urinë. Kështu që për të shkuar në Dibër është bërë e vështirë të zgjedhësh: Nga Kukësi, nga Qafë Thana, nga Librazhdi apo Rrësheni: të gjitha këto thika pas shpine për Rrugën e Arbërit. Kësaj të fundit i jemi kthyer me avazin e vjetër: kemi ndërtuar gjysmën, edhe gjysma na ka mbetur!

Dy punëtorë, dy baballarë, dy burra, dy vëllezër i përcollëm në parajsë, pasi mbetën në galeritë e Martaneshit. Në ditët e mortes të gjithë angazhohen për drejtësi, por pas tre ditësh të gjithë i kthehen dokumentacionit në sirtarët e burokratëve të shtetit dhe fajtorët rezultojnë të kenë shkuar në botën tjetër.

Një grup ambientalistësh nga Dibra vizituan Fushën e Lukovës. Rrugës u doli policia pyjore dhe i ndaloi të shkonin lart, pasi dëmtonin mjedisin. Një furgon e dëmton mjedisin, ndërsa makinat e mëdha që kanë çuar tubacionet apo presin pyjet nuk e dëmtojnë, por e shkatërrojnë fare....

Policia duket edhe këndeje nga anët tona. Një postblllok i policisë private të ndalon të shkosh te Liqeni i Zi, park natyror, pasi është kantier ndërtimi. Kur e pyet policin se çfarë kantieri është, thotë se nuk ka kantier. Dhe presim pastaj të bëjmë turizëm në Dibër.

Turizmi veror shkëlqeu këtë vit. Nuk numërohen të ardhurat prej tij. Asnjë agjenci turistike nuk ofron ture në Dibër. A nuk dimë t’i presim apo nuk dimë ku t’i çojmë, kjo është çështja!

Tre veta i rrahën dy punonjës të policisë rrugore, se tentuan ta ndalojnë për shkelje të rregullave të qarkullimit. Për dy prej tyre, popull hesapi, i mësuam emrat, ndërsa njërit vetëm inicialet, pasi ishte punonjës i SHISH!!!

Një veprimtari e shkëlqyer u zhvillua në Dibër. Mbi 50 vetë dhuruan gjak për të shpëtuar jetë, por edhe për sensibilizim të çështjes Radika. Më mirë të dhurojmë gjak sot, se sa ta derdhim nesër për ujin e Radikës...

Lajmet për një aksion humanitar në Dibër ishin prezente këtë muaj në rrjetet sociale. Rreth 50 dibranë dhuruan para dhe një familje e varfër në Dibër u strehua. Kur jemi pak, bëjmë punë të mira, kur bëhemi shumë i prishim punë njëri-tjetrit.

Radhën e kaluar ju thashë që shpëtoi filiali i Peshkopisë i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, por fillimi i gushtit provoi të kundërtën: Universiteti u mbyll! Kështu shkoi kjo punë, si nisi-bitisi. Më vjen keq për qindra familje që përshatën shtëpitë për dhoma konvikti, pa universiteti si në Durrës, si në Peshkopi, as shkollë e mesme nuk ishte.

INSTAT publikoi statistikën mbi prodhimin e brendshëm bruto dhe Dibra rezultoi qarku më i varfër, si gjithmonë. Gushti ishte muaji dasmave. Lokalet e dasmave nuk pushuan asnjë ditë gjatë muajit, as në Peshkopi dhe as në Shehër. Mbi 5 milionë dollarë llogariten xhirot e muajit në këto lokale, kështu që ia hodhëm krizës...

ANEKDODA E MUAJIT

* * *

Nji babë kishte një djalë. Ky djali ishte shumë i prapë. Çdo ditë i ati i thoshte:

- Mor djalë, nuk je tue u ba njeri.
- Ke për të pa se ç’njeri do bahem, - i thoshte djali.

Nji natë djali ikën prej shtëpie e bashkohet me do njerëz të hunit e të litarit. Tani bante prapësina ma shumë. Vidhte e vriste njerëz. Nji ditë ushtria turke e kapi ene e burgosi. Mas do kohe këtë djalin e liruan nga burg. E vunë në krye të një bande për të ndjekur “kaçakët amautë”. Ki djali dallohet në këtë luftë e turqit i japin gradën e pashës. Ma vonë e bëjnë vali e thonë se në ç’vilajet donte me shkue. Ai zgjodhi vilajetin ku kishte familjen e vet. Si bani nja dy javë në detyrën e re, i thotë një zabit:

- Shko e merrma babanë rrshqanthi. Babai ishte tue larue në arë e ashtu siç ishte, këmbëzbathur e krejt pluhun e çon në qendër të vilajetit. Valiu e pyet:

- A më njeft mue kush jam?
- Nalu nji herë të mushem me frymë, se më kanë tërheqë rrëshqanas ata njerëzit e tu – thotë plaku.

Plaku qetësohet disi ene valiu i thotë:

- Po tashti a më njeft?
- Ngreu në kamë të të shoh më mirë – i tha plaku valiut.

Valiu u ngrit në kamë ene plaku e pa mirë.

- Tani të njoh, - tha plaku. – Je pasha turk.

- Jo pasha, por vezir.

- Unë nuk i njoh gradat, po prej shenjave që paske, ma mori menja që je pashë.

- Po cili jam, si e kam emrin?

- Nuk të njoh me emën – i tha plaku.

- Po ta kallëzoj unë se kush jam. Jam djali yt. A e man men se si

më thoshe? Unë u bana vali.

- Ti je ba vali, po nuk je ba njeri, se nuk merret baba rrshqanthi me turqili!...

* * *

Niset për një udhë të largët një dibran. Gjatë rrugës takohet me një tjetër dibran. Pasi shkëmbejnë duhanin, e pyet dibrani kalimtarin:

- Nga je nis, or mik?

- Drejt kazasë.

- Epo paskemi rrugën bashkë.

- Po të pyes, more burrë, – i thotë dibrani, - a do t’më bajsh në shpinë, a të të baj në shpinë? Kalimtari befasohet dhe hesht. Gjatë rrugës, afër një fshati shikojnë arat e mbjella me grurë e misër. E pyet prapë dibrani:

- A e ka ngranë bereqetin?

Përsëri shoku që ecin heshti e s’e kupton.

Kur afër një kulle dibrani i thotë: A ka vdek i zoti i kullës apo asht gjallë?

Shoku e dinte se zoti i shtëpisë ka vdekur, por prapë s’po i jep përgjigje...

U afrua koha e ndarjes. Dibrani duke pa heshtjen e kalimtarit u jep përgjigje pyetjeve.

- Kur të thashë a më baj në shpinë e atë të baj, d.m.th. a të japësh muhabet, a të të jap?

- Kur të pyeta se a e ka ngranë bereqetin, e kisha fjalën nëse janë të vetat, apo është tokë e huaj.

- Kur thashë se “A ka vdek i zoti i kullës apo është gjallë”, d.m.th. “a ka lanë njeri pas, fëmijë që t’ia rrisin vlerën”.

Përgatiti: **MEVLUD BUCI**

Ditari i një vajze...

Kategoritë e miqve në Facebook

I dashur ditar... se pse lodhem unë akoma duke shkruar te ty?... Shumica kanë Facebook-un për ditar, ku megjithëse kanë 500 e kusur *friends*-a, ndajnë aty çdo gjë; ku janë, me kë janë, pse janë.. kë kapin e kë lenë, sa fëmijë duan të bëjnë, kur i bëjnë e si i bëjnë, testin e shtatzanisë, ekografitë dhe ca më të guximshëm edhe procesin e pjelljes.

Ka lloj-lloj njerëzish, por në kaq vite përdorimi të FB kam parë këto kategori friends-ash:

Fantazmat - ata që nuk pëlqejnë a komentojnë asgjë, se bëjnë sikur nuk rrinë gjithë ditën në FB. Ne e dimë që jeni aty.. e tradhtoni veten kur nuk rezistoni dot pa komentuar tek ndonjë gjë që ju ngacmon.

Mosha e jo-internetit - janë personat e njëfarë moshe, që janë “*FB-virgins*”. Klikojnë ç’t’ju dalë para dhe iu postohen vazhdimisht lajme- e video-viruse me dhe pa brekë. Le kur të pyesin për mamin, babin e i bëjnë të fala gjithë farefisit në foto krejt pa lidhje, ku ti thjesht ke komentuar...

Dëshpërimisht vëmendje - këta janë ata që nuk e çojnë dot një orë pa postuar diçka apo përditësuar foton e profilit. Seriozisht njerëz, askujt s’i intereson që do pini kafën e dytë për sot... Për atë punë, askujt s’i interesonte as për të parën!

Heronjtë e CandyCrash Poker - ka më lojra? Ka, apo s’ka, luani për vete dhe boll na dërguat jetë, tokens e sugjerime për të luajtur se së shpejti do ju vijë ndonjë sugjerim për block!

Profilët familjare - këto profile kanë emër me formulë empirike: Emri-Burri-Mbiemri-Mbiemri Burrit. Është çorientuese kur ju komentoni, se nuk e di a është burri, gruaja apo kalamani 10-vjeçar që po i thotë një goce për fundin e bukur që ka veshur... E kam fjalën, mund të jetë secili prej jush!

Dramaturgu - këta janë njerëzit e zhgënjyer nga jeta, nga dashuria, nga oferta e Vodafonit dhe nga shitësi i bukës në lagje: “Përse, o



Zot, përse duhet të jetoj në këtë vend, ku të gjithë kanë nga një tjetër, oferta mbaron me facebook.0 dhe Buçi i bukës nuk të jep as kusur... përssssssssse?!!!! :’(((“

Prind dhe krenar - lum si ju! Në profilin e prindërve të rinj nuk gjen me foto të miqve të tu, por vetëm të kalamajve të tyre. Bebi duke ngrënë, bebi duke pirë, bebi duke ndejt kot si cop mishi që është, bebi duke bërë kakën... awwwww sa i bukur!!!

Promotori - këta janë të ashtuquajturët “menaxherë lokalesh”. Puna e tyre specifike është mister, rroga e tyre mbase jo-egzistente, por ne e dimë që janë promotorë se të ftojnë dhe bëjnë tag në të paktën 10 evente në javë.

Adoleshenti - çerrat duan gjithmonë të duken sikur nuk jua ndjen për asgjë, sikur bëjnë namin në kafën e lagjes, janë më të fortët dhe sikur kanë pirë hashash. Nuk gënjeni dot askënd. Të gjithë e dimë që akoma ju lan mami.

Filozofi - tipikisht këta kanë aftësinë të kërkojnë për shprehje në internet, t’i shkruajnë dhe të vënë emrin e tyre në fund. Ndonjëherë kanë edhe statuse origjinale, kur shpjegojnë me një thellësi marramendëse jetën: “Shoh larg në horizont zogj të natyrës tek fluturojnë mbi shtëpinë dykatshe të

Ramiut dhe brenda unit tim kam një ndjenjë të thellë se herët a vonë dita mbaron e nata fillon e pastaj nata mbaron e dita fillon përsëri - Pilan Pisteku”

Turi-dalët - fenomeni ‘*duck-face*’ është përhapur në masë, jo vetëm ndër femra por edhe meshkuj...ok, *feshkuj*. Ata nuk kanë asnjë foto ku fytyra e tyre i ka muskujt e relaksuar. Nëse s’i ke takuar për së gjalli për ca kohë nuk i njeh në rrugë, deri sa të nxjerrin turinjtë si në foto dhe: “ah, ti qenke mor çerr?!”

Të jashtmit - megjithëse jetojnë në Bathore dhe kanë qenë veç një muaj në Angli gabimisht, ata postojnë rekordin e fotove që kanë bërë atje dhe nuk shkruajnë asnjëherë shqip. E shprehin më mirë veten në anglisht, *you know what I mean?*

Dhe unë vetë - Sido që mund të duket nga sa më sipër, unë nuk kam paragjykime... i urrej të gjithë njësoj!

Ndiq linqet e mëposhtëme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...

<http://peshkopidiberalbania.wix.com>
<https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbani>



Të ishin të mirë nuk do të na ndanin.
Të ishin mirënjohës do të na falënderonin që i lam të ulen në këto troje.
U dham ujë të pinë, tani duan të na e marrin edhe lumin.
Respektoj çdo racë, fe apo komb!
Nuk jam nacionalist,
por Ti më detyron të bëhem!!!

Foto dhe teksti: © Gazmend Kërkuti

<https://www.facebook.com/dibra.debar.9?fref=ts>



NISMA

Lëvizja Qytetare Dibrane: Ja qëllimet tona!

Lëvizja Qytetare Dibrane është formuar për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dibrane dhe qytetin e Dibrës. Ne nuk jemi kundra askujt, por të gjithë ata që punojnë kundra Dibrës janë dhe kundërshtarët tanë.

Të shohësh se si zhduket ngadalë vendi ku ke lindur, të shohësh se si uzurpohen resurset natyrore, të shohësh se si keqpërdoret dhe kalohet nëpër çdo filtër të shfrytëzimit korruptiv, të shohësh se si manipulohet me ëndrrat e rinisë, të shohësh se si largohet rinia dhe mos gjen arsye për t'i ndaluar, të shohësh se si nëpërkëmbet dinjiteti njerëzor dhe kombëtar... kjo JO nuk duhet toleruar.

LQD një nismë nga vet vullneti qytetar me përkrahjen dhe mbështetjen e qytetarëve dibrane do të iniciojë ngritje të vetëdijes dhe ndërgjegjësim me veprime demokratike dhe përkrahje të të gjithë faktorëve relevant, për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e qytetit tonë.

- Lëvizja Qytetare Dibrane do angazhohet me të gjitha mjetet dhe metodat e veta për rikthimin e territorit të Dibrës
-Mbrojtja e qytetarëve dibrane nga padrejtësitë.

-Mbrojtja e faktorëve natyral dhe artificial të Dibrës.

Ne nismëtarët e " Lëvizjes Qytetare Dibrane" duke ndjerë padrejtësitë që i bëhen qytetarit dibrane, vatrës së arsimit qytetar, traditës, zgjuarsisë dhe trimërisë dibrane, të bindur se është koha që duhet ngritur zërin për t'ju treguar të gjithë dashakeqësve se mjaft më me padrejtësitë që bëhen në dëm të individit, qytetit dhe kombit tonë. Misioni ynë i shenjtë është që të ruajmë dhe mbrojmë nga çdo padrejtësi që bëhet ndaj qytetarit tonë, qytetit tonë dhe kombit tonë... e drejta e çdo kujt është të jetojë me



dinjtet në tokën e vet ... përkrahim me respekt çdo iniciativë që ndikon në mirëqenien qytetare e kujt qoftë ajo...!

Vazhdojnë padrejtësitë dhe sulmet ndaj qytetit të Dibrës. Ashtu si me Radikën, ndarja e re territoriale po e zvogëlon gjithmonë e më shumë shtrirjen e qytetit, po na copëtojnë dita ditës, ndaj duhen sensibilizuar qytetarët. Të mundohemi me çdo mjet dhe mundësi të mbrojmë qytetin, të mbrojmë vlerat, kulturën dhe dinjitetin tonë, të kthejmë krenarinë dhe urtësinë që dikur përfaqësonte ky qytet. Këtu nuk bëhet fjalë për ngjyrimet politike, të gjithë që e ndiejnë veten të gatshëm të ndihmojnë në mbrojtje të qytetit janë të mirëseardhur. Është koha dhe momenti për të reaguar sepse i kemi një detyrim moral këtij qyteti t'i kthejmë atë që dikur përfaqësonte.

Kujdesi dhe vigjilenca e dibraneve gjatë gjithë periudhave të kohës ka qenë gjithmonë prezent atje ku e ka kërkuar vendi dhe koha. Kurrë nuk ka munguar humanizmi dhe përkrahja pa rezervë në sferat ku ka pasur më shumë nevojë kombi. Gati në çdo cep të trojeve shqiptare mësuesit dibrane ishin vigjilentë, në çdo cep të trojeve shqiptare u vlerësua trimëria Dibrane, human dhe gjithmonë të gatshëm për përkrahje progresive. Kurrë nuk u kursye potenciali Dibrane në projekte të ndryshme kombëtare .

Po të krahasosh se në çfarë gjendje sot ndodhet Dibra, është për të ardhur keq.. e ndarë, e copëtuar, e uzurpuar, e shfrytëzuar. Ne nuk e meritojmë këtë!

Nëse fokusohemi tek papunësia, emigrimi, varfëria, pamundësia për karrierë, rreziqet dhe pengesat për shfrytëzimin e resurseve natyrore lind pyetja: mos vallë për Dibrën aplikohet ndonjë "program zhdukjeje"??

Vetëdijësimi dhe përkrahja e të gjithë qytetarëve dibrane është një formë për të ndaluar këtë të keqe. Konsultimi i përbashkët, ndershmëria dhe aftësia e të gjithë qytetarëve, do të na diktojë drejt një jetese më të sigurtë. Ky është obligimi i ynë, kudo që jemi dhe ndjehemi dibrane.

Logoja e lëvizjes është një sy shqiptar në mes, që simbolizon mprehtësinë dhe largpamësinë, si dhe ngjyrat kuq e zi.

Së shpejti do bëhen të ditur edhe emrat e themeluesve dhe anëtarëve të lëvizjes.

Grupi Nismëtar

<https://www.facebook.com/pages/Levizja-Qytetare-Dibrane>

Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections

Complete the construction of the Arbëri Road - Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbërit

Firmos dhe komento peticionit në change.org
http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=peticion_created&utm_medium=email&utm_source=guides

Sign this petition
with 4,440 supporters

560 NEEDED

First Name

Last Name

Email

City

Why is this important to you? (Optional)

Sign

☒ Display my signature on Change.org

By signing, you accept Change.org's [terms of service](#) and [privacy policy](#).

Save River Radika

JOIN US ON FACEBOOK

Mbro Radikën!

Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

<http://saveriverradika.com>



Kontributi i mërgimtarëve dibranë nga SHBA është i pazëvendësueshëm për vendlindjen e tyre. Edhe pse larg vendlindjes, ata nuk kanë pushuar asnjëherë të ndihmojnë, familjet e tyre...

profil

Dibranët në SHBA bëjnë me shtëpi të re një familje të varfër në Dibër

■ **“Meka dibranëve është Dibra, e cila po qe se nuk do të u kishte detyruar të largoheshit nga politikat që u ndoqën në Dibër gjatë sistemeve të ndryshme - nuk do të ishin larguar kurrë - Dibranët janë një popull që flasim me punë, trimëri, patriotizëm përkushtim dhe ndjenja dhe krenari”...**

Nga BEQIR SINA

DIBER E MADHE – Dibranët në Amerikë dhe Europë, krahas mbështetjes që i japin realizimit të projekteve të ndryshme në vendlindjen e tyre, një ndihmë të madhe janë duke dhënë edhe për sigurimin e kulmit mbi kokë të familjeve të bashkëfshatarëve të tyre, të cilët janë në gjendje të rëndë sociale. Falë mjeteve të grumbulluara në diasporë, mërgimtarët e dibranë në SHBA dhe Europë, kanë siguruar ndërtimin dhe paisjen me të gjitha komoditetet për familjen Karameti, e cila jetonte me gjendje të varfër.

Duhet theksuar se kontributi i mërgimtarëve Dibranë nga SHBA është i pazëvendësueshëm për vendlindjen e tyre. Edhe pse larg vendlindjes, ata nuk kanë pushuar asnjëherë të ndihmojnë, familjet e tyre, që mbahen prej vitesh nga njerëzit e tyre në mërgim, por edhe Dibrën sa herë që ka pas nevojë për realizimin e projekteve të ndryshme.

Këtë e ka theksuar në këtë reportazh edhe autori i kësaj video-reportazhi kur thotë se mërgimtarët janë të gatshëm të mbështesin edhe projektet kapitale të nevojshme për bashkëqytetarët e tyre, si ndërtimin e shtëpive të tjera dhe nevojat tjera për familjet skamore në Komunën e Dibrës së Madhe.

“Aksion humanitar - Shtëpi për Gëzim Karametin”- e ka titulluar Dr. Xhemal Çupi telereportazhin e tij përgatitur për “Vizioni Dibrën” (<https://www.youtube.com/channel/UCd6E-BovPb3ar6RkMlmiGczg>)

Ai thotë se Fondacioni “Dibra” Projekti “Shtëpi për një shtëpi”, ka bërë blerjen e shtëpisë për Gëzim Karametin, duke theksuar se “Ky është një organizim qytetar me qëllime humanitare e organizuar kryesisht nga dibranet e Shteteve të Bashkuara - por jo vetëm, mbasi është ndihmuar edhe nga qytetarët dibran dhe dibranët në Europë”.

Një familje shtatë anëtarshë dibrane - jeton me shpresën se një ditë do të bëhet më mirë për ta, thekson ai. Ajo është një familje e kryefamiljarit Gëzim Karameti, që nuk ka pasur asnjëherë shtëpi dhe kulmë mbi kokë, por me ndihmën e dibranëve në Amerikë, ajo u bë me shtëpi të re dhe të mobliuar mirë.

Simbas këtij reportazhi të televizionit lokal “Vizioni Dibrën”, njëri prej folësve, me emrin Skënder - thotë se inisiativa për ndërtimin e kësaj shtëpie, u bë nxitja e TV “Zhupa”, prej gazetares Vjollca Sadiku - e cila me kolegën e saj të MTV - Rina Turkeshi, sensibilizuan qytetarët anemban vendit deri përtej oqeanit në SHBA.

Ai tha se idenë për të grumbulluar ndihma financiare nga SHBA, men-

jëherë mbas reportazhit të dhënë në MTV- e dha Edmont Ymeri, dibrani që jeton prej vitesh në Staten Island - Nju Jork, së bashku me bashkëqytetarët e tij - Bekim Paçuku, Fation Mashkulli, bashkëngjitur me shumë dibranë të tjerë.

Edmondi, vetë thotë se i faleminderohet me këtë rast të gjithë dibranëve në Amerikë(rreth 40 donatorë), të cilët, me bujarinë e tyre tradicionale, dibrane, edhe kësaj radhe ditën t’a tregojnë vet-veten në raste të tilla. “Por, duhen faleminderuar, theksoi ai edhe shumë të tjerë, shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, e viset e tjera, madje edhe jo shqiptar, të cilët, iu bashkëgjintën fushatës tonë, për mbledhjen e ndihmave për ndërtimin e kësaj shtëpie - Së fundi faleminderojmë Zotin që na ka dhënë mundësin të ndihmojmë njëri tjetrit në atë vend të bekuar, ku ne jetojmë e punojmë prej vitesh” tha ai.

Inisiativa tregon për televizionin lokal “Vizioni Dibrën”, bashkëatdhetari ynë, Bekim Paçuku, u morë nga dibrani në SHBA, Edmond Ymeri, nëpërmjet rrjetit social facebook. Ajo ishte një ide e thjeshtë që më të vërtet preku shumë zemëra anembanë vendit. Paçuku, u shpreh se :“ Kjo ndihmë e dibranëve, nuk ka lidhje dhe as duhet të identifikohet me ndonjë parti politike, cilado qoftë ajo, simbas tij. Mbasi ndihma e dibranëve në Amerikë, është e vetë dibranëve, që u dhimbset vendlindja e tyre”.

Ai shton se kan idenë që duke bashkëpunuar me Komunën e Dibrës, ata duan të gjejnë një tokë shtetërore për ndërtimin e katër a pesë shtëpive të tjera (community house), ndërsa premtosë se “nuk do të ndalen me kaq - por dotë vazhdojnë të ndihmojnë familjet më në nevojë në Komunën e Dibrës”.

Njëri prej folësve, gjatë këtij reportazhi 20 minutësh një predikues fetar, i cili mori pjesë në dorëzimin e çelsave të shtëpisë së re, duke e bekuar të, tha se kjo ndihmë ka treguar edhe një herë atë humanizmin e pastër njerëzorë, dhe shpirtëror të dibranëve, që i ka dhënë gjithmonë kombit tonë. Ai tha se “Meka dibranëve është Dibra, e cila po qe se nuk do të u kishte detyruar të largoheshit - nuk do të ishit larguar kurrë - Ne jemi një popull që flasim me punë, trimëri, patriotizëm përkushtim dhe ndjenja dhe krenari” tha ai.

Imami vlerësojë me këtë rast edhe ndihmën që i kan dhënë shqiptarë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke i quajtur ato si vendin më mikëdashës dhe më mikë-pritës dhe më përkrahës i shqiptarëve prej nga pavarësia e Shqipërisë, demokratizimi i saj - dhe çlirimi e pavarësia e Kosovës - Zoti i bekofë shqiptarët dhe SHBA.

Ferdinad Cami, shqiptari i parë zëvendës-president i super kompanisë L-Discovery

Nga BEQIR SINA

CHICAGO ILLINOI: Duke shfletuar faqen më të njohur në internet ZoomInfo - e cila i dedikohet më së shumti njerëzve të biznesit dhe profileve profesionale, që përfshijnë informacionin e vërtetuar tek të dhënat, e të dëshmuar në biografi, histori të punës, përkatësitë dhe më shumë, thuhet se :“Ferdinad Cami, një 33-vjeçarë shqiptaro amerikan, me origjinë nga Dibra e Madhe, i cili jeton prej vitesh në Çikago së bashku me familjen e tij, është emëruar zëvendës president i kompanisë L-Discovery me bazë në Chicago”.

Ai është i njohur mirë si një investitor dhe aktivist që ka një sukses të madh në këtë lëmi mbasi ai është i dyti në botë në krye të kësaj kompanie, shkruan Zominfo.

Si Drejtor i Shërbimeve në LDiscovery, Hosted z. Cami zhvillon mënyrat e rritjes së suksesit të LDiscovery; krijon, mban dhe ruan bazat e të dhënave, në shqyrtimin e dokumentave; dhe i plotëson ato me më të kërkuar në bazë të kërkesave të prodhimit. Ndërsa, është i njohur edhe në menaxhimin e web-faqeve në internet, ato të shërbimeve në Chicago-. Z. Cami, ka njohuri të gjerë, më të planifikuar të të gjitha platformave në internet, në skemën kCura, në bazë të dhënave; Relativitetit, Përputhja, iConectNXT / Xera, Equivio Zoom dhe një shumëllojshmëri të zonave të tjera.


Simbas ZoomInfo, thuhet se para se t'i bashkohej LDiscovery, z. Cami, ishte një analistë dhe administrator i Lartë, i web-faqes ky shfrytëzohen Baza e të dhënave dhe të dhënave në ONSITE3.

Z. Cami mori në manexhim administratën e hostedit - Relativiteti Certified “RCA” dhe u certifikua në vitin 2010 si një specialist i avancuar në SQL. Ai ka marrë një certifikatë nga Universiteti DePaul në 2009, si një i trajnuar, dhe si një analist në sistemin dixhital mjeko-ligjor, si dhe një administrator i bazës së të dhënave, Z. Cami mori një certifikim tjetër në vitin 2008, në Access Data Certified (“ACE”) dhe e mbylli suksesin e tij me një diplomë në Certified Examiner në 2010.

Ai merr pjesë rregullisht në një shumëllojshmëri të programeve të trajnimit për të rinovuar dhe për të ruajtur aftësitë e tij kundrejt teknologjisë dixhitale mjeko - ligjore, jo vetëm në SHBA, por në bazë të dhënave në të gjithë botën.

Ferdinand Cami, i cili ka lindur, në Nju Jork,(22 gusht 1981), është i biri i veprimtarit të dalluar në SHBA, Fanol Cami, nga Dibra e Madhe, dhe nënës së tij Diana. Ai ka dy motra Rajmonda, Shkelqesa dhe vëllanë Osmanin. Ai është i martuar me shqiptare Arlinda Ahmetin dhe ka një vajzë dy vjeçare me emrin Leona.

Babai i tij Fanol Cami në një postim në profilin e tij në facebook shkruan “ Djali i babit, me këtë provim ti jo që gëzove familjen tënde, po i gëzove të gjithë Shqiptaret në botë. Babin, mamin dhe mbarë familja Cami në



■ **Babai i tij Fanol Cami në një postim në profilin e tij në facebook shkruan: “ Djali i babit, me këtë provim ti jo që gëzove familjen tënde, po i gëzove të gjithë shqiptaret në botë.**

Dibër të Madhe, dhe SHBA, se të gjithë sot krenohemi me punën tande. Gëzuar nga zemëra dhe me këtë rast të gjithë dëshërojmë sukses të matejshme”

L-DISCOVERY :

LDiscovery është një kompani lider në zgjidhje të menaxhimit L-Discovery, duke siguruar fonde në shërbime këshilluese, dixhitale në teknologjinë më të sofistikuar në botë mjeko ligjore të quajtur Amlaw 200 - firma të ligjit, Ajo ka kooperim me më shumë se 500 korporatat, dhe agjencitë qeveritare. Themeluar në vitin 2005 dhe me seli në McLean, Virgjinia, LDiscovery është rritur shpejt në një nga kompanitë më të mëdha për përdoruesit e e-Discovery, në rangë kombëtar, me zyra në Nju Jork, Filadelfia, Çikago, Atlanta, dhe San Francisco.

Ajo është mjaft e kërkuar për përpunimin e të plotë në të dhënat e relativitetit - hosting - me zyrë edhe në Londër për të lehtësuar rishikimin e të

■ **LDiscovery ka qenë e njohur si një nga kompanitë me një rritje më të shpejtë në Amerikë, e krijuar nga dy kompanitë gjigande Inc Magazine (Inc 5000) dhe Deloitte (Deloitte Fast 500)**

dhënave, për të gjithë ata që banojnë brenda BE.

Simbas ZoomInfo, thuhet se para se L-Discovery, kompania në të cilën numeri 2 i saj është ky shqiptarë i amerikës, Ferdinad Cami - rekruton, trajnon dhe stafin dhe avokatët më të mirë dhe të zgjuarit, inxhinierë në industrinë, analistët të sistemit dixhital të mjekësisë ligjore, dhe përgatit profesionistët dhe mbështetësit të sistemit kombëtar gjyqësorë. Kjo kompani thotë se :Për shkak se një pjesë e rëndësishme e LDiscovery është me punonjës në pronësi, ne jemi në gjendje për të garantuar standardet më të larta të cilësisë dhe mbështetjen e klientëve. “Standardet tona kan orë mbështetëse, thonë ata duke shtuar se janë të hapur dhe operojnë në sistemin elektronikë internet . në platformën dixhitale 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, 365 ditë në vit. Ekipi ynë, thkeson L-Diccovery kombinon arsimin, përvojat, risit, dhe përkushtimin për të zhvilluar procese të reja dhe mjetet me një qëllim të njëjësimit në mendje - për ju, klientit tonë që të sigurojë, të dhënat me të sakta, e argumentuar, ato me një kosto-efektive “ shkruan eDiscovery.

LDiscovery ka qenë e njohur si një nga kompanitë me një rritje më të shpejtë në Amerikë, e krijuar nga dy kompanitë gjigande Inc Magazine (Inc 5000) dhe Deloitte (Deloitte Fast 500). Përveç kësaj, LDiscovery është një-nivel me Orange Relativiteti kompani e mirë në shërbimin me partner, ajo është një Premium i Relativitetit Hosting Partner, dhe qendra e të dhënave të saj është SSAE 16 / ISO 9001.

Prof. Dr. Nuri Abdiu ka bërë një punë pionieri, ka hapur rrugën veçanërisht në fushën e psikologjisë shqiptare, të historisë së saj, indirekt ka kontribuar dhe për historinë e filozofisë shqiptare.

“Njeriu i së ardhmes”

Prof. Dr. Nuri Abdiu - një emër që s'ka mort

“Je bregliqen ku çlodhen
zogjtë, ...
Je oqean i thellë mendimi...”
Një poeteshë, ish studente e tij

“Prof. Nuri Abdiu është
pedagogu që jep e kërkon,
duke të respektuar
njëkohësisht...”
*Fjalë të mënçura nga një ish
student i tij*



“Prof. Nuri Abdiu,
Njeriu që flet bukur,
që shkruan bukur,
Që paraqitet kudo
me fisnikëri...”
Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri

Tërë jetën ai rrezatoi mirësi
e dituri, duke u bërë një
figurë e nderuar në fushën
akademike dhe shkencore,
një emër i shquar në arsimin
publik e jo publik në vendin
tonë...

Nga Dr. LAURANT BICA

1. NURI-DRITË

S i tani e mbaj mend atë moment, kur u ndamë nga njëri tjetri. Kjo ndodhi katër pesë ditë përpara se profesor Nuri Abdiu të ndahej nga jeta në moshën 85 vjeçare më 27 Prill 2014 në orën 3 të mëngjezit. “Kemi nevojë të shihemi përsëri. “Këto ishin fjalët e fundit që i thamë njëri tjetrit. Pashë për herë të fundit atë, mikun tim të mirë, që po largohej ashtu qetë qetë drejt shtëpisë së vet...N’atë çast as mund ta mendoja se ajo ishte hera e fundit që po shihesha me atë njeri fisnik

Profesor Nuri Abdiu i takon asaj plejade intelektualësh që vunë gurë themeli në arsimin kombëtar dhe luftuan pandërprerë për ta përsosur atë – mbi 50 vjet pedagog janë një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe, arsimit kombëtar. Kontributi i profesorit të nderuar është shumë i madh e shumëdimensional. Gjatë tërë jetës ai pati një nord, binomin punë dhe atdhetarizëm. Këto qenë dy busulla për të, që s’e lanë të gabonte kurrë.

Ai lindi më 1 shkurt të vitit 1930 në një familje fisnike e të shquar në krahinën e Dibrës në fshatin Sohodoll, fshat i madh i përmendur veçanërisht për traditat e tij, rrëzë malit të Korabit. Prindërit e tij, i ati Hazizi dhe nëna Gjylja rridhnin nga familje të dëgjura të zonës, sidomos ishin arsimdashës. Këtë bënë për djalin e tyre më të madh, Nuriun. Sikundër i shkolluan deri në fund dhe tre vëllezërit e tre motrat e tjerë që do ta pasonin atë. Jo vetëm për arsimimin e tyre por gjatë gjithë jetës Nuriu do të bëhej mbështetje e tyre. Ai do ta meritonte emrin vëlla i madh i tyre deri në fund të jetës së vet.

Prindërit i vunë një emër të traditës, pa e ditur se ai do të bëhej, siç u bë Dritë, njeri i ndriçuar për vehten e vet, për të afërmit, për të tjerët, për të ardhmen, për brezin e ri.

Tërë jetën ai rrezatoi mirësi e dituri, duke u bërë një figurë e nderuar në fushën akademike dhe shkencore, një emër i shquar në arsimin publik e jo publik në vendin tonë. Prindërit, duke i vënë emrin Nuri, një fjalë me origjinë arabe që ka kaluar në gjuhën turke e nëpërmjet saj në gjuhën tonë dhe vazhdon dhe sot të përdoret) që dmth dritë, donin të shprehnin dëshirën që biri i tyre të bëhej i tillë. Dhe ai u bë i dobishëm jo vetëm për familjen por për Dibrën, Shkodrën, për krejt Shqipërinë e më tej, duke rrezatuar gjithandej.

Fjala NURI po të shohësh fjalorët, do të thotë ndriçim, rrezatim, shkëlqim, dritë hyjnore, nur.

Në trajta të ndryshme të saj, e kombinuar dhe me ndonjë fjalë tjetër, ajo ka kuptimin njeri shumë i dashur, person i respektuar, me pamje që të ngjall respekt, i famshëm, i bekuar, i shenjtë. Në trajtën e saj Nurejin, nënkupton Hënë bashkë me Diellin, pra njeriun që është zotërues i këtyre dritave, që është me nur, me dritë. Profesor Nuriu, që kur filloi shkollën fillore e pastaj nga klasa e pestë, pra shkolla unike, e deri sa mbaroi të lartën jashtë shtetit, bëri jetë konviktori. Për një kohë në Peshkopi qe dhe nëndrejtor konvikti. Ai e meritoi plotësisht këtë emër të familjes së tij fisnike e atdhetare.

Nuriu jo vetëm në vitet e shkollimit por tërë jetën rrezatoi dritë, dritën e arsimit e të kulturës. Ai u bë “ambasador” i Dibrës në Shkodër, i Shkodrës në Tiranë, i Tiranës në trojet etnike, në Kosovë, Maqedoni etj. dhe kudo ai si një pedagog i shkëlqyer përhap dritën e arsimit shqip. Ai u bë edukator i brezit të ri; u bë pedagog i studentëve një jetë të tërë në të katër anët e Shqipërisë.

Dikur për Hasan Tahsinin, rilindas me të cilin u muar edhe prof. Nuri Abdiu, nxënësit e tij në Universitetin e Stambollit apo në shkollat e tjera të larta, ku Tahsini dha mësim, thoshin me krenari: “Kam qënë nxënës i Hoxha Tahsin-it”. Këdo që kam takuar gjatë jetës time, që ka mbaruar Institutin Pedagogjik të Shkodrës, sot Universiteti “Luigj Gurakuqi”, sa herë ka rënë fjala për prof. dr. Nuri Abdiun me kënaqësi e me krenari të ligjshme kanë thënë: “Kam qënë student i profesor Nuriut”. Ai jo vetëm i donte, i mësonte por kur duhej në raste të veçanta dinte dhe t’i mbronnte ata. Prandaj ata përgjoheshin për mësuesin e tyre të nderuar. Për Nuriun, jo vetëm miqtë e dashamirët por sidomos masa e kuadrove që ai ka nxjerrë nga duart e tij e kanë konsideruar si Mësuesi i mijra mësuesve si Pedagogu i pedagogëve. Mbi tre dekada në krye të Institutit të Shkodrës, më i rëndësishmi midis institutëve pedagogjike si Normales së Elbasanit, Pedagogjikes së Korçës, Pedagogjikes së Tiranës etj. nga duart e tij ka dalë një armatë e tërë pedagogësh që e kujton me respekt, krenari e nostalgji, Mësuesin e vet, Profesor Nuriun.

2. SHKENCËTARI

Në 83 vjetorin e lindjes së Prof. Dr. Nuri Abdiut u tha me të drejtë në kremtimin që u bë në kuadrin e 7 Marsit se “Profesori i papërsëritshëm i psikologjisë Nuri Abdiu me punën e kontributin e tij është e do të jetë një institucion shkencor e pikë reference për të gjithë studiuesit në fushën e psikologjisë brenda e jashtë vendit”. Profesor

Nuri Abdiu duhet vlerësuar si një nga misionarët e parë që i takoi detyra që ta fillonin çdo gjë nga e para, si hartimin e programeve e leksioneve, të teksteve të psikologjisë e pedagogjisë për shkollat e mesme e të larta si dhe për kualifikimin e mësuesve dhe specializimet pasuniversitare në Universitetin e Shkodrës e Universitetin e Tiranës. Në këtë mision fisnik Prof. Nuriu e plejada e tij u bënë të parët që ngritën nga e para katedrën e pedagogji-psikologjisë dhe të Institutit Pedagogjik në Shkodër si dhe zhvillimit të procesit të arsimimit, specializimit e kualifikimit pasuniversitar të qindra e qindra specialistëve në fushat e psikologjisë.

Penës së Nuri Abdiut si shkencëtar i takojnë një mori veprash, një pjesë të madhe të të cilave e kemi sot në dorë të botuar e të ribotuar. Ndër to mund të përmendim “Historinë e psikologjisë shqiptare”, (2002, 2010), “Bibliografinë e punimeve shqiptare të fushës së psikologjisë” (1986, 2011). Po ta kish vazhduar “Historinë e psikologjisë shqiptare” më tej, duhet të hynin patjetër emra që vijnë deri në ditët tona si akademikët Bedri Dedja në Shqipëri, Pajazit Nushi në Kosovë dhe padyshim ai vetë, Prof. Dr. Nuri Abdiu. Me krijimin e Akademisë Shqiptare të Shkencave të Edukimit (A. Sh. Sh. E.) në vitin 2011, Profesor Nuriu u bë antar i saj. Jemi të bindur se vazhduesit e punës së tij në të ardhmen do ta bëjnë këtë gjë. Në projekt Nuriu, miku im, pati dhe veprën “Punime për psikologjinë në përgjithësi në vite”, dosjen e së cilës e kish bërë gati me kohë dhe për botimin kish biseduar diku. Këtë ma tha në takimin tonë të fundit. Është e domosdoshme botimi in memoriam i kësaj veprë që ne mendojmë se do të jetë mjaft voluminoze. Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve dhe artikujve shkencorë i kalon të 170 zërat. Të paktën gjysma e tyre duhet të jetë e kësaj fushë. Për më tepër profesor Nuri Abdiu është me veprën e tij ai që u ka hapur horizont për dekada të tëra apo ka shërbyer si themel për kërkime në fushën e psikologjisë për studjuesit e rinj të këtij drejtimi.

Ai ka bërë një punë pionieri, ka hapur rrugën veçanërisht në fushën e psikologjisë shqiptare, të historisë së saj, indirekt ka kontribuar dhe për historinë e filozofisë shqiptare. Gjithashtu ka dhënë ndihmesën e vet për studimin e veprave të rilindasit Hasan Tahsinin. Me punimin e tij “Psikologjia e Hasan Tahsinin” ai jep një model, si të veprohet për të nxjerrë e vlerësuar veprat e tjera të Tahsinin. Ndërsa bibliografia për psikologjinë është një pikëmbështetje për kërkime të reja në fushën e psikologjisë. Me veprën e vet “Historia e Psikologjisë Shqiptare”,

ai e ka ngritur vehten në një pjestal, duke u rradhitur krahas homologëve të vet të fushës së psikologjisë nacionale edhe në hapësirat e Ballkanit, të vëndeve mesdhetare, të Lindjes së Mesme, të Europës e më gjërë. Pra emri i tij qëndron krahas parsonalitetëve, që kanë shkruar historinë e mendimit psikologjik të vëndeve përkatëse.

Prof. Dr. Nuri Abdiu me veprën e vet “Bibliografia e punimeve shqiptare në fushën e psikologjisë” me ribotimin e saj të dytë, i shtoi dhe 15 vjet, pra e shtriu deri në vitin 2000. Kjo është një lloj ftese për studjuesit e rinj, për t’i shpërë përgjithësimet e autorit për historinë e psikologjisë shqiptare, për t’i shtrirë ato nga 1939, deri ku ai i çoi vetë, deri më 2014, dmth edhe për 75 vjet të tjera. Pra ajo është një çelës për përgjithësimet të reja, për ta sjellë deri në ditët tona.

Është detyrë e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, që profesor Nuri Abdiu e kryesoi sa qe gjallë me nder e dinjitet, t’i botojë veprat e tij të plota në katër-pesë vëllime si botimet psikologjike në përgjithësi, bibliografia, historia e psikologjisë shqiptare dhe në fund “Psikologjia” e Hasan Tahsinin. Mund të botohen edhe në dy vëllime në format të madh; dy tre të parat për psikologjinë në përgjithësi në një vëllim dhe ato për psikologjinë shqiptare në vëllimin e dytë. Gjithësesi është një punë që duhet bërë sa më parë e me përgjegjësi.

...Veprat e Prof. Dr. Nuri Abdiut kanë rëndësi e janë një pikënisje për psikologët e ardhshëm.

Profesori është autor edhe i disa monografive me përmasa më të vogla, të botuara në revista e përmbledhje shkencore.

Zëri i shkencëtarit N. Abdiu apo kumtesat e tij janë dëgjuar në forume shkencore kombëtare e ndërkombëtare si në Kongresin e VI European të Psikologjisë (Romë 1999) apo janë lexuar në kongrese të tjerë të radhës për psikologjinë si në Stokholm të Suedisë apo matanë oqeanit deri në Montreal të Kanadasë etj. ;ku ai ka paraqitur e mbrojtur denjësisht me arritjet e tij, vëndin tonë, Shqipërinë e shqiptarët. Standartet e tij shkencore e kanë çuar në nivele të tilla si Nënkrjetar i Shoqatës mbarëshqiptare të Psikologëve, konsulent botues në revistën shkencore “European Psychologist” që del në Hamburg të Gjermanisë etj.

Ai është bashkëautor i shtatë teksteve të psikologjisë, midis të cilëve dhe i manualit “Psikologjia e Personalitetit” për kursin pasuniversitar të Psikologjisë dhe të Pedagogjisë të Universitetit të Tiranës(1988).

(Vijon në faqen 23)

Nga MEVLUD BUCI

Është vërtetë gëzim shpirtëror për cilindo njeri a intelektual human kur del në qarkullim një libër i ri. Sigurisht që libri ka vlera, sepse është rrezatim i kulturës, historisë, virtyteve, gjurmëve e dritës së diturisë. U emocionuam shpirtërisht kur morëm në duar librin historik “Katër Grykët e Dibrës” të studiuesit e intelektualit të shquar Qazim Prejsi. Ndonëse në moshën 78 vjeçare në pension, me banim në qytetin e Lezhës, autori në pension, autori Prejsi ka punuar me pasion e përkujdesje për të pasqyruar historinë, traditat e zakonet, luftërat, ngjarjet, folklorin, figura të ndritura atdhetare, organizimin administratën shtetërore, organizimin e brendshëm të fshatit, fisit, trungut familjar, sigurimin e të ardhurave në zonë, ndërtimet e banesave të zonës orënditë shtëpiake, veshmbathjet, besimet fetare, kultet e natyrës, festat fetare, argëtimin e banorëve të zonës përhapjen e arsimit në Zonën e Katër Grykëve, zhvillimin e zejtarisë, mjekësisë, tregtisë, ndërlidhjen telefonike, fejesat e martesat nga jeta (vdekjet) si dhe gjenezën e popullsisë të të gjitha fshatrave. Treva e Katër-Grykëve të Dibrës në librin e Qazim Prejsit pasqyrohet realisht, me përshkrime luftërash, lidhjes atdhetare, figura të ndritura brenda e jashtë zonës. Sigurisht që në një libër nuk mund të pasqyrohet përfundimisht jeta, ngjarjet, traditat e një zone. Por një zonë, apo edhe për një figurë të shquar mund të shkruhen disa libra. Autori Qazim Prejsi ka bërë një punë serioze, pasiononte dhe korrekte duke na pasqyruar Katër-Grykët e Dibrës nga lashtësitë e deri në vitin 1940. Kuptohet që ndërmarrja e tij është e lavdërueshme, fisnike dhe me plot merita, sepse i ka përpunuar vendlindjes “mineralin” shpirtëror të gjurmuar nëpër vite.


Autori Prejsi, me modestinë që e karakterizon qysh në hyrje të librit falënderon intelektualin e shquar Fatmir Jashar Delishin, por ndihmesën humane e përkujdesjen në parapërgatitjen e librit falënderon disa nga intelektualët e zonës, brenda e jashtë saj me të cilët autori ka bashkëpunuar. Nëpërmjet thënies filozofike të saktësuar në fillim lexuesi. Zbulon qartë mesazhin dhe misionin fisnik të studiuesit Qazim Prejsi.

Autori shkruan: “Njohuria rreth historisë na krijon ndjenjën se jemi pjesa e një shoqërie e cila përshkon shekujt që nga shumë kohë para lindjes sonë, deri në shumë kohë pas vdekjes sonë: (f. 5). Pasi autori shkruan parathënien ku shpërfaq detyrimin moral e shpirtëror për vendlindjen, rrugët për sigurimin e të dhënave, ndjesë për ndonjë anashkalim në mos përmendjen e ndonjë ngjarjeje apo personazhi, për boshllëqet e mbetura etj., autori tregon mirënjohjen për mjaft bashkëpunues, homazhin për dy figura të shquara të dala nga kjo zonë, të cilët nuk rrojnë më si Bajram Totraku dhe Hysen Lala (studiues të talentuar) homazh për xhaxhanë, të paharruarin Maliq Ram Prejsi, i cili ideoi, inkurajoi e ndihmoi autorin për nismën që të shkruante librin për zonën e Katër-Grykëve.

Libri “Katër Grykët e Dibrës” në pjesën e parë ka “Një vështrim mbi Dibrën”, pjesë etnografike e së cilës janë dhe Katër Grykët.

Janë pasqyruar të dhëna historike për Dibrën, Kastriotët, kryengritjet e Dibrës gjatë shekujve 17-18 ndarje figurative e Dibrës (Topalltia, Malësia (Nandë malet), beteja e Gjoricës (gusht

‘Katër Grykët e Dibrës’ - një përmendore për vendlindjen



1844), lufta në Bulqizë (prill 1860), roli i Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Kongresi i Dibrës, 23 korrik 1909, kryengritja e prillit 1910, qershorit 1912, pozita e Dibrës në vitet e krizës Ballkanike 1912-1913, ushtritë austro-hungareze e Bullgare në Shqipëri, ushtritë serbe përsëri në Dibër, kryengritja e Dibrës e gushtit 1920, lufta e Lanë-Lurës 26-28 tetor 1921, barbarizmat serbo-sllave në Dibër, tetor 1912 – dhjetor 1915 dhe tetor 1918-nëntor 1921. Krahas këtyre ngjarjeve interesante e me vlerë autori Prejsi shkruan edhe për disa figura të shquara si “Demir Lusha tek veziri i Shkodrës”, “Treqind nuse me duvak”, “Lura përballë masakrës austriake” (10-28 korrik 1916) “Mbi ngjarjen në Kodër-Kace të Zall-Dardhës (shtator 1941). Në këto shkrime studimore autori krahas përshkrimeve e argumenteve ka dhënë me qartësi edhe epikën historike si bashkëkohëse e ngjarjeve dhe e qëndresës.

Në hyrje të kapitullit të dytë “Katër – Grykët e trevës së Dibrës”, autori poshtë nëntitullit jep mesazhin e rëndësishëm prej vizionari për rëndësinë dhe korrektësinë përballë rrjedhës, fakteve e pasqyrimin të historisë: “Ndodhitë në histori nuk duhet të fshihen, sepse duke i fshehur ato disa emocionues do ta kishin më të lehtë për të shpikur të tjera histori, jo me aq vlerë, duke e arnuar atë” (f. 75).

Autori Prejsi krahas pozitës gjeografike, faktorëve ekonomikë, turizmit klimaterik veror e të dhënave për popullsinë, vendosjet pasqyrojnë tradita të vyera, ngjarje e fakte që dëshmojnë

■ **Autori Prejsi ka punuar me pasion e përkujdesje për të pasqyruar historinë, traditat e zakonet, luftërat, ngjarjet, folklorin, figura të ndritura atdhetare...**

■ **Në faqet e këtij libri të Qazim Prejsit, historianët, studiuesit, gjuhëtarët, folkloristët, kulturologët, mësuesit, e cilido lexues gjen këndin e punës së tij, vlera të rralla, thesarë të shpirtit, trimërisë e mençurisë së brezave.**

atdhetarinë e qëndresës në breza.

Ndihma dhe roli historik i Katër Grykëve si para, gjatë e pas luftërave të Skënderbeut, rezistenca e Katër Grykëve ndaj pushtuesve të huaj, lufta e Talmuranës (Tallë-stivë ose mal dhe muranë – përmendore, grumbull gurësh ku përjetohen trimat që bien në betejë). Më 1443 Skënderbeu vendos forcat në Shtek të Murrës (Murrë-gjak, vend gjaku, M.B.) tek shkëmbi i Buce, nga ku i sulmon egërsisht turqit sapo futen në hyrje të Murres për të shkuar në mposhtjen e kalasë së Stelushit.

Janë pasqyruar qartë e me fakte qëndresa e popullit të Katër-Grykëve, luftërat nën udhëheqjen e Skënderbeut, uniteti popullor, janë saktësuar edhe betejat e vitit 1714, 1841, 1847, roli në Lidhje të Prizrenit 10 qershor 1978, lufta e Katër Grykëve me turqit, tetor 1880, mobilizimi ushtarak turk i viteve 1910-1911 emigrimi në zonën e Katër Grykëve, Katër Grykasit në Luftën e Kakarriqit të Lezhës nëntor 1912, Lufta e Topojanit (dhjetor 1912) kryengritja e vitit 1913, lufta kundër austriakëve (janar 1916-shtator 1918). Në faqet e këtij libri të çmuar jepen me qartësi lidhjet ndërkrahinore të Katër-Grykëve si me Dibrën, Matin, Mirditën, konfliktin me Allamanin, Oxhakun e Hoxhollit, Oxhakun e Karahasnit, personazheve të shquar nga secili fshat.

Në libër janë pasqyruar burra me zë e mençuri të dhënë në foto si Ramadan Biba, Sali Bajram Manreka, Elez Duka, Sali Biba, Rrahman Lala, Tahir Lleshi, Abaz Loca, Liman Muça, Tafë Lasku, Kurt Bodini, Hasan Delishi, Hamit Hasbajrami, Islam Tahir Bruçi, Asllan Dullë Ndrejoni, Shaban Dervishi, Vokërr Ndreka, Veli Rama, Rexhep

Elezi, Kros Nelhani. Janë pasqyruar në plotësi dhe në unitet me kohën kur kanë jetuar atdhetarë e prijës popullorë si Tafë Kaziu, Hoxha Bajram Buci (Molla Bajrami, M.B.), Hoxhë Sefer Bodini, Llan Destan Ndrejoni, Halil Daçi, Ismail Nika, Ahmet Perhati, Jashar Lela, Elez Sulë Lala, fisi i Hasbajrame, tradita, shkollimet, lidhjet e saj me Abdyl bej Frashërin, shembulli bujar i kullës Hasbajrame, emri i së cilës u gdhend në pllakë mermeri në mes të stambollit: “Shtëpi e madhe në Kacninë e vogël” (f. 166). Me korrektësi e dashamirësi autori Prejsi pasqyron edhe ata Katërgrykas të shpërngulur nga zona, por që bënë emër në vendet ku shkuan. Të tillë janë Rrahman Konesha nga Lukani, i cili u vendos në Katund të ri të Luznisë. Më 1793 u ndesh në Moravisht afër Strugës me forcat e ushtrisë e Ali Pashë Tepelenës të cilat i thyen. Autori e konkretizon betejën me epikën historike:

“O Koneshë, o bir, o bir, / Luftë po ban me një vezir / Obobo po vjen Konesha / Si arushë me shumë veshë / Pushka e Derës lara-lara / Treqind vetë i vu përpara... (f. 175)

Janë pasqyruar trimi Haziz Xheka (nga Selishta) që jetoi e luftoi në kullë në Gjoricë në breg të Drinit.

... Haziz Xheka trim dai / E ban gjakun n’Zall e n’Dri / Kurt Hoxha paska thanë / Ke ura e Spiles vend do zamë / Një ushtar në kamë s’e lamë / Ban gajret Haziz Xheka i zi / Se tabori u mbyt në Dri... (f. 177).

Në faqe të librit janë gdhendur edhe veprimtaria e atdhetarëve si Idriz Meta (Çetush), Isuf Lela (Gurrë e Madhe Mat) fisi Kaceli (në fshatin Bel të Matit) Sulë Capa (Kllobçisht), Mexhit Capa (Dibër e Madhe) të gjithë këta nga Selishta e Katër-Grykëve. Libri “Katër-Grykët e Dibrës” i Qazim Prejsit i ngjan një galerie të çmuar me minerale ku agronomi, intelektual, ish kryetar i kooperativës Lurë e drejtues (kryetar) i degës së planshërbimeve në drejtorin e postë-telekomunikacionit në Peshkopi e së fundmi në drejtorinë e ujërave të Dibrës z. Qazim Prejsi ka gjurmuar e pasqyruar historinë e figurat, ngjarjet, luftërat e traditat e vendlindjes, Katër-Grykëve të Dibrës qysh në lashtësi, deri në vitin 1940.

Ndonëse në moshën 78 vjeçare e me banim në Lezhë kurrë nuk rreshti së gjurmuar. Shembulli dhe përkushtimi i tij përbën vërtetë modelin e intelektualit e të studiuesit, i cili “nektarin” e jetës, të historisë e të fisnikërisë e gjen në vendlindje.

Libri “Katër Grykët e Dibrës” i Qazim Prejsit është një dëshmi e qartë e madhështisë së popullit, brezave të Katër-Grykëve të Dibrës, përbën vërtetë një përmendore për vendlindjen, për brezat, për historinë.

Në faqet e këtij libri, historianët, studiuesit, gjuhëtarët, folkloristët, kulturologët, mësuesit, e cilido lexues gjen këndin e punës së tij, vlera të rralla, thesarë të shpirtit, trimërisë e mençurisë së brezave.

Botim i ri



Revolucioni i gjelbërt, një dokument strategjik për mbrojtjen e pyjeve

Me 30 gusht 2014, në sallën e Teatrit të Metropolit në Tiranë, u promovua libri i autorit Selman Meziu “Revolucioni i gjelbërt”.

Ishin të pranishëm në këtë promovim pedagogë, specialistë pyjesh, veteranë, studiues, miq të autorit, etj. Për vlerat dhe risitë që sjell ky botim e morën fjalën mjaft të pranishëm, të cilët vlerësuan punën dhe kontributin e Dr. Selman Meziut, jo vetëm me këtë botim, por edhe me shumë shkrime të tjera që lidhen me problematikën dhe dëmtimin e pyjeve në Shqipëri.

Selman Meziu, prej shumë vitesh jeton dhe punon në Itali. Ai mban lidhje me kolegët, ndjek nga afër problemet e pylltarisë shqiptare. Para pak muajsh, përmes rrjetit social Facebooku, ai inicioi një peticion, një debat publik, ku morën

pjesë shumë specialistë pyjesh, kryesisht ata që sot jetojnë jashtë vendit.

Ky botim i veçantë përmbledh pikërisht atë “debat”, komentet e specialisteve të pyjeve, dhe jo vetëm të atyre, për pylltarinë shqiptare. Ai me këtë botim voluminoz, sjell shumë fakte dhe komente ku evidentohet gjendja e rëndë e pyjeve dhe personelit pyjor që nuk e ushtron dot profesionin. Ai shkon me tej, ku në formë thirrje kërkon që strukturat përkatëse të shtetit, kushdo që ka në dorë të ndalojë degradimin e mëtejshëm të mjedisit natyror në përgjithësi dhe pasuritë pyjore në veçanti.

“Gjeta këtë formë për të ngritur zërin, në mbrojtje të pyjeve, të kësaj pasurie që unë dhe shumë kolegë brenda dhe jashtë vendit ju

përkushtuam në formimin tonë profesional dhe punuam në këtë sektor. Unë, në këtë botim përveçse kam shprehur të gjitha ndjesitë e mia në dashurinë dhe apelin në mbrojtje të pyjeve, investova të gjitha kursimet e mia për të arritur që ju kolegë të pyjeve, ju qeveritarë, tu sjell një gjë të shkruar me fakte, por dhe me rekomandime që gjendja e pyjeve të mos përkeqësohet”, tha Meziu gjate prezantimit të botimit.

“Kaq munda të bëja si një zë i vetëm në këtë përmbledhje, por ju ftoj ju kolegë, që të bashkoheni, të jeni një zë i fuqishëm dhe një faktor që të veproni konkretisht, që tashmë kaq pyje sa kanë mbetur të mos dëmtohen më tej.

Le ta quajmë “Rilindjen shqiptare” për analogji tek pyjet “Revolucion të Gjelbërt”

Nga Prof. Dr. HAJRI SHEHU

Libri “Përjetime, meditime” i profesor Zenel Sulës është një ditar me mbresa nga jeta e tij shkollore, familjare, shoqërore etj. Në libër ka emra konkretë dhe ngjarje konkrete. Përmen-den të afërm e të largët, kolegë e miq. Emrat dhe ngjarjet janë si personazhet dhe ngjarjet në një krijim letrar e kështu, vetë ditari është letrar. Edhe përshkrimet e udhëpërshkrimet janë letrare. Në libër ka edhe fotografi e kësisoj, emrat, ngjarjet e fotot bëhen njësh.

Zenel Sula. Një shkollor e student i dalluar në të gjitha nivelet. Po aq i dalluar edhe si pedagog, si drejtor shkolle, si studiues, si redaktor e si zyrtar e specialist në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës. Por këto nuk thuhën as midis rreshtave sepse ai flet pak për veten e për punën e tij të dalluar. Në libër gërshetohet bukur individualja me shoqëroren, e veçanta me të përgjithshmen. Aty ka histori të familjes së tij, të fshatit të tij, të krahinës së tij e më gjerë. Dhe lexuesi mëson se formimi i tij shpirtëror e kulturor dhe i personave të tjerë që përmenden, është arritur jo vetëm nëpërmjet shkollës, por edhe në mjedisin familjar e shoqëror të fshatit e të krahinës.

Libri paraprihet nga një parathënie e prof. Enver Hysës. Ajo është një sintezë e vetë librit. Parathënien e plotësojnë bukur shkrimi “Në vend të hyrjes” nga autori, profesor Zeneli dhe thënia kup-timplote e bashkëshortes së tij të nderuar, Sanies, në kapakun e dytë të librit: “Lexojeni këtë libër, që ta njihni Zenel Sulën, siç e kam njohur unë.” Dhe vërtet, ata që e kanë njohur, e njohin edhe më shumë. Dhe njohin një njeri, aq dinjitar. Motoja e librit është: “Pa të shkuar nuk ka të ardhme”.

Kur lexova librin, mësova se në fëmijëri profesori ka rrajtur dhitë. Në libër ka një episod shumë të bukur, kur një herë humbi gjysmën e tufës në pyll. Jam i bindur që profesori e ka përmendur ruajtjen e dhive jo, thjesht si punë fëmijësh në fshat, por për të dhënë një mësim: Pa punë nuk arrihet asgjë. Çdo punë e mirë, sado e thjeshtë qoftë, është e vyer dhe e vlerësuar. Kam rastin të them se nga leximet e mia kam mësuar se edhe Profeti Muhamed ka kullotur delet. Kur i erdhi dikush për t’i kërkuar diçka, Profeti i tha: “Mos u dridh! (I ardhuri kishte emocione sepse ishte përpara të Dërguarit të Zotit). Unë jam ai që kam mjelë dele”.

Profesor Zeneli shkruan me shumë dashuri e me shumë admirim për njerëzit e afërm. Kjo është krejt e natyrshme e krejt njerëzore. Por kjo dashuri e ky admirim shkon edhe te njerëz të largët – tek të gjithë njerëzit, me të cilët ka pasur të bëjë. Profesori e do shumë fshatin e lindjes e flet me përgjërëm për të. Sa mirë e sa bukur që nuk ka asnjë zbehje! Kam parasysh që qysh në adoleshencë profesori ka jetuar, mësuar e punuar jashtë fshatit – qyteteve, përfshirë edhe Moskën dhe në njëfarë mënyre mund të kishin pasur ndikimin e vet. Mirëpo jo.

Libri ka episode të bukura që të lënë mendueshëm për një copë herë. Janë shumë njerëzore. Shumë interesante. Shumë mbresëlënëse. Në një roman a novelë, ato do të ishin mirëfilli pjesë e tyre integrale. Shih, për shembull, episodin e ndarjes së vëllezërve – aq paqësisht e aq vël-lazërisht - si vëllai me vëllai. Shih zgjuarsinë e dajë Hajdarit dhe të Tafë Sulës me ushtarët serbë, me gjeneral Acin të divizionit “Firence” pas kapitul-limit të Italisë, në shtator 1943, bisedën për vlerën që ka mendja e një të moshuari etj. Një episod tjetër është ai i një mikui të largët nga Stebleva që kishte sjellë edhe të shoqen t’u mësonte grave si gatuhej buka e thekrës. Sa njerëzore! Përcjellja për në Normalen e Elbasanit, ku gëzimi i shkollës përzihet me lotët e përcjelljes është, gjithashtu një episod i bukur. Gjithkush e ka provuar këtë ndjenjë. Një episod tjetër i bukur është ai në stan me partizanët. Pjekja e gështenjave të zgjon të tjera emocione.

Episodet flasin vetë. Por ajo që dua të nënvizoj është se në gjithçka që thuhet, autori i ndërlihd gjërat bukur. Madje, duhet sikur e përmend diçka, në dukje, e vogël, për të nxjerrë një përfundim të madh. Për lexuesin, domosdo. Ai bën debate me Zhan Zhak Rusonë. Ai bën debate për panteizmin e Naim Frashërit. Edhe për teorinë evolucioniste të Darvinit. I ndërlihd gjërat edhe në kohë, edhe në hapësirë. Flet për një të shkuar të mirë dhe qorton një të tanishme të keqe. Kujton Zerqanin e bisedat në Zerqan dhe komenton Europën e sotme.

Me përshkrimet e bukura etnografike, historike e kulturore, libri është mirëfilli edhe një enciklopedi. Shih, për shembull, përshkrimet që bëhen

Përjetime dhe meditime që na japin mësim të gjithëve



për fejesa e për martesë. Ato janë si t’i përjetosh vetë e jo si në libër. Me përshkrimet e tjera të natyrës, libri është si një visore (peizazh) e bukur a si një dokumentar i bukur, që ti e merr vesh se mbaroi vetëm kur ndizen dritat elektrike të sallës. Thëniet nga mendimtarë dhe njerëz të urtë popul-lorë, “Kuriozitetet” dhe “Zakone të çuditshme” në fund të librit, të gjurmua e të qëmtuara me dijen, intuitën dhe kujdesin e një njeriu të ditur të bëjnë të mendosh shumë.

Shumë i mësohet në libër moralit të shoqërisë. Dashuria për njerëzit është e vetmja forcë që mund t’i kundërvihet botës së shthurur. Nëse ti arrin ta mbushësh shpirtin me dashuri, atëherë e ke mundur të keqen. “Moralit është ai pushtet, - citon autori Kornelius Neposin, - që i siguron njeriut lirinë e vërtetë”. Nëpërmjet bisedave e rreshtave, na thuhet si t’u qëndrojmë larg të këqijave, si të ruhem nga veset, egërsia, pabesia, egoizmi, urrejtja etj. Ka disa tregime për preokupimin dhe përpjekjet e tij në raste sëmundjesh e jo vetëm për të afërm të tij (si për doktor Aliun, një njeri fisnik, i cili siç shkruan prof. Ahmet Kamberi, zbuloi salmonelën “Dibra” dhe qe pararendës i identifikimit dhe i tipizimit të saj), por edhe për bashkëfshatë. Në libër përmenden aq shumë raste solidarësie në kohë të vështira. Një moral kaq i lartë. Ky është edhe ai Zeneli, për të cilin bashkëshortja e tij, Sania, thotë: “Lexojeni këtë libër që ta njihni Zenel Sulën”.

Në libër sheh gjithandëj moralin e lartë të krahinës, në të gjitha kuptimet që ka fjala moral. Lexo, për shembull, kur u gjet një thikë në kullotë e ajo u kthye menjëherë aty ku ishte gjetur, sepse me siguri do të shkonte ta kërkonte aty i zoti i saj. Shih pastërtinë e një nëne nga Zerqani. Por pastërtia trupore është gjysma e besimit, - thotë feja islame. Edhe bisedat, edhe përrallat ishin vetëm të moralshme në familje, në fshat, në krahinë, - thotë autori. Dhe për ta përmbyllur, citon një filozof: “Jetoni e punoni në atë mënyrë që të mos ju vijë turp për sjelljet e veprat tuaja!”. “Tek shkruaj këto fjalë, - thotë autori i librit, - më vijnë në mendje zyrtarë të sotëm... që të kërkojnë rryshfet edhe për shërbime fare të thjeshta”.

Një kapitull i veçantë në libër është “Medi-time”, me nëntitull “Shkolla – vatër e edukimit moral”. “Gjatë karrierës sime kam ndier kënaqësi, - thotë profesori, - pasi më ka takuar të punoj me mësues të përgatitur në mënyrë të admirueshme nga ana profesionale. Fjala e tyre ishte me peshë, - vijon ai më tej, - për arsye se thuhej me dashamirë-si e mençuri. ” Dhe flet në mënyrë të veçantë për edukimin moral të nxënësve nga mësuesit. Më tej, profesori flet për vlerën e pazëvendësueshme që ka libri për nxënësin dhe për studentin. Tek shkruaj këta rreshta, më kujtohet një thënie shumë vlerësuese e shkrimtarit Viktor Hygo për mësuesin: “Dy janë nëpunësit kryesorë të shtetit – nëna dhe mësuesi”. Profesor Zeneli shkon një me një me këtë vlerësim. Mësuesia e profesor Zenelit ishte për t’u admiruar.

Profesor Zenel Sula na mësoi letërsinë në

■ Përjetimet janë të bukura.

Meditimet janë të mëdha. Janë

meditime që na japin mësim

të gjithëve ne. Ato kanë të

bëjnë me jetën, me moralin,

me dijen, me shoqërinë e me

individin. Kësisoj, libri nuk

është vetëm për familjen e të

afërmit e profesorit, as vetëm

për Zerqanin që ai e do aq

shumë, as vetëm për krahinën e

tij. Është për të gjithë.

kuptimin e vërtetë të fjalës. Na mësoi metagjuhën e letërsisë – gjuhën që shpjegon letërsinë. Nga profesor Zeneli ne mësuam të bënim analizë të veprës letrare. Ne mësuam të bënim referate për vepra të caktuara a për autorë të caktuar. Ishte një formim më tej se shkollor.


Profesori qe diplomuar në një universitet me emër botëror - universiteti “M. V. Lomonosov” në Moskë. Por jo vetëm kaq. Qe një diplomant i shkëlqyer. Tashmë, edhe një pedagog i ri, me ndezull, vrull dhe përkushtim për t’ua dhënë nxënësve tërë dijen e vet. Do të jap vetëm pak shembuj për këtë. Profesori nuk mjaftohej vetëm me tekstin. Për tema të caktuara ne mbanim shënime. Kemi mbajtur shënime për Naimin e për rilindësit, për Ndre Mjedën, për “Klubin e Selanikut” ... Kur kanë shkuar në fakultet, nxënësit e pedagogjikes së Peshkopisë e kanë ditur ç’do të thoshte të mbaje shënime. E kishin mësuar nga profesor Zeneli. Këto shënime e këto dije u shërbyen shumë në fakultet për tema që i kishin zhvilluar në Peshkopi. A ishin mbingarkesë për nxënësin? Aspak. Ishin dije plotësuese pas tekstit. Ato na ftilonin shumë. Dhe i mësonim me endje.

Me sa duket, nga letërsia e huaj, profesori kishte për zemër Tolstoin. Më kujtohet si sot, kur profesori shpjegonte “Lufta dhe paqja” e “Ana Karenina” të Tolstoit. Herë pas here ngrinte buzën e poshtme mbi të sipërmen (duket ishte një kënaqësi e veçantë që shpjegimi e mësimi ecnin bukur). Ndonjëherë, do të ngrinte flokët që i binim mbi ballë. (Profesori i kishte flokët shumë të dendur dhe mrekullia është që edhe sot i ka po aq të dendur). Ngrysej kur shpje-gonte fundin tragjik të Ana Kareninës dhe çelëj në fytyrë kur fliste për Kutuzovin. Emrin *Lev Nikolla-jeviç Tolstoi* e shqiptonte me shumë ëmbëlsi. Më vonë, unë pata rastin të shkoja në Moskë për stu-dime. Na çuan të vizitonim shtëpinë-muze të Tol-stoit. Në Jasnaja Poljana kam kujtuar me dashuri, mirënjohje dhe nderim profesor Zenelin për gjithë dijen që na kishte dhënë në letërsi. Edhe atëherë, por sidomos më vonë, kam menduar e kam thënë (si unë, edhe të tjerët): Ky profesor Zeneli duhej të ishte në Tiranë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë. Leksionet e tij do të ishin dinjitare për auditore universitetesh. Ai duhej të ishte studiues në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, të Akade-misë së Shkencave, ku do të kishte shkëlqyer. Por, ani. Ai mbushi rrethet e Veriut (në pedagogjiken e Peshkopisë, nxënësit vinin kryesisht nga disa rrethe të Veriut) me mësues shumë të mirë e me dije shumë të mirë në letërsi.

E veçanta tjetër e orëve të letërsisë me profesor Zenelin ishin hartimet dhe mësimi përmendsh i pjesëve a i vargjeve të caktuara. Analiza e kor-rigjimeve të hartimeve për çdo nxënës në klasë ishte shumë frytdhënëse. Mësonim si duhej të shkruanim, si duhej ta ndërtonim frazën. Në këto orë ne mësonim edhe gjuhë - zgjedhjen e fjalës e drejtshkrimin e fjalës. Mbjaj mend që shkruanim ga-bim shkronjën ë në fjalët *shqiptar* e *kopsht*. Gabimi i parë ishte ndoshta ndikim nga vjersha e Çajupit

Gusht 2014 - 17

Duke lexuar librin e profesor Zenel Sulës “Përjetime, meditime”, Tiranë, 2014




“Shqipëtar” (e kishim mësuar të gjithën përmendsh dhe mund ta recitonim në çdo moment). I dyti, nuk e di pse. Me durim, profesori na i hoqi këtë gabim e shumë gabime të tjera drejtshkrimore. Drejtsh-krimi i gjuhës shqipe kishte vlerë të veçantë për profesorin. Profesori kënaqej kur shkruanim bukur në hartime si për një krijim letrar. Kur kënaqej fort, nuk i mjaftonte fjala “shumë mirë”, por “Të lumtë!”. Shkruar me laps të kuq. Sa për pjesët përmendsh, mbaj mend që ato ishin shumë të këndshme për ne. Dhe për habi, s’e kishim zor t’i mësonim. Dhe t’i recitonim në klasë. Kur jam bërë vetë mësues, e kam vlerësuar këtë kërkesë dhe këtë detyrë shtëpie të profesorit: Te nxënësi zhvillohet aftësia e të folurit rrjedhshëm e bukur.

Profesori na mësoi të lexonim letërsi artistike. Bëhet fjalë për vitet 1956-1960. Ku dinim ne atëherë ç’do të thoshte të lexosh një novelë a roman. Madje, mbaj mend që diskutonim midis nesh: Ou, po ku lexohen 100 e 200 faqe! Por na mësoi profesor Zeneli. Dhe pastaj ia ndjemë lezetin. Lexuam “Donin e qetë” – disa qindra faqe e vepra të tjera. Mbjaj mend, mua më dha në fillim një novelë, me titull “Pranvera në Sakenë”. Ishte përkthim nga rusishtja. Sakena qe një fshat i largët, provincial. Mua më ngjante me fshatin tim dhe më pëlqeu. Pastaj bëra referatin. Se si mund ta kem bërë, nuk e di. Ama, unë lexova diçka. Dhe mësova diçka jashtë klase. Profesori na mësoi edhe të bënim krijime letrare. Çdo nëntor mbyllej konkursi në shkollë për krijimet më të mira letrare. Ishte një nxitje shumë e madhe për nxënësit.

Vetëm dy fjalë për profesor Zenelin si drejtor. Besoj se janë shumë domethënëse e shumë kupt-implote. Ndoshte ndonjëherë që si adoleshentë e si të rinj, bënim ndonjë gabim a thyerje disipline në klasë, ose ndonjë mungesë pa arsye. Kishte ndonjë mësues që pasi të nxirrte nga klasa, të thoshte: “Të shkosh te drejtori, pastaj të hysh në klasë!”. Kjo ishte shumë e rëndë. Në drejtori hynim sedërlënduar. Çdolloj dënimi tjetër të mësuesit do ta prananim, veç te drejtori të mos na çonte. Ishte ndjenja e turpit dhe e respektit të madh që kishim për drejtor Zene-lin. Më pas, kur jam bërë vetë mësues, kam menduar që edhe nga pikëpamja pedagogjike e edukative, një veprim i tillë nuk ka qenë pozitiv për mësuesin dhe për autoritetin e mësuesit. Drejtor Zeneli nuk na bërtiste. Vetëm na këshillonte. Madje, shprehte bindjen që herë tjetër kjo nuk do të ndodhte. Kjo fjala e fundit na ngrohte e na inkurajonte shumë. Sidoqoftë, dilnim të turpëruar nga drejtorja e me vendimin që për veprime të tilla të mos shkonim më kurrë te drejtori. Ndërkohë mendoj: Sa shumë punë ka pasur drejtori dhe si i ka përballuar aq mirë! Si ka shkëlqyer shkolla pedagogjike e Peshkopisë? Dhe, cili ka qenë roli i drejtorit në atë shkëlqim? Dhe, a e kanë bërë drejtorin Zenel Sula “Mësues të Popul-lit”? Po, a e kanë dekoruar për punën e tij vigane? Sidoqoftë, edhe po të mos e kenë bërë Mësues të Popullit, ai është Mësues i Popullit. Ai është Mësues i Popullit me punën e tij më se 50-vjeçare.

(Vijon në faqen 23)

“Alegoria e Dibrës, filozofi e shekujve”



MEVLUD BUCI
ALEGORIA E DIBRËS,
FILOZOFI E SHEKUJVE
Gjurmime alegorike - Anekdotat - Shprehje popullore

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-34-1
Formati: 140 x 205mm
Nr. i faqeve: 288
Çmimi: 1200 lekë

Për kontakt:
“M&B” - Botime
dhe Studio Grafike
Rruga “Zenel Baboçi”, Pall. Ferar
E-mail: mbbotime@gmail.com
+ 355 4 22 33 283
+ 355 68 65 08 441
+ 355 69 20 68 603
+ 355 67 30 73 265

Botimet e Shtëpisë Botuese M&B,
mund t’i gjeni pranë librarisë
në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e
librarive “Adrion”, libraria “Eva”
pranë Pallatit të Kulturës,
Libri Universitar si dhe në pikat e
shpërndarjes së librit.

kulturës shpirtërore dibrane, Mevlud Buci është një tjetër krijues, folklorist e kulturolog me një diapazon të gjerë krijues e mbledhës të thellësive të shpirtit popullor, ku në këtë përcjellje përkushtuese, Dibra, sigurisht, mban kryet e vendit.

Ajo që e bën unikalë Dibrën në gjithë këtë prurje stilemashtë të një të folure të veçantë, me shëmbëlltyra dhe alegori, me kode dhe nënkode të magjishme të thellësive të shpirtit është mençuria e pashembullt e dibranit, filozofia e tij sa e thellë, aq dhe pragmatiste, në përputhje me kërkesat e kohës dhe të bashkëkohës.

Është e famshme mençuria dibrane, por ajo që quhet “alegoria dibrane”, është e paarrtshme në kohëhapësirën shqiptare dhe globale, është Himalaja e pazbuluar ende e një thesari të vyer, që na dëshmon gjurmët e ndritura të mendësisë kolektive dibrane që nga kohët prehistorike dhe mitologjike, deri në ditët tona. Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë diktuese, bindëse.

Pjesë të këtij vektori kulturologjik ka kohë që na sjell me një përkushtim dhe përgjegjësi të madhe mbledhëse e krijuese shkrimtari dhe folkloristi Mevlud Buci, autor i njëzet e tre librave të llojeve dhe zhanreve të ndryshme letrare, ku sundon mbledhja dhe krijimi i proverbave, alegorive dhe të folmeve me ngarkesë stilistike të shumëkuptimtë.

Ky autor ka mbledhur dhe krijuar me mijëra fabula, epigrame, epigrafe, satira, mijëra njësi frazeologjike, idioma dhe të folme të kodifikuara etj., përmbledhur në disa libra voluminozë dhe në qindra shkrime, ku ai shpalos seriozitetin e një studiuesi të pasionuar e skrupuloz.

Në librin “Alegoria e Dibrës, filozofia e shekujve”, libër me gjurmime alegorike, Mevlud Buci përmbledh grimca, kujtesa, porosi të filozofëve popullorë të Dibrës, rrëfime të mjeshtrave popullorë të rrëfimit, bëma e ndodhi të njerzve të mençur të kësaj treve sharmante, ku gjuha ngrihet në një kult lirë dhe qytetërimi, anekdotat, sentenca etj.

Mjafton të sjellim në vëmendje të lexuesit porositë e Salë Markes: “Mos shtini pushkë në vllazni”, “Mos zini nuse në gjak”, “Mos bani zijaftete të teprueme”, “Mos jepni para me fajde”,

“Mos i zini tjetrit udhë kot”, “Kur hyni në valle, hyni me mend e dilni me vesh” etj., për të kuptuar atë mendësi të ngulitur thellë në mendimin dhe veprimin dibran, që vjen përmes gojës së filozofëve pa shkollë të Dibrës, por që janë në lartësinë e devizave të mendjeve më të ndritura botërore të të gjitha kohërave.

Përpjekjet për të krijuar një mendim për gjuhën e kodifikuar, të cilën dijetari francez Roland Barthe e vlerëson si fillesë të asaj që ai e quan metaligjërime, të çojnë detyrimisht në odat e burrave në male, ku nuk mjafton gjuha e drejtpërdrejtë për të komunikuar, por duhet që kjo gjuhë të pajiset me “çelsa të fshehtë”, të cilët mund t’i përdorin vetëm burrat e ditur dhe mendjemprehtë. Oda e Dibrës është unikalë në përdorimin e kësaj gjuhe, e cila me kohë është kthyer në një arketip mprehtësie dhe syçelësie.

Mevlud Buci e njeh me rrënjë këtë gjuhë, ka bredhur odave në male në kërkim të nektarit psiko-linguistik, ka kontaktuar me qindra persona me të cilët ka ndërtuar ura jo vetëm njerëzore, miqësie e bashkëpunimi, por dhe ura kulturologjike, duke e përdorur përvojën e tyre diturore, si “lëndë të parë” për materien e librave të tij të shumtë, që janë një përcjellje virtuoz e kulturës së thellë të shpirtit kolektiv dibran në veçanti dhe të shpirtit kolektiv kombëtar në përgjithësi.

“Alegoria e Dibrës, filozofia e shekujve” është një libër ku autori ka bërë përpjekje shteruese për të nxjerrë në pah botën magjike të popullit, ato thesare të trashëguara që në prehistorinë e largët, që u mbushën me nektar mençurie nga burrat më në zë të Dibrës, Matit e krejt trojeve etnike shqiptare.

Është një rrugë në të cilën kanë vënë gurë kilometrikë mjeshtra të folklorit dhe të kulturës sonë kombëtare, por Buci e çon më tej këtë traditë, pasi me pasionin dhe zellin e tij të admirueshëm, krijon modele arketipale kulturologjike, të denja për një studiues tepër serioz.

Gjithë kjo prurje, jo vetëm në këtë libër, por dhe në librat pararendës të Mevlud Bucit, e bëjnë atë një institucion lëvizës kulturologjik, që sjellin drejt lexuesit një botë të tejndezur pasioni, në gjurmët më të ndritura të kulturës gjuhësore, estetike dhe kulturore të trevës së Dibrës dhe të krejt kombit shqiptar.

Dukagjin HATA
Studiues, kritik arti

Ndërsa ndjek rrugën e shkrimtarit, studiuesit dhe kulturologut Mevlud Buci gjatë këtyre njëzet e tre viteve të çlirim të letrave tona kombëtare nga dogmatizmi dhe jashtëletrarja, nuk mund të mos kuptoj se kryefjala e kësaj krijimtari është Dibra dhe, dashje pa dashje, faqe pas faqeje të kësaj krijimtari të gjerë e të larmishme, shpërfaqet një botë e magjishme, plot dritëhije, me një gjuhë të denjë për podiumet më të famshme të oratorisë dhe gjykimit kolektiv. Ndaj, tok me fragmentet e librave të Mevlud Bucit, më vijnë në mendje dhe pika lidhjeje në kohë, mendje të ndritura, që e ekspozojnë Dibrën tonë në vëmendje të plotë të diturore.

Në vitin 1502 një i huaj, Feliks Petani, i referohet Dibrës (Dibri) si qytet me shumë banorë, dhe në atë kohë ajo njihej si një qendër e rëndësishme qytetare. Pukëvili, na bën me dije se ndryshe nga mjaft qytete të tjera, elementi sllav aty mungonte fare. Për francezin tjetër Ami Bue, populli i Dibrës është “i vyeshëm”, me vlera. Por ajo që është cilësuar nga të huajt dhe vendasit si “kryeshenja e identitetit shpirtëror dibran” është e folmja “qesh e ngjesh”, “qaj e qesh”, e folmja me dy e më shumë kuptime, me alegori dhe shëmbëlltyra.

Autori Mevlud Buci ka kërkuar shumë në këtë lëmë të kulturës popullore, duke na përcjellë të botuar

libra me vlerë në fushën e kërkimit të shpirtit dhe etnopsikikës kolektive, ku fabulat, shëmbëlltyrat, parabolat, anekdotat, grimca të krijuara apo të mbledhura në gjirin e popullit, gjurmimet gjuhësore dhe letrare rreth të folmeve me dy kuptime, alegorike etj, janë pjesë e vektorit krijues dhe kulturologjik të këtij autori.

Në rrugën e Dine Hoxhës, të mbiquajturit “Dekan i Universitetit të Dibrës”, “Sokrati i Dibrës”, “Profesor i Alegorisë Dibrane”, Haziz Ndreut, këngëtarit, folkloristit dhe kulturologut emblematic, Xhafer Martin, i cili ka gjurmuar dhe përcjellë me një aparat të veçantë shpjegues dhe reflektiv pjesë të thesareve më të vyera të

Në sallën e bibliotekës Peshkopi, u promovua libri i dytë i poetes Urime Straka. Poetë e shkrimtarë dibranë, lexues dhe miq e dashamirës të poetes mbushën sallën dhe e ndoqën me interes aktivitetin. Fjalën e hapjes e mbajti drejtoresha e bibliotekës, zonja Liljana Sadiku, pastaj mbi risitë dhe vlerat artistike të librit “Përtej ëndrrës” foli zoti Isuf Miha.

Me mjaft vëmendje dhe interes ishte diskutimi i zonjës Violeta Neziri, mësuesja e gjimnazit dhe njëkohësisht redaktore e librit “Përtej ëndrrës” të Urimes. “Autorja e librit kërkon të gjejë veten në mjediset që janë të gjithkundgjeshme” – thotë Violeta Neziri.

Edhe mësuesi i Letërsisë, Neki Iskurti, nxori në pah vlerat e librit duke e krahasuar me librin e parë me poezi “Qetësisht” të po kësaj autoreje, ka një arritje dhe pjekuri artistike. Historiani dhe shkrimtari Moisi Murra e mbyll diskutimin e tij me fjalët “Urime Urimes”.

Pastaj vazhdoi diskutimi mes autore dhe auditorit për titullin e librit, për krijimtarinë në përgjithësi. Folën mësuesit Silvana Zajmi, Bashkim Çiku, krijuesi dhe mjeku Edmond Hasani si dhe myftiu i Dibrës zoti Ahmet Çausi. Në fjalën e saj përshëndetëse autorja përshëndet të pranishmit, diskutantët si dhe sponsorin e librit zotin Shkëlzen Qoka.

Në gjithë krijimtarinë e poetes së re Urime Straka, studente nga Peshkopia, zë vend të rëndësishëm në temat aktuale, gëzimi, shqetësimi dhe fenomenet e ditës së sotme në shoqërinë tonë. Vetë moshë e saj e re por me një pjekuri artistike, tema e bashkëmoshatarëve të saj shkruhet me dashuri dhe përkushtim. Dashuria

Risitë e një libri



në kuptimin e vërtetë të fjalës është lajtmotiv i që përshkon gjithë krijimtarinë e saj, një dashuri e bukur, shkruar e bukur, e me

dashuri e ndjenjë. Kështu autorja në personazhet e saj janë njerëz të dashuruar me jetën, me familjen, me sinqeritetin deri në detaj për babin “Le t’i mburrem botës për ty dhe krenare të mbroj termin mashkull ideal”.

Yll pa emër është titulli i një skice letrare, një bashkëbisedim i motrës me vëllanë, në një largësi fizike por jo shpirtërore. Nga të gjithë yjet në hapësirën qiellore është një yll më i bukuri, por pa emër, që mund të marrë emrin e vëllait në dashurinë e motrës.

Unë shkruaj për veten, për qetësinë më të këndshme të shpirtit tim – thotë autorja.

Ndërsa studiuesi Isuf Miha duke shkruar për librin “Përtej ëndrrës” thotë: “Poetja shkruan risitë e modernitetit, përdor vargun e matur pa trille e shkapërdredhje në emër të modernizimit”.

Fëmijëria, adoleshenca dhe sinqeriteti i moshës, dashuria e vështuar artistikisht në këndvështrimin e saj e me pjekuri artistike janë tema të realizuara bukur.

“Atij i mungoj, ashtu siç më mungonte mua ajo kohë (fëmijëria), shkruan Urimja tek skica “Arushit tim” faqe 87.

“Jeta”, “Nën lëkurën tënde”, “Shi ndjenjash”, “Mëkat i dashurisë”, “Më thuaj ku të gjej” etj., janë jo vetëm tituj intrigues, por me një tematikë ndryshe nga ç’kemi lexuar dhe të shkruara me ndjenjë. Figuracioni është i thjeshtë, i goditur për të përcjellë më qartë idetë dhe mesazhet, shkruan në parathënien e librit redaktorja Violeta Neziri.

Ilmi Dervishi

globalizim

Nga **SEJDI M. GASHI**
Instituti Albanologjik -Prishtinë

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim kemi bërë përpjekje që të trajtojmë procesin e globalizimit, ndikimin që mund të ketë ky proces në gjuhë, veçmas në gjuhën shqipe si dhe kujdesin që po tregojnë shqiptarët për gjuhën e tyre amtare.

Në përgjithësi, në ditët e sotme, procesi i globalizimit synim parësor ka që të krijojë diçka të re, të pa qenë më parë, të paktën jo në formën dhe masinë e synuar, kurse në rrafshin gjuhësor, globalizimi vlerësohet si një dukuri me përmasa gjithë botërore që po shpie në ngritjen marramendëse të ndikimit të anglishtes në të gjithë botën, funksion ky që për shumë shekuj e kishte gjuha latine.

Përkundër cilësimit të anglishtes si gjuhë botërore, që po realizon ndikimin e vet përmes teknologjisë së informacionit, medie, prapëseprapë shtrirja e rrjetit të internetit në të gjithë botën, mund të llogaritet si shpëtim për gjuhët e tjera, pasi që në këtë formë janë krijuar hapësira të reja për zbatimin e shumëgjuhësisë.

Së këndejmi, në rrafshin gjuhësor të shqipes, globalizimi ka ndikuar që ajo t'i ekspozohet një lloj përshtatjeje apo edhe simbioze me komunikimet gjuhësore që po realizohen sot në nivel botëror e që kjo përshtatje në vete duket sikur ka sjellë edhe një lloj ndryshimi në aspektin e stileve të komunikimit në gjuhën shqipe.


HYRJE

Gjuha paraqet sistem shenjash dhe idesh që së bashku përbëjnë mjetin kryesor të komunikimit të njerëzve për të kumtuar mesazhe ndaj të tjerëve, por edhe për të pranuar mesazhe. Një nga tiparet dalluese të njeriut nga gjallesat e tjera është edhe forma e komunikimit gjuhësor. Historikisht njerëzit kanë komunikuar midis vetës qoftë në formë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë p.sh me anë të shkresave të ndryshme, përmes të të dërguarve, por gjithherë si mjet komunikimi është përdorur gjuha, qoftë e folur apo e shkruar.

Lidhur me gjuhën, në histori ekziston një legjendë, e përshkruar në Librin e 11-të të Gjenezës, ku në fillim të gjithë njerëzit kishin një gjuhë dhe përdornin po të njëjtat fjalë. Kur erdhën nga Lindja, u vendosën në një rrafshinë diku në Tokën e Shinarit (Sinajit), filluan të piqnin qerpiç për të ndërtuar vendbanimet e tyre. Gjatë kësaj pune u lindi ideja për të bërë një qytet me një kullë shumë të lartë deri në qiell në mënyrë që ta rrisnin namin e tyre dhe të gjithë të kenë një vend të përbashkët të banimit e jo të jenë të shpërndarë nëpër botë. Kur Zoti mësoi për idenë e tillë, zbriti nga qielli dhe duke kuptuar se ishin një popull dhe flisnin të gjithë një gjuhë, vlerësoi se në këtë formë nuk mund të ndalohej njerëzimi që t'i arrijë të gjitha në këtë botë. Prandaj, Zoti vendosi që të krijojë shumë gjuhë, në mënyrë që njerëzit të mos kuptoheshin në mes vete dhe kështu të arrijë që ata t'i shpërndajë nëpër të gjitha pjesët e botës. Ai vend u quajt Babel apo Babilon që do të thotë hutim, për arsye se Zoti vendosi që të krijojë shumë gjuhë në mesin e njerëzve, të bëjë të mos kuptoheshin midis vete dhe kështu ta ketë më të lehtë shpërndarjen e tyre gjithandej botës, pra kësi soji shkaktoi hutit të njerëzimit!

Tani le të kthehemi te çështja se si shihet dhe vlerësohet gjuha si mjet dhe akt komunikimi nga shoqëria e sotme njerëzore. Duke qenë pjesë e shoqërisë dhe në funksion të saj, gjuha

A po cenohet shqipja nga procesi i globalizimit apo nga vet shqipfolësit?



me kalimin e kohës, është bërë pjesë e ndryshimeve. Në këtë drejtim, janë bërë përpjekje, duke filluar nga ajo për të bërë një gjuhë universale për të gjithë qytetërimin njerëzor (që për shekuj të tërë këtë funksion e ka kryer gjuha dhe kultura latine e që sot këtë primat e bartë anglishtja) e deri të krijimi i zhargoneve gjuhësore, gjuhëve minoritare, gjuhëve kombëtare dhe së fundmi procesi i globalizimit i cili po manifestohet në formën e universalizimit të pothuajse çdo fushë-veprimtarie njerëzore, përfshirë edhe gjuhën.

ÇKA PARAQET GLOBALIZIMI, SI MANIFESTOHET KY PROCES NË GJUHË?

Në literaturën shkencore tashmë janë dhënë mendime dhe përkufizime të ndryshme për globalizimin, përfshirë aspektin historik prej kur mund të thuhet se bota është futur në rrjedhat e këtij procesi.

Në enciklopedinë "online", në Stanford Encyclopedia of Philosophy, globalizimin e gjejmë me këtë përkufizim: "Në diskursin e përditshëm globalizimi shpesh funksionon pak më tepër sesa një sinonim për një a më shumë nga fenomenet në vijim: përkrahja e politikave klasike liberale (ose të "tregut të lirë") në ekonominë botërore ("liberalizimi ekonomik"), dominimi në rritje i formave të jetës politike, ekonomike dhe kulturore perëndimore (ose edhe amerikane), përhapja e shpejtë e teknologjive të reja të informacionit ("revolucioni i internetit"), si dhe nocioni se njerëzimi është duke qëndruar në pragun e realizimit të një bashkësie të vetme të njësuar, në të cilën forcat e mëdha që kanë shkaktuar konflikte shoqërore janë duke u zhdukur ("integrimit global")" (shih: <http://plato.stanford.edu/entries/globalization>).

Ndërkaq, sipas sociologut Anthony Giddens, globalizimi paraqet "Intensifikimin e marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes të cilave vende të largëta mbajnë lidhje me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që ngjarjet në një vend karakterizohen nga të njëjtat procese sikurse edhe në një vend tjetër shumë kilometra larg, dhe anasjelltas" (Giddens, 1990:64).

Duke mos dashur të zgjatim më shumë rreth përkufizimeve teorike lidhur me globalizimin, këtu pajtohem me pohimin e Anthony Gideensit kur thotë se globalizimi ka ardhur si rrjedhojë historike e kolonializmit dhe industrializimit të Perëndimit dhe ndikimit të këtij të fundit në vendet e Botës së Tretë dhe se globalizimi duhet të trajtohet më shumë si dukuri sociologjike, për shkak të ndikimit që ka në jetën dhe në ndryshimet shoqërore..." (po aty).

Sido që të jetë, shumësia e përkufizimeve dhe e përpjekjeve për ta definuar globalizimin, në ditët tona, paraqet vështirësi të konsiderueshme rreth asaj se çka në të vërtetë paraqet ky proces me përmasa planetare!

Si çdo fushë tjetër jetësore edhe gjuha nuk ka mundur t'u ikë ndikimeve që ka sjellë ky procesi. "Kjo temë shtrihet në sërë pyetjesh, të cilat sot për sot kanë marrë disa përgjigje në botë, por jo përfundimtare, pasi që mendojmë se globalizimi ka hapur themelet e një bote e cila ka filluar të rrokulliset në disa binarë të rinj" (Shpresa Hoxha, Gjuha shqipe VS. Globalizimit, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Kulturën dhe Letërsinë Shqiptare, Prishtinë, 2008, f.275).

Sido që të jetë globalizimi, në aspektin gjuhësor, ka edhe veti pozitive, si p.sh përpjekjet zyrtare në nivel të mekanizmave botërorë siç janë OKB-ja dhe BE-ja për ruajtjen dhe kultivimin e shumëgjuhësisë, ndonëse këto parime dhe vlera universale jo gjithherë zbatohen në tërësi (Shefikje Islamaj, Aspekti gjuhësor i globalizimit dhe shqipja standarde, në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Kulturën dhe Letërsinë Shqiptare, Prishtinë, 2008, f. 518). Lidhur me këto përpjekje po përmendim këtu rastin kur Bashkimi Evropian më 5 nëntor 1992 në Strasbourg ka miratuar dhe fuqizuar Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare.

Nga ana tjetër, në ditët tona është dukuri qenësore që globalizimi gjuhësor dita-ditës po zgjerohet me anë të teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit, pasi që me hovin e madh të shpikjeve që emërtohen në gjuhën e shtetit se ku zbulohen apo prodhohen, është e pa mundur të bëhet përkthimi dhe përshtatja e gjithë atyre termave në gjuhën shqipe. Pra, në këtë drejtim vërehet një vërshim i huazimeve në leksikun e shqipes, ndonëse fjala "huazim gjuhësor" për mendimin tonë tingëllon ironike, pasi që po t'i referohemi Fjalorit të shqipes së sotme, fjala huazim ka kuptimin e asaj që mund të huazohet diçka materiale për një kohë të caktuar e pastaj të kthehet te pronari i saj, por jo edhe fjala. Pra, fjala nuk mund të huazohet për një kohë e pastaj të kthehet te gjuha dhënëse, apo jo? Në këtë drejtim, mendojmë se në vend të fjalës "huazim gjuhësor" në shqipen, duhet të gjendet apo krijohet një term i ri, i përshtatëm në aspektin logjik e gjuhësor.

NDIKIMI I GLOBALIZMIT NË SHQIPEN

Siç e thamë edhe më lartë në këtë punim, ndikimi i globalizmit në gjuhë është i dukshëm, veçmas në gjuhët

Procesi i globalizmit është duke ndikuar fuqishëm në shumë gjuhë dhe kultura botërore, së këndejmi edhe në kulturën dhe gjuhën shqipe, ashtu siç ka shtrirë ndikimin e vet edhe në fushën e ekonomisë, politikës, sigurisë e madje edhe në atë të ambientit.

dhe kulturat që u takojnë popujve të vegjël. E tillë është edhe shqipja. Sot kur Kosova ka vetëm 6 –vjet shtet, kur edhe më tutje vazhdon të mos ketë të konsoliduar sa e si duhet institucionet e saja shtetërore, edukative e arsimore, të shkencës, të sigurisë e të drejtësisë, kur ende është në përpjekjet e saja për shtim të njohjeve të subjektivitetit të vet ndërkombëtar, kur ekonomia e saj është jo konkurruese me tregjet globale, të gjitha këto së bashku bëjnë që globalizmi për shtetin tonë Kosovën, por edhe për kombin tonë shqiptar, në përgjithësi, të jetë më i egër, ndoshta më i egër se në shumë vende të tjera të botës.

SA PO KUJDESEMI PËR SHQIPEN?

Krahas shtet-formimit të Kosovës, është nevojë tepër e ngutshme që të kemi edhe konsolidim të mirëfilltë gjuhësor, veçmas në përdorimet e saja publike pasi që gjuha shqipe e njësuar dhe e përdorur me korrektësi për veprimtarinë e administratës është një ndër kërkesat më të para për një shtet (Emil Lafe, Nga liberalizmi gjuhësor të shqipja standarde (vështrim i shkurtër), *Botuar te "Gazeta shqiptare Milosao", 05.12.2010*) modern dhe të përparuar, mirëpo problemi i funksionimit të shqipes së njësuar në shtetin e Kosovës, në të gjitha nivelet e përdorimit, nuk është i kënaqshëm.

Rrethanat politike dhe ekonomike në Kosovë në këto 14 vjetët e fundit kanë bërë që vërtetë shumë fjalë të huaja të futen në shqipen.

Vlen të theksohet këtu periudha kohore që nga viti 1999, kur ndodhi instalimi i Administratës së Përkohshme Ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK-ut), me ç'rast në komunikimin e përditshëm të të shprehurit dhe të të shkruarit profesional administrativ-juridik dhe politik, në gjuhën standarde shqipe, shpesh vërehet një regjistër i zakonshëm, i thjeshtë dhe argotë i fjalëve dhe kuptimeve të përdorura.

"Në këtë drejtim, pa hezitim mund të vlerësojmë se, deri më sot nuk ka asnjë ligj apo ndonjë akt tjetër normativ-juridik, të aprovuar, dikur në kohën e UNMIK-ut dhe tashti të EULEX-it, që nga aspekti gramatikor, terminologjik apo sintaksor, nuk është "masakruar" apo devijuar nga ana e përkthyesve tanë joprofesional që punojnë në këto institucione ndërkombëtare". (Adnan Abrashi, Shpirti i një populli është gjuha që e flet-Gjuha shqipe është e bukur edhe si gjuhë zyrtare administrative-shtetërore, Prizren, 05. 12. 2009).....)

Po ashtu, është tejet qesharake, kur shpeshherë gjatë paraqitjeve dhe

debateve publike të disa politikanëve tanë ndoshta nga mosdija apo si "lapsus", ngatërrohet domethënia kuptimore e termeve "STATUT" me "STATUS", "KONTEKST" me "KONTEST", etj..

Rasti më tipik i përbuzjes së normës së shqipes është ai i ish Kryeparlamentarit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ku jo rrallëherë, gjatë drejtimit të seancave të Kuvendit, u drejtohej deputetëve me lajmërimin e tij " *tash erdhi koha me votuar*". Mund ta merrni me mend se çfarë formimi mund të jetë ky " me votuar"! Të tillë shembuj, ka mjaft që sillen e pështillen nëpër "gramatikën" e deformuar të politikanëve tanë.

Madje edhe nga disa të punësuar në administratën publike dhe shtetërore në Kosovë, nuk po dihet se me çfarë dokumenti si akt formal, raportohet, planifikohet, përcaktohet, vendoset apo rregullohet. Edhe sikur të dihet, posa ta lexosh me vëmendje përmbajtjen e ndonjëres prej tyre, menjëherë aty do të vësh përplot gabime, jo vetëm estetike dhe gjuhësore, por edhe të mungesës konstruktive përmbajtjesore të paraqitjes kuptimore të lëndës, e cila nuk është aspak në harmoni me standardet e përgjithshme profesionale të parapara për atë dokument apo akt konkret. (Po aty).

Një dukuri edhe më drastike e shëmtimit të rregullave të përgjithshme të gjuhës standarde shqipe, e kemi në gjyqësi dhe institucionet tjera të drejtësisë. Për procesverbale, që zakonisht diktohen dhe shkruhen gjatë seancave të rregullta gjyqësore dhe mbeten si interne në lëndët e shumta, as mos të flasim fare, por, mjafton që me vëmendje ta lexoni një AKTVENDIM apo AKTGJYKIM të pranuar gjyqësor. Sa gabime estetike, ortografike, kuptimore, gramatikore dhe sintaksore do të vëreni aty?!

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga tërësia që u tha më lartë mund të nxirren këto përfundime:

Se procesi i globalizmit është duke ndikuar fuqishëm në shumë gjuhë dhe kultura botërore, së këndejmi edhe në kulturën dhe gjuhën shqipe, ashtu siç ka shtrirë ndikimin e vet edhe në fushën e ekonomisë, politikës, sigurisë e madje edhe në atë të ambientit.

Se vërtetë, në mesin e shqiptarëve po mungon kujdesi dhe vetëdija për ta mbajtur të gjallë e për ta pasuruar shqipen me fjalë e terma të rinj që do t'u përgjigjeshin nevojave të kohës. Për më tepër shqiptarët, gjuhën e tyre shqipe, po e trajtojnë si një monedhë në një treg me hiperinflacion. Për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme në mënyrë që të kemi një nivel gjuhësor me të kënaqshëm në Kosovë, në përgjithësi, mendoj se menjëherë dhe pa vonese Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta nxjerrë dhe ta miratojë një ligj të veçantë, përmes të cilit shqipja si gjuhë e shumicës absolute e popullit të Kosovës, duhet të vihet nën mbrojtje institucionale dhe të cilësohet si pasuri kombëtare, në të kundërtën fundi i qenies, kulturës shqiptare dhe gjuhës shqipes si pjesë e saj, mund të kanoset seriozisht nga faktorët që u cekën në këtë punim, por edhe faktorët të tjerë që mund të linden ndërkohë.

Prishtinë, 16 qershor 2014

Romani “Sikur të isha djalë” ishte një nga librat më të lexuar të kohës. Ai ngjalli një lëvizje emancipuese në të gjithë rininë shqiptare...

studim

Gruaja dibrane në veprën e Haki Stërmillit

Nga MENTOR HOXHA
Master Shkencor në “Studime Letrare”

(Vijon nga numri i kaluar)

Ngjarje të tilla qarkullojnë si legjenda të bukura e tronditëse në shumë vise të Shqipërisë, sidomos në malësi, ku vajzën që do një tjetër e martojnë sipas zakonit dhe dhëndri tregohet aq i mirëkuptueshëm e fisnik sa ia çon nusen dashnorit të saj. Në dramë këto të vërteta na jepen në fatin e ndërlikuar nëpër të cilën kalon dashuria e Tanies me Sulën dhe në shpirtmadhësinë që tregon Sufi, burri i Tanies³⁰. Nga të gjitha këto personazhe, jetën më të tmerrshme dhe me një fund të tmerrshëm e ka Dija te romani “Sikur t’isha djalë” (1936).

Duke mos gjetur mbështetjen e duhur nga shoqëria dhe nga i dashuri i saj kosovar Shpend Rrëfeja përfundon tragjikisht. “Dija ngrihet me zemërim kundër çarçafit, këtij “thesit të zi” që ka paralizuar jetën e gruas shqiptare. ...Ajo ngre krye e revoltohet, kritikon e godet, thërret e demaskon pa mëshirë fajtorët, ata që janë përgjegjës për skllavërinë e femrës, por zëri i saj tingëllon si një zë në shkretëtirë; atë asnjë nuk e dëgjon. Në këto rrethana, heroina, e revoltuar, kërkon të martirizohet, për të shpëtuar nga një anë shoqet e veta dhe, nga ana tjetër, me vdekjen e saj, të tërheq vëmendjen e shoqërisë për gjendjen e rëndë të gruas shqiptare. Është interesante të vihet në dukje se ideja e martirizimit të heroinës kalon nëpër një vijë ngritëse: në fillim ajo donte të vdiste e dëshpëruar nga jeta e rëndë, pastaj për shkak të dashurisë së pafat, kurse në fund, duke u bërë më e ndërgjegjshme për luftën që ka nisur, kërkon që me vdekjen e saj, të bëhet flamur i një lëvizjeje të gjërë shoqërore për çlirimin e gruas³¹.

“Romani “Sikur të isha djalë është shkruar në formë ditari, në të cilin tregohen vuajtjet e një vajze që prindërit nuk e lënë të martohet me atë që do, por e japin në derë të pasur. Haki Stërmillin këtu e shqetëson çështja e emancipimit të gruas që ishte mjaft e trajtuar në atë kohë. Ai dënonte skllavërimin dhe martirizimin e gruas shqiptare. Kjo është e para vepër e letërsisë shqiptare për emancipimin e gruas dhe aktakuzë kundër shkaktarëve të tragjedisë së saj³². Në këtë roman shkrimtari e ka lënë aspektin patriotik të figurës së gruas shqiptare dhe ja ka kushtuar veprën pozitës së gruas në shoqërinë e kohës. Ai i tregon lexuesit për gjendjen e vështirë të femrës shqiptare në kushtet e sundimit të feudo-borgjezisë, kur vendi ishte çliruar nga të huajt, por gruaja vuante ende nën prangat e fanatizmit.Fanatizma sipas tij, është një nga hallakat e skllavërisë njerëzore, prandaj bënte thirrje për ta luftuar atë³³. Ky roman bëri bujë të madhe. “Nga suksesi që pati u shtyp sërish pas dy vjetësh (1938), gjë që ndodhte rrallë asokohe. “Ribotimi për të gjashtën herë dëshmon më së miri për meritat e tij të veçanta shoqërore dhe

kjo shpjegon interesimin e gjerë e popullaritetin e merituar që gëzon kjo vepër ndër këndonjësit tanë³⁴. Të gjitha gazetat e revistat e kohës zbuluan vlerat e romanit dhe të autorit nga Dibra. Bashkëkohësi i Stërmillit, Lazër Radi në librin e tij “Shqipëria në vitet ’30-të shkruan:

“Një nga librat më të lexuar të kohës, ka qenë romani “Sikur të isha djalë”, i Haki Stërmillit. ... Romani ngjalli një lëvizje emancipuese në të gjithë rininë shqiptare. ...E kërkonin në mënyrë të veçantë vajzat, sidomos ata të mbyllurat në shtëpi. Në ato vite, fanatizmi ka qenë sëmundja më e rëndë e vendit tonë. Si pasojë, pak vajza ndiqnin shkolla dhe kjo kishte bërë që ato të mbeteshin prapa dhe analfabete të shekullit. Di disa raste të vajzave të mbyllura që kanë mësuar të shkruajnë e të lexojnë vetëm e vetëm për të lexuar romanin “Sikur t’isha djalë”. Ai trajtonte një problem që i interesonte mbarë popullit shqiptar e në mënyrë të veçantë vajzave shqiptare që ishin më të persektuarat e më të diskriminuarat e asaj kohe. Ky libër doli në një çast kur shtypi, letërsia dhe shteti po merreshin me problemin e madh të reformës shoqërore. Në “Yllyria” po lexonim novelën “Lilusha vajzë shqiptare” të Ernest Koliqit. Migjeni po përgatiste novelën shkodrane “Të hapën arkapijat”, qeveria nxori dekretin sipas të cilit duhej të hiqej “perçja” dhe asnjë grua nuk do të dilte me perçe në rrugë. ... Në një çast shumë të volitshëm doli romani i Haki Stërmillit “Sikur të isha djalë”, në qendër të të cilit është një vajzë e thjeshtë, viktimë e fanatizmit, skllave e ligjeve të ashpra dhe disa zakoneve të mbrapshta që vazhdonin ta brenin shoqërinë shqiptare. Megjithatë tani kishim arrijtë të bëheshim një shtet i konsoliduar, një monarki mjaft konstituciale, prap se prapë mungonin forcat e duhura për të zbatuar reformën. Meritë e madhe e Haki Stërmillit është se solli në letërsinë shqiptare personazhin “Dije”, në mjediset e së cilës shtypja dhe poshtrimi i gruas ishin në skajet e fundit, ishin aty ku nuk mbante më. Një meritë tjetër e auktorit është dhe me psikologjinë e protagonistes, por edhe me paraqitjen e mendimeve; ajo polemizon me kundërshtarët dhe armiqtë e lirisë së gruas. Nuk do të bëja keq të paraqitja disa pjesë nga komenti që Doktor Kodra i bën këtij romani. “Autori i këtij libri rreh disa probleme me rëndësi të madhe të shoqërisë sonë. Është një roman shoqëror, protagonistja e të cilit është një vajzë shqiptare, Dija, e pajisur me të gjitha vetitë e pastra të femrës arbërore. Ajo ndryshon nga shoqet e saja vetëm pse dëshiron t’i thyej prangat me të cilat qëndron i lidhur seksi femëror shqiptar. ...Ajo është liberale. Kërkon lirinë. E, për të mujt me e ngritë këtë flamur dëshëron “të ishte djalë”, se atëherë do të mund të luftonte më lirisht fanatizmin e urreyer, atë fanatizëm theror i së cilës ishte edhe vet Dija. Me pak fjalë, një vajzë jetime e shtypur nga njerka, dashuron dhe bie viktimë e mentalitetit të mykur. Të 310 faqet e romanit janë të mbushura me përshkrimin e zakoneve të ndryshme, por mjaft të mbrapshta

të vendit tonë. ...Me këtë roman interesant e të bukur, Stërmilli hapi një epokë të re në letërsinë shqiptare. Ai e tregoi portën e emancipimit. ...Ky roman luajti një rol të dorës së parë; deri diku mund të themi se bëri minimalisht po at efekt që bëri romani “NËNA” e Gorkit në përhapjen e ideologjisë komuniste në Rusi e në botë. Në atë vepër e tërë rinia shihte si prekeshin problemet dhe shqetësimet e saja. Ky libër që u përpi nga lexuesit dhe nga shtypi i kohës, u prit mjaft mirë. Në çdo recension çmoheshin vlerat sociale të romanit, për faktin se autori ka dëjtur të rrahë një problem që shqetësonte të gjithë vendin dhe me të drejtë u quajt “romani i shqetësimit”, ndërsa autori u quajt “mjeshtër i urtë” dhe “mbrojtës i të drejtave të gruas shqiptare”. Me këtë vepër ai u ngrit kundra koncepteve patriarkale, kundra zakoneve dhe paragjykimeve socio-feudale e borgjeze. Ai mbeti flamurtar i flaktë i mbrojtjes së lirisë dhe krijimit të personalitetit të gruas arbërore. Vepra e Stërmillit ishte e para vepër e këtij lloji në letërsinë tonë. Është e para herë që një problem kaq i rëndësishëm siç është emancipimi i gruas rrihet në një vepër të gjerë në formë romani. Nga tema dhe nga problemi që rreh autori, vepra hyn në kategorinë e romaneve që me realizëm paraqesin një plagë shoqërore, gjendjen e gruas shqiptare, që ishte një plagë kancerogjene dhe një shqetsim i madh për gjysmën e popullsisë shqiptare. Stërmilli u tregua mjeshtër dhe vrojtues i mirë dhe i vëmendshëm i jetës së vendit, i mentalitetit dhe i psikologjisë, jo vetëm të vajzës shqiptare por edhe të familjes shqiptare në përgjithësi. E tërë jeta e shqetësuar e familjes shqiptare të asaj kohe parakalon me hap të përmotshëm para syve të lexuesit. ...Në faqet e këtij libri, femra e njomë arbnore, do të mësojë shumë të drejta që i’a ka falur natyra e që i’a ka rrëmbyer shpjegimi i gabueshëm i Kuranit prej disa hoxhallarëve që kanë vumun shallin vetëm për të siguruar kafshatën e gojës e që s’kanë fare haber nga përmbytja e Kuranit. Nderin e femrës nuk mund ta sigurojë një perçe e këtë e përshkruan shumë bukur autori në faqen 41. Është e vërtetë e pakundërshtueshme se nderi i shqiptarkës është ruajtur më i pacënuar atje ku ajo ka dalë e zbuluar. Botimi i romanit “Sikur të isha djalë” shënoi një ngjarje të rëndësishme në atë kohë, jo vetëm në jetën letrare por edhe në gjithë jetën shoqërore të vendit”, -përfundon Lazër Radi.

“Autori nuk e zgjodhi heroinën e e romanit nga radhët e atyre pak femrave intelektuale që luftonin asokohe për të drejtat e gruas. Ai hyri në popull dhe solli në letërsi një heroinë nga ato rrethe, ku shtypja dhe vuajtja e gruas shqiptare ishin të tmerrshme; ...E jo vetëm kaq, po Stërmilli bëri të flasë me zë të lartë një vajzë të thjeshtë për të drejtat e veta dhe të shoqeve të saj. ...Sigurisht, Dija e vërtetë, e shtypur dhe e përbuzur nuk do të dinte të tregonte dhe të mbrohej, nuk do të arrinte të shprehte ato mendime të guximshme dhe të godiste atje ku duhet, po të mos i vinte

në ndihmë autori³⁵. Kështu Dija arsyetonte me guxim, kur thotë se “Gjysmën e popullit shqiptar e bën femra, po ajo nuk gëzon asnjë të drejtë. Të gjitha të drejtat i ka mashkulli. Unë, po të isha djalë, do t’i tregoja botës mashkullore se dora që përkund djepin asht ajo që rrotullon boshtin e parë të fatit të njerëzisë, sepse ajo dhe vetëm ajo e drejton jetën kah horizontet e ndritura ose të errëta. Po, mjerisht, s’jam djalë dhe, si femër, nuk mund me e nxjerrë zanin”. (Sikur të isha djalë, 1936).

Problemi i emancipimit të gruas hyri si temë e rëndësishme në letërsinë tonë realiste të viteve ‘30. Shumë shkrimtarë, si Migjeni, Nonda, Bulka, Sterjo. Spasse, Petro Marko, Ernest Koliqi etj., u muarën në shkrimet e tyre me fatin e gruas shqiptare. Po vepra që e pasqyroi më gjërë këtë problem dhe i bëri jehonë luftës shoqërore për çlirimin e gruas që, padyshim, romani “Sikur të isha djalë” i H. Stërmillit. Romani u bë zëdhënës i kërkesave që paraqiste lëvizja shoqërore e kohës, ai i dha forcë zërit të mekur të vajzës shqiptare, që vuante prapa kafazit, e shtypur nga ligjet e zakonet obskurantiste³⁶. Shumë prej femrave që kanë lexuar këtë libër kanë shpërthyer në lotë, ndërkohë që edhe sot vajzat përloten nga ky libër. Një studente 20 vjeçare, kur më pa këtë studim për romanin “Sikur të isha djalë” u shpreh: “Kam ka qarë kur e kam lexuar për herë të parë këtë libër dramatik me nota të larta dhimbjeje”.“Të reja të rinjtë revolucionarë, duke marrë shkas nga idetë e guximshme të romanit, shfaqën optimizëm për të ardhmen e gruas shqiptare. Nga kjo pikëpamje tërheq vëmendje të veçantë letra që e reja revolucionare Nexhmije Xhugini (Hoxha) nga Dibra e Madhe (bashkëshortja e Enver Hoxhës) i dërgon autorit nën pseudonimin “Flaka” dhe që shkrimtari e boton në ribotimin e romanit në vitin 1938³⁷. “Ajo i shpreh mirënjohjen autorit me këto fjalë: “Atë që prej shekujsh vajza shqiptare ndryente në zemrën e saj të dërmueme, atë që në heshtje duronte të luhej në kurriz të saj, vetëm ju me pendën e të paktëve mundët ta gërmonit thellë, ta studionit me sinqeritetin ma të madh të një psikologu të vërtetë”. Ky roman “i përket letërsisë sentimentale shqipe”, ndërkohë që edhe personazhi kryesor Dija, është ndërtuar sipas karakteristikave të këtij drejtimi letrar³⁸.

30. N. Jorgaqi, Parathënia, në Haki Stërmilli, vepra letrare 1, fq. 21.
31. N. Jorgaqi, Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare, cituar, f. XIV.
32. Historia e popullit shqiptar, vëllimi i III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë 2007, f. 395.
33. N. Jorgaqi, Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare, cituar, f. XI.
34. N. Jorgaqi, Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare, cituar, f. III.
35. N. Jorgaqi, Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare, cituar, f. XIV.
36. N. Jorgaqi, Këngëtar i të drejtave të gruas shqiptare, cituar, fq. XI.
37. N. Jorgaqi, Parathënie në H. Stërmilli, vepra letrare 1, cit. fq. 31.
38. R. Kryeziu, vep. cit. fq. 186.

Botim i ri



Promovohet

“Ditët e mia” të poetes Gjelina Gjika

Në fund gushti në Tiranë u promovua libri në poezi “Ditët e mia” të poetes Gjelina Xhika, lindur në Elbasan e martuar në Borovë të Dibrës.

Poet dhe shkrimtarë, dashamirës të poezisë dhe miq të saj që ndoqën këtë eveniment, ku u njohën në krijimtarinë e saj dhe veçanërisht në librin “Ditët e mia” botuar në dy gjuhë.

Në këtë aktivitet foli redaktorja Fatime Kulli, përthyesja Prof. Dr. Klara Kodra, studiuesja Sevimi Arbana, shkrimtari dhe botuesi Mark Simoni, pyetja nga Shkodra Faride Zmijani, Ramadani si dhe shkrimtarja nga Dibra e Madhe Miradije Ramadani si dhe shkrimtarja nga Dibra e Madhe Miradije Maliqi.

Pas përshëndetjes së autores, Gjelina Gjika, përshëndeti në emër të familjes dhe ftoi të pranishmit në një koktej bashkëshorti i saj Ilirjan Abazi.

Ilmi Dervishi

Thirrje per sponsorizim

SHTËPIA BOTUESE M&B KA NË PROCES BOTIMI DISA LIBRA ME VLERA HISTORIKE, KULTURORE DHE KOMBËTARE PËR DIBRËN DHE GJITHË SHQIPËRINË.

Individë ose biznesmenë që dëshirojnë të bëhen kontribues në këto projekte mund të na shkruajnë në:

email: mbbotime@gmail.com/botimemb@gmail.com
tel: 069 20 68 603

recensë

Një libër me shumë vlerë për turizmin shqiptar

Nga XHAFFER MARTINI

(Vijon nga numri i kaluar)

Në shkrimin “Shqipëria, kjo parajsë e adhuresve të historisë” me autor David Aronovitch thuhet se Shqipëria apo shqiptarët shpesh lidhen me fjalë të rënda si “kriminel”, “tutorë”, “trafikantë qeniesh njerëzore”. Thuhet se italianët kanë frikë nga shqiptarët, ndërsa grekët i urrejnë ata. Ndaj t’i lejosh vetes një udhëtim prej një ore nga Korfuzi në portin shqiptar të Sarandës, të duket në fillim një mision jo i lehtë. Por, në fakt, është një nga gjërat më të mira që mund të bësh.

Ashtu si ky autor, ka shumë të tjerë, që vinë në Shqipëri me dyshime dhe me frikë, për shkak të propagandës së keqe që është bërë nga të huaj ndaj vendit tonë, por pastaj bëhen miq të Shqipërisë dhe adhures të saj. Natyrisht, siç mund ta kuptojë lexuesi, disa prej këtyre artikujve, si kohë, i përkasin asaj periudha kur Shqipëria sapo qe hapur ndaj botës; disa janë shkruar gjatë vitit të mbrapsht 1997, kur Shqipëria ishte në kaos, por edhe pse të shkruar në këto periudha të errëta për vendin tonë, prej tyre buron një dashuri e madhe dhe e singertë. Mjafton t’i bëhesh mik një natë, dhe e njeh natyrën e vërtetë të shqiptarit.


Autorja Katerina Nikolas Shqipërinë e shikon si “një destinacion që po lulëzon në sytë e turistëve ndërkombëtarë. Organizata britanike Helium, e konsideruar si tryeza më e madhe elektronike e gazetareve, shkrimtarëve dhe agjentëve turistikë dhe të pasurive të paluejtshme, shkruan se Shqipëria ofron male, lumenj, bregdet të jashtëzakonshëm dhe ambiente të rehatshme për vizitorët e huaj. Shkrimtarja Katerina Nikolas thotë se Shqipëria apelon veçanërisht ata udhëtarë të pavarur që duan të eksplorojnë një vend që ndonëse nuk është futur akoma në epokën e modernes, përbën një gur të çmuar”.

Përveç turizmit, shkruhet nga këta autorë, Shqipëria ofron shumë lehtësira dhe mundësi të arta në fushën e investimeve, sidomos në pasuritë e paluejtshme. Për organizatën britanike Helium, Shqipëria është destinacioni më i preferuar i radhës i investitorëve, sepse Shqipëria është një vend me bregdet të mrekullueshëm, por edhe me çmime të përbalueshme...

“Francezë, investoni në Shqipëri!” – është një thirrje profesor Michel Godet, ish- ministër i Ekonomisë dhe Financave, që u bënë biznesmenëve francezë. Ndër të tjera ky autor shkruan: “ Është për të ardhur keq që Klubi i Mesdheut heziton të instalohet pranë Sarandës, në një gji rëre pranë qendrave të jashtëzakonshme të antikitetit, si: Butrintit, një vend unik, i cili është i lakmueshëm”.

Në publikimet që bëjnë për Shqipërinë “Ekspertët e National Geographic” sugjerojnë turin që parashikon plazhe të rralla, kështjella dhe vende mesjetare. “Viti 2008 sapo ka nisur, - thotë autori, - por aventurierët më të njohur të botës kanë bërë gati listën e vendeve të tyre të preferuara ku mund të shkojnë. Dhe për çudi vendin e dytë në listën e shteteve që ia vlen për të vizituar këtë vit është Shqipëria. Këtë herë nuk jemi renditur si një vend që ofron turizëm postkomunist apo frikën e një aventure në një vend të pasigurt. Shqipëria këtë herë është vlerësuar si vendi më i mirë në botë, ku mund të gjesh ujëra të pastra dhe plazhet më të virgjëra”. Për ujërat Shqipëria është klasifikuar si vendi i parë në botë, për malet Kolumbia, për pyjet Senegali e kështu me radhë.

Po mbase shkrimi që të entuziazmon më shumë është ai me titull: “Lonely Planet” që e rendit Shqipërinë si vendin e parë ndër dhjetë vendet e Botës, që duhet të vizitohet gjatë vitit 2001. “Njëri prej themeluesve të kësaj organizate, i cili qëndroi për pak kohë në Shqipëri dhe vizitoi disa qendra më të rëndësishme turistike të vendit tonë, shprehet : “Të gjesh kënaqësi në Shqipëri, tashmë nuk është një betejë e vështirë. Por të mos harrojmë se ky ndryshim i madh në këtë



vend ndodh në një kohë të shkurtër, kur dihet se jo shumë kohë më parë, kjo pjesë e Ballkanit-Shqipëria, konsiderohej si një destinacion vetëm për njerëzit e guximshëm, ku mund të shkonin vetëm ata më trimat e trimave dhe jo kushdo tjetër. Mahnitja nga plazhet blu, vendet arkeologjike, kuzhina shumë e mirë, jeta e natës, siguria dhe qetësia, aventurat dhe mikpritja e banorëve, janë ende diçka e re dhe e panjohur për udhëtarët e huaj, që kanë rastin të vizitojnë Shqipërinë”.

Mbledhja e botimi i këtyre shkrimeve, mendimeve dhe vlerësimeve të të huajve për Shqipërinë dhe resurset shqiptare, është kontribut i madh i këtij autori pasi bota ka mundësi të mësojë të vërtetën për vendin tonë duke shpërndarë kështu ato mjegulla iluzive që kanë përhapur të keqinformuarit ose dashakeqësitë e vendit tonë.

Në shumë prej këtyre shkrimeve nuk ka vetëm lëvdata për Shqipërinë dhe shqiptarët, por edhe kritika objektive, që lidhen me kujdesin që duhet të tregojmë për vendin tonë të mrekullueshëm që ai të bëhet edhe më i bukur sesa është. Se mjaft prej tyre thonë se dora e njeriut në Shqipëri pak ndihet për mirë, kurse për keq ndihet shumë. Shqiptarët, thuhet në disa shkrime, kanë shkatërruar natyrën, kanë prerë pyjet dhe kanë ndotur mjedisin.

Pjesa e tretë e librit është me shkrime origjinale të autorit Xhelal Marku, i cili, me detyrën e specialistit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit e ka shkëlur Shqipërinë në çdo pëllëmbë të tokës së saj dhe mrekullitë e saj i ka pasqyruar në lloje të ndryshme të publicistikës, duke siguruar lexuesve jo vetëm një njohje të plotë e të gjithanshme të Shqipërisë dhe të resurseve të saj, por duke dhënë një ndihmesë të madhe për të hapur horizonte për zhvillimin dhe begatinë e vendit.

Me dashuri dhe shpirt prej artisti autori ka përshkruar kullën e Suf Laçit në Gjurrë Reç, e cila ka jo vetëm vlera muzeale, por edhe vlera përdorimi meqë që shumëkush nga turistët e huaj do të dëshironte të ishte për disa kohë strehuar dhe banor i një ngrehine që e ka kaluar me kohë shekullin, por mbahet e fortë e hijerëndë si ato kështjellat mesjetare. Shtëpia e Laçëve dhe të zotët e saj, të përmendur për bujari dhe mikpritje, tani, në kohën moderne, ndjenjën e mikpritjes mund ta shfaqin thjesht duke krijuar kushte sa më të përshtatshme për turistët e huaj. Një shkrim me shumë vlerë mban titullin “Nëpër kanionet e Osumit”, ku jepen me ngjyra të gjalla, me një përshkrim të saktë dhe realist bukuritë e Luginës së Osumit duke u ndalur në atë çka është karakteristike për këtë lumë: kanionet. Jepen edhe të dhëna shkencore me rëndësi për formimin e kanioneve, si dhe një cikël legjendash në lidhje me përfytyrimin popullor për to, çka dëshmon se bukuria fizike

Libri “Turizmi në Shqipëri”, ka një koncept të ri për turizmin; ai nuk konsiderohet vetëm i lidhur me bukuritë natyrore të vendit tonë, por edhe me larminë e trashëgimisë sonë historike e kulturore, me tradita dhe zakonet, me mënyrën tonë të jetesës, me konstitucionin shpirtëror të shqiptarit, me gjuhën, identitetin, vlerat e tij shpirtërore, ku, natyrisht, vendin e parë e zë mikpritja, e pajisur dhe mbrujtur me elementë të rinj bashkëkohorë...

është shkrirë me bukurinë shpirtërore dhe kanë ekzistuar tek njëra-tjetra. Lexuesi mëson edhe për historikun dhe aktualitetin e sportit të Rafting-ut, si sport i guximit dhe i kurajos që gjen vazhdimisht adhures. “Një udhëtim drejt bjeshkëve turistike të Selitës, Mirditës”, është një himn dashurie për këtë krahinë piktoreske që, ndonëse ka qenë e varfër, dy gjëra nuk i kanë munguar kurrë: bukuria e natyrës dhe e njerëzve të saj fisnikë. Ky shkrim është kaq i pasur me të dhëna historike, gjeografike sa siguron një njohje shumë të mirë të kësaj krahine që herët e vonë ka qenë në qendër të vëmendjes të shumë dijetarëve, studiuesve dhe shkrimtarëve. Autori përshkruan me një stil dinamik dhe saktësi shpellat e Mërkurthit, e Shutërrisë dhe shpella të tjera që janë të shumta në territorin e Mirditës. Ngado që shkon dhe çdo përshkrim që bën, çdo objekt autori nuk e shikon si diçka në vete, si një bukurie të shterpëzuar, vetëm për ta soditur, por edhe si një burim biznesi, si një mundësi për zhvillimin e turizmit. Kështu, si shembull, kur jep rrjedhën e lumenjve dhe ujërat e kësaj zone, kur bën fjalë për lumin e Urakës, ai gjen rastin ta informojë lexuesin se “Janë disa studime dhe projekte të kryera në këtë fushë, për të cilat pritet miratimi dhe më pas fillimi i investimeve që këto burime ujore do t’i kthejnë në më shumë dritë dhe energji, në më shumë të ardhura për zonën e Selitës dhe banorët e saj”. Autori e vë theksin në krijimin e infrastrukturës si bazë për zhvillimin e turizmit, duke theksuar sidomos nevojën për rrugë të mira dhe të asfaltuara, që do të shkurtojnë distancat dhe do të krijojnë mundësi për investime. Xhelal Marku është jo vetëm një gazetar i përpiktë, një publicist i klasit të parë, por edhe një njeri i angazhuar dhe i shqetësuar seriozisht për zhvillimin e vendit të tij. Me detyrën e specialistit të AKT ai pothuaj nuk ka lënë vend pa shkëlur në Shqipëri dhe kudo ku ka shkuar, siç është mahnitur nga arritjet që na i përcjellë me dashuri, ashtu edhe është shqetësuar për të metat e dobësitë që frenojnë seriozisht zhvillimin e vendit dhe janë të karakterit subjektiv.

Është shumë e çuditshme që ky njeri me këtë horizont për turizmin shqiptar, që ka hartuar një libër që do ta meritonte të përkthehej me paratë e shtetit në anglisht për t’ua bërë të njohur turistëve në botë, të pushohet nga puna dhe ta kalojë kohën e tij të çmuar nëpër gjyqe. Por këto janë shfaqje të paradokseve shqiptare që i ndeshim në çdo hap të jetës. Derisa ne nuk do të flakim tej korrupsionin dhe paradokset që edhe kjo është një shfaqje korrupsioni, kurrë nuk do të hyjmë në rrugën e zhvillimit. Të mos harrojmë se Shqipëria për dy- tre dhe pesë për qind të popullsisë është bërë e lulëzuar dhe begatuar, por për 95 për qind të shqiptarëve ajo është prapë e varfër dhe e mjeruar, mbasi në hotelet luksoze, në plazhet e

mrekullueshme në pikat turistike mund të shkojnë vetëm të pasurit.

Si përfundim desha të them se libri “Turizmi në Shqipëri”, ka një koncept të ri për turizmin; ai nuk konsiderohet vetë i lidhur me bukuritë natyrore të vendit tonë, por edhe me larminë e trashëgimisë sonë historike e kulturore, me tradita dhe zakonet, me mënyrën tonë të jetesës, me konstitucionin shpirtëror të shqiptarit, me gjuhën, identitetin, vlerat e tij shpirtërore, ku, natyrisht, vendin e parë e zë mikpritja, por një mikpritje jo thjesht tradicionale, por e pajisur dhe mbrujtur me elementë të rinj bashkëkohor, e aftë për të përballuar jo vetëm me shpirtin e madh, por edhe me kulturën e shërbimit dhe kushtet që kërkojnë turistët e huaj. Pjesë përbërëse dhe ndikuese në turizëm janë edhe tregues të tjerë, si objektet e kultit dhe harmonia ndërfetare, klima e mrekullueshme etj. Por të gjitha këto pa faktorin njeri, pa njeriun shqiptar, që i nxit ose i frenon resurset natyrore, turizmi nuk do të kishte kuptim.

Që turizmi të modernizohet, të krijohet ajo që quhet industri turistike dhe të veprojë me kapacitet të plotë si degë shumë e rëndësishme e ekonomisë sonë, duhet të zhduken dhe të rrafshohen rrënojat e koncepteve frenuese , duke i zëvendësuar ato me bindje dhe koncepte të reja për një turizëm gjithëvjetor, të kudondodhshëm, në fushë dhe në malësi, në det dhe në plazhe, në male dhe në lugina, kudo ku ka jetë dhe natyrë, sepse çdo pëllëmbë tokë e këtij vendi ka të veçantat e veta dhe vlen të shikohet dhe jetohet. Imazhi i ri për turizmin e vendit, që shkon paralelisht me imazhin e ri për Shqipërinë ka si bazë formimin e njeriut shqiptar me bindje dhe dashuri për progresin, sepse vetëm një njeri i tillë, mund të bëjë mirë menaxhimin e resurseve natyrore, mund ta kthejë natyrën në shtëpi të vetë. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e turizmit duhet të paraprihet nga krijimi infrastrukturës shpirtërore, për të krijuar një mendim të ri për ruajtjen dhe pastërtinë e mjedisit, për ta shndërruar atë në një vlerë kombëtare dhe në një veçori kombëtare.

Një nga shprehjet më të drejtpërdrejta të njeriut dhe të çdo kombi është rregulli dhe pastërtia, estetika dhe kultura e të punuarit dhe të jetuarit. Unë kam jetuar për pak kohë në një fshat austriak, në rajonin e Salzburgut. Ngrohja bëhej me dru dhe pranë çdo shtëpie kishte një turrë me dru. Por kishe qejf ta shikoje turrën me dru. Ajo ishte një vepër arti. Vepra arti ishin edhe koshat e mbeturinave. Merre me mend për gjërat e tjera. Në mes të fshatit ishte një kombinat druri. Nga jashtë dukej sikur ishte ndonjë spital, ose ndonjë institucion tjetër me shumë rëndësi. Izolimi jo vetëm me pamjen e jashtme, me xhamllëkun modern, por edhe për të mbrojtur mjedisin nga zhurmat, ishte një gjë shumë e rëndësishme. Kësaj ia kishin arritur plotësisht, megjithatë, popullata e vendit, qaqej për atë kombinat dhe donte ta largonte prej andej. Dhe me siguri e kanë larguar. Mund të udhëtoje me orë të tëra nëpër pyje dhe të mos shikoje asnjë mbeturinë, asnjë. Populli i pastër! Tek kjo shprehje përfshihen të gjitha vetitë morale që ne i shprehim me një varg epitetesh dhe superlativash. Natyra është si rrobat që mbajmë veshur. Ajo është “rroba” që na mbështjell të gjithëve, që na mban ngrohtë ose na fut plevitin, kjo varet nga ne, sa e duam, sa e mirëmbajmë, sa kujdesemi për të. Shqiptarët përgjithësisht vishen bukur, bile me luks. Por atë kujdes që kanë për veten nuk e kanë për natyrën, për mjedisin, për asgjë që i rrethon. Rrobat grisen dhe hidhen, natyra gjallërohet dhe përtërihet, por edhe ajo ka moshën e vet, ligji i plakjes nuk përjashton asgjë. Rinia e saj në kuptimin figurativ varet shumë nga ne.

Këto mendime dhe shumë të tjera të zgjon libri i Xhelal Markut “Turizmi shqiptar”. Ky autor është i prirur ndaj pozitives, për të gjetur dhe sjellë vlera dhe arritje në shkrimet e tij. Kjo të bën optimist dhe t’i shton shpresat në të ardhmen e Shqipërisë. Dallon pra nga gazetarët e tjerë që derdhin vetëm helm dhe shikojnë vetëm zi.

Asnjë “kompensim financiar” i munguar deri tani, nuk mund të kompensojë vdekjen dhe torturat e qindra familjeve të Fushë Alies, Bllaçe, Laçës, Mustafë e Sinjë.

Fushë Alia dhe dy 70 vjetorët përkujtimorë të Luftës së Dytë Botërore

Nga **HYSEN REPA**

Më 29 Korrik 2014 mbushën plot 70 vjet nga lufta (genocidi) në Fushë Alie midis forcave nacionaliste dhe partizane.

Historiografia shqiptare rreket akoma midis dilemave të vërtetësisë së kësaj lufte të përgjakshme dhe genocidi të paparë të organizuar nga PK e Shqipërisë dhe formacioneve të saj luftarake. “Epopeja” e luftës Nac.Cl. për 50 vjet injoroi faktet historike dhe konkrete të një pjese më të errët të kësaj lufte siç është masakra dhe genocidi komunist i bërë mbi popullsinë e Fushë Alie. Jo vetëm kaq por në shumicën e rasteve zhduku nga arkivat dokumentacionin (si urdhra, plane dhe operacione të ndëshkimit) dhe çdo gjë që implikonte krerët komunist në këto masakra. Por dhe pas viteve ’90, historianët “për vazhdimësi” vazhdojnë të glorifikojnë “fitoren mbi kolaboracionistët” dhe “armiqve të brendshëm”, duke e cilësuar këtë luftë si një fitore të Ushtrisë Nac.Cl.

Për argumentimin e kësaj “Fitoreje” vazhdohet të citohen kujtimet e E. Hoxhes, H. Lleshit, M. Shehut, Sh. Pecit, K. Azbiut e tjerë që urdhëruan dhe zbatuan një masakër të padëgjues gjatë luftës së II-të botërore në Shqipëri. Ata që dogjën dhe shkatërruan fshatrat Fushë Alie, Bllaçe, Laçes e Sinjë vazhdojnë të “meritojnë” titujt “Hero i Popullit” dhe të përkujtohen si “trimat” që luftuan kundër vëllezërve të tyre, jo për të çliruar Shqipërinë, por për ideologji dhe nënshtrim të rezistencës antikomuniste në vitet ‘44. Ata që dhe pas lufte vazhduan ta persekutojnë këtë zonë për 50 vjet rresht ku 1/3 e burrave të kësaj zone (Një burrë në çdo 3 shëtipi) u pushkatua dhe u burgos për qëndrim antikomuniste deri në vitet ‘90.

Ndoshta jo vetëm për këtë arsye, por dhe për veprimtarinë e mëvonshme kriminale, këta personazhë historikë të cituar më lart, nuk duhet të mbajnë tituj e grada honorifike të dhëna gjatë regjimit komunist.

Parlamenti, organet shtetërore dhe akademja e shkencave duhet të marrin masat përkatëse dhe të argumentuara për të vendosur faktet e vërteta historike në realitetin e ri. Shoqëria civile dhe media gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në propagandimin e fakteve historike dokumentare

Në përfundim të kësaj lufte patriotike, PK u angazhua më shumë në eliminimin e “armikut të brendshëm” se sa në luftën kundër atij të jashtëm. Pasojat e kësaj lufte e ndanë Shqipërinë në “ne” dhe “ata”. Gjithë përpjekjet e shoqërisë sonë, sot duhet të perëndohen në unifikimin e vendit në “ne”. Kjo nuk mund të realizohet duke festua fitoren “ne” mbi “ata”. Kapërcime mbi faktet historike duke lënë në harresë qindra e mijëra shqiptarë që u masakruan për nacionalizëm dhe luftën kundër komunizmit çon në një ndarje të re dhe nuk i shërben unifikimit kombëtar.

dhe pastrimin e pasaktësive historike . Paqja sociale dhe krijimi i një mentaliteti realist për të shkuarën është një proces që shumica e vendeve europiane e kanë kaluar me sukses vetëm në saj të “hakut” që i kanë dhënë veprimeve historike të të shkuarës. Ndjesa dhe falja është një proces i gjatë, i argumentuar dhe domosdoshëm. Mjaftuan 23 vjet që ky proces duhej të kishte përfunduar dhe më në fund shoqëria shqiptare duhej të ishte paqëtuar nëpërmjet një faljeje të pritur por që akoma nuk ka ardhur.

Genocidi që u krye në Fushë Alië në Qershor-Korrik 1944 (si dhe në krahina të tjera si në Mirditë, Lumë, Shkodër e Malësi të Madhe deri në fund të luftës e në vazhdim) u shoqërua me viktima njerëzore të pakrahasueshme.

Qëndrimi ndaj tyre ka qenë i diferencuar. Të rënë nga forcat partizane u trajtuan si dëshmorë dhe heronj për 50 vjet, kurse të rënë nga forcat nacionaliste si tradhtar, bashkëpunëtor të pushtuesit, jo vetëm ata por dhe familjet dhe të afërmit e tyre u trajtuan si armiq të pushtetit komunist për 50 vjet.

Është për argument historik (po që se dikush disponon të dhëna të tjera mund t'i argumentojë) se në këto luftime dhe masakra nuk ka as dhe një emër ushtari pushtues që ka marrë pjesë apo është vrarë në këto luftime. (Në radhë e partizanëve ka patur maqedonas, por nuk kemi të dhëna për ndonjë të vrarë apo dëshmor (a hero)).

Programi luftarak i PK të Shqipërisë në këto

operacione ishte ndëshkimi i forcave nacionaliste në zonat e Veriut. Kjo vërtetohet dhe në urdhrat e dhëna Divizionit të I-rë Sulmues për kalimin në Veri gjatë Maj-Korrik 1944.

Në këto operacione në asnjë rast nuk ka patur përpjekje luftarake me forcat gjermane, të cilat po tërhiqeshin nga Shqipëria pasi kishin pësuar disfatë pas disfatë në frontet e tjera të Europës.

Në programin e nacionalistëve, të përcaktuara në kuvendet e Dibrës të organizuara nga Balli Kombëtar dhe nacionalistët tek varret e Delihasanit, Ferra e Pashës dhe në Lurë, ishte lufta pa kompromis kundër vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Ishte një përpjekje luftarake midis dy ideologjive me një pjesëmarrje në shkallë të gjerë të gjithë popullsisë së kësaj zone kundër vendosjes së regjimit komunist.

Përdorimi i termave “ Bashkëpunëtor të fashizmit”, “bashibozuk” etj si për krerët e rezistencës por dhe ndaj pjesëmarrësve të kësaj përpjekjeje u përdorën si argument nga që disa krerë të lëvizjes, gjatë pushtimit mbajtën anën e pushtuesit si Halil Alia, Miftar Kaloshi etj. Por kjo ofensive e përgjakur u bë dhe kundër Lumësi ku lëvizjen e drejtonte Muharrem Bajraktari apo në zonat e Krujës ku komandonte Abas Kupi. cili kishte luftuar me armë kundër pushtuesit. Kjo përpjekje ishte një “argument” justifikues për ndëshkimin e kësaj zone e cila përfundoi në një luftë civile me dëme të pallogaritshme.

Qeveria ka planifikuar që në përvjetorin e 70-të

të luftës në Shqipëri të ketë aktivitete të mëdha
përkujtimore si një fitore të madhe mbi pushtuesit.
(sipas tyre, fshatrat e Çidhnës ishin pushtues)

Në historinë e popullit shqiptar kjo luftë është krenari për çdo shqiptar, si kontribues në luftën e madhe që mposhti nazifashizmin në të gjithë botën. Kjo luftë u organizua dhe u zhvillua jo vetëm nga PK e Shqipërisë por dhe nga nacionalistët shqiptarë dhe populli i thjeshtë i cili nuk ishte rreshtuar në organizime politike. Të vrarët në këto përpjekje luftarake janë një krenari kombëtare dhe meritojnë respekt në breza.

Në përfundim të kësaj lufte patriotike (pa përjashtuar dhe gjatë luftës), PK u angazhua më shumë në eliminimin e "armikut të brendshëm" se sa në luftën kundër atij të jashtëm.

Pasojat e kësaj lufte e ndanë Shqipërinë në "ne" dhe "ata".

Gjithë përpjekjet e shoqërisë sonë, sot duhet të përqendrohen në unifikimin e vendit në "ne".

Kjo nuk mund të realizohet duke festua fitoren
"ne" mbi "ata".

Kapërcime mbi faktet historike duke lënë në harresë qindra e mijëra shqiptarë që u masakruan për nacionalizëm dhe luftën kundër komunizmit çon në një ndarje të re dhe nuk i shërben unifikimit kombëtar.

Ky 70-vjetor të mos ndahet në dy 70 vjetorë. Një që përkujton fitimtarët dhe një që përkujton të mundurit.

Ky 70-vjetor në Fushë Alie nuk ka fitimtarë. Pati vetëm viktimë të një lufte civile, e cila u zhvillua për interesa të PK për vendosjen e komunizmit në Shqipëri dhe diferencimin klasor dhe krahinor që akoma vazhdon të ketë pasoja.

Asnjë "kompensim financiar" i munguar deri tani, nuk mund të kompensojë vdekjen dhe torturat e qindra familjeve të Fushë Alies, Bllaçe, Laçes, Mustafë e Sinjë.

Personalisht nuk mund të harroj rrënojat e shtëpisë sime të djegur nga partizanët, kur linda unë në vitin 1948.

Fushe Alla përkujton dhe përulet me respekt për ata burra e djem që dhanë jetën jo vetëm kundër instalimit të komunizmit por dhe për ata që vdiqën dhe u torturuan në burgjet dhe kampet e regjimit komunist.

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj



**Gazeta ofron faqet e saj për
REKLAMA apo NJOFTIME
të ndryshme për biznese dhe individë.**

ÇMIME TË ARSYESHME
për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e fages) ofrohen falas!

Për informacion:

E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Tel: +355 69 20 68 603



Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: [<rrugaearberit@gmail.com>](mailto:rrugaearberit@gmail.com)
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMERISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

Prof. Dr. Nuri Abdiu - një emër që s’ka mort

(Vijon nga faqja 15)

Sa qe gjallë ai qëndroi në majat e psikologjisë dhe sytë i mbajti nga e ardhmja. Mbas vizitës që bëri në Moskë, pas vitit 2000 në Universite-tin Pedagogjik, ku kish kryer studimet që më 1958, ai bleu një enciklopedi voluminoze në dy vëllime për psikologjinë me arritjet më të fundit në Rusi e në botë, botim i akademikëve rusë. Dikush pa takt i bëri pyetjen se ç’i duhej ajo tani në moshë të shkuar. Përgjigja e tij ishte kuptimplote:”Dua të jem në korent me ecurinë, me të rejat më të fundit të shkencës sime që i kushtova jetën. Edhe po vdiqa, deri sa të kem frymë, për aq sa të rroj, të mësoj sa të mësoj!”

Kur flasim për personalitetin e Nuri Abdiut si shkencëtar, nuk duhet harruar edhe ndihmesa e tij në lëmin e pedagogjisë dhe lidhjeve të saj me fushën e psikologjisë. Prej penës së tij kanë dalë dhe artikuj shkencorë që mbulojnë këtë fushë. Ai sikurse kolegët e vet të nderuar, Bedri Dedja e Hamit Beqja, mbaruan të njëjtën shkollë në Moskë dhe të njëjtën degë për Psikologji-Pedagogji dhe kanë kontribute të vyera në të dyja fushat.

3. ATDHETARI VIZIONAR

Prof. dr Nuri Abdiu , po ta shprehim me një fjalë, është “një mal pune” të bërë në mbi 5-6 deka-da. Në sajë të saj, ai që më 1973 ka marrë titullin shkencor “Docent”, më 1991 gradën “Doktor i Shkencave”dhe më 1999 titullin shkencor “Profe-sor”. Gjithashtu në linjën zyrtare puna e tij si per-sonalitet jo vetëm shkencor por dhe në pikpamje profesionale si dhe si veprimtar shoqëror është çmuar. Është dekoruar me “Medaljen e Punës” më 1968, me urdhërin “Naim Frashëri” të klasit të parë më 1980, me titujt e lartë “Mësues i Merituar”më 1987 dhe “Mësues i Popullit”më 1989.

Nga këto lartësi të mbritura ai është përpjekur vazhdimisht t’l shërbejë atdheut. Latinët e vjetër thoshin se “E ke bërë detyrën ndaj atdheut po të kesh rritur e edukuar një qytetar romak”. Prof. Nuriu me të shoqen zonjën Fitnete, kanë rritur e shkolluar dy vajzat e tyre Ermirën e Arditën, që u bënë siç thotë populli “goca të hajrit”, jo vetëm për vehte por dhe për prindërit e tyre. Sot ato kanë familjet e tyre por prindërit i kanë parë në dritë të syrit. Emira, vajza më e madhe, mbaroi për fizikë bërthamore dhe sot është me detyrë në Kenia për llogari të PNUD-it (organizatës së OKB për zhvillimin). Ajo nuk harron të ftojë çdo verë prindërit e saj të kalojnë pushimet në Nairobi të Kenias. Ndërsa Ardita u bë juriste dhe sot punon në Gjykatën e Strasburgut. Ajo i mundësoi të ja-tit, Nuriut, të vizitonte ish shkollën, ku kreu studi-met e larta në Moskë, në ish Bashkimin Sovjetik. Pas vitit 2000 Nuriu me zonjën e vet shkoi në Universitetin Pedagogjik, u takua me akademikë e profesorë të shkollës së vet. Të gjithëve u bëri

përshtypje rusishtja perfekte e profesorit. Ai la përshtypjet më të mira aty dhe u kthye me mbresa të thella e të pashlyera prej andej.

Me këtë rast po përmëndim se profesor Nuriu ka punuar si Referent Konsullor në Ministrinë e jashtme të Shqipërisë në fillim të viteve ’50 dhe më pas në kurset e gjuhëve të huaja pranë Minis-tisë së jashtme të ish Bashkimit Sovjetik. Mund të kish qënë një diplomat i shkëlqyer por pas mba-rimit të studimeve në Moskë, kariera e tij vazhdoi në fushën e psikologji-pedagogjisë, për të cilën kreu shkollën e lartë. Profesor Nuriu përgatiti dy fëmijët e tij si dy kuadro të lartë, tepër të kuali-fikuar, që i shërbejnë atdheut, me të cilët do të krenohej çdo familje. Ato u bënë pasardhëse të denja të babait të vet intelektual.

Nuri Abdiu nga viti 1996-2005 dha mësim për rreth një dekadë në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Aty ka qënë edhe me detyrën si kry-etar i komisionit për pranimin e pedagogëve të psikologjisë në Degën e Psikologjisë të këtij Universiteti. Ai ka përgatitur studentë nga trevat etnike shqipfolëse jashtë Shqipërisë, të cilët e ku-jtojnë vazhdimisht profesorin e tyre elokuent dhe të mençur. Pushimet ndër vite ai i kalonte famil-isht në Strugë, ku bëri shumë miq e shokë dhe ku rrezatoi si atdhetar.

Profesor Nuriu ka qënë dhe shumë i lidhur me vendlindjen e tij, Dibrën. Dihet, Dibra e di-branët kanë luftuar për çdo krahinë të Shqipërisë, sikurse kanë punuar kudo në çdo cep të atdheut si muratorë tepër të aftë. Ustallarët dibranë janë me nam. Profesor Nuriut i takon merita e krijimit të Shoqatës të Intelektualëve Dibranë, kryetar i së cilës u zgjodh njëzëri ai. Ai ka bërë në krye të saj shumë për të nxjerrë në pah vlerat e asaj krahine. Profesor i mishëron në vetvehte njeriun e virtytshëm dhe sistematik e tepër të rregullt në jetë, një model për të afërmit, për shokët , për miqtë e tij të shumtë. Jetëshkrimi i tij është ai njeriut që njohu vetëm ngjitje me gjithë sfidat e shumta në jetë. Në Shkodër bile atë e donin dhe e respektonin dhe të ashtuqajturit të “de-klasuar”. “Ti, Nuri Abdiu s’je si të tjerët. Lum, nana që të ka ba. “i thoshin. “Ti je fisnik!”

Kur vdiq profesori fizikisht, se për njerëz si ai s’ka mort, një kallaballëk i paparë shihej në var-rimin e tij. Shiu ra atë ditë “me shtëmba”, sikur donte të vajtonte, të shprehte hidhërimin e madh, tepër të madh, për të “madhin”Nuri që po largo-hej nga kjo jetë, pikëllimin për të “shquarin”Nuri Abdiu. Njerëzit ishin mizëri tek varrezat e Shish Tufinës, kaq shumë dashuri e mirësi kish mbjellë në ta ky njeri, kaq shumë e donin. Kishin ardhur jo vetëm nga Tirana e Shkodra e Dibra e rrethet e ndryshme të Shqipërisë por dhe shqiptarët e përtej kufijve, nga Dibra e Madhe e Tetova, nga Struga e nga Kosova, Prishtina, Ulqini etj. etj. Një varrim i pazakontë. Pas fjalëve të rastit në ceremoninë mortore në krye të varrit nga rektori i “Albanian

Siç e ka përcaktuar akademiku i dëgjuar Bedri Dedja, duke dhënë thelbin e tij”Profesor Doktor Nuri Abdiu do të mbetet një “Kalorës i Psikologjisë”, ku ai gjatë gjithë jetës përqëndroi forcat e veta si mësues i devotshëm e shkencëtar i shquar.

University”, ku ai punoi e drejtoi në fund si zv. dekan për punën shkencore, zoti Pavli Kongo, sikur të kish mbirë nga dheu, u duk shkrimtari Agim Vinca. “Nuk mund të mungonja në këtë ditë të dhimbshme, e nisi fjalën ai. U nda nga ne një intelektual kalibri të lartë, Prof. Dr. Nuri Abdiu... ”Ndërkohë mendoja se ishte shumë kuptimplotë ardhja e Agim Vincës. Ai, duke qënë nga Struga dhe profesor në Universitetin e Prishtinës, për-faqësonte aty shqiptarët e Kosovës e Maqedonisë, që aq shumë e deshën profesor Nuriun, sikundër që i deshi edhe ai. Më thoshte shpesh: “Është de-tyra e jonë, kudo që jemi, të bëjmë shumë e më shumë për vëllezërit tanë matanë kufijve”. Dhe ai bëri shumë për ta, pa u kursyer asnjëherë. Ndaj dhe ata siç s’i ndau gjatë jetës, nuk ju ndanë dhe në lamtumirën e fundit.

4. “ NJERIU I SË ARDHMES”

Në figurën e Prof. Dr. Nuri Abdiut kemi një personalitet shkencor, një personalitet peda-gogjik, një personalitet shoqëror, një edukator, një familjar e prind të mirë e mbi gjithçka njeriun fisnik. Kur kam folur me një kumesë në një nga sesionet e shumta që organizonte profesor Nuriu për “Fisnikërinë Dibrane”, veç të tjerash kisha parasysh personin e tij që meritonte e gëzonte re-spektin e dibranëve kudo e kurdoherë...

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (F. E. Sh.) vol. I Tiranë 2008, zëri i gjashtë, faqe 4 është ai që i kushtohet profesor Nuri Abdiut. Është shkruar nga vetë akademiku Bedri Dedja dhe redaktuar nga Azis Gjergji që ve emrin në krah. Sigurisht vlerësohet lart figura e tij dhe për aq sa është paraqitur. Profesor Nuriu u caktua për të bërë e një sërë zërash të fushës së psikologjisë për Enciklopedinë e ardhshme Shqiptare, gjë që s’e arriti dot ta realizojë...

Nuk mund të lë pa përmëndur si vlerësim për të, një profil të figurës së tij që jep Prof. Dr. Musa Kraja. Ajo është një sintezë e krejt jetës së profesorit:

“Të zhvillosh leksione e të drejtosh seminare tek disa universitete për mbi gjysëm shekulli në fushë të psikologjisë dhe të pedagogjisë, të shkru-ash e të botosh tekste në këto fusha në plotësim të kurrikulave dhe të kërkesave të studentëve dhe sidomos në përgjigje të nevojave teorike e ap-likative, në vizion të gjërë, të shkruash dhjetra e dhjetra artikuj studimorë e vepra të këtyre fush-ave, të udhëheqësh tema kursesh, tema magji-straturash dhe doktorature, të drejtosh institucione të larta pedagogjike, deri në nivele universitetesh, të drejtosh departamente deri në ditët në vazh-dim dhe të japësh një mori leksionesh në nivele universitare e pasuniversitare etj. dotë thotë se ka akumuluar shumë, se brënda tij përmban shumë vlera, humane, profesionale, të cilat brezat e rinj duhet t’l njohin. Këto vlera nuk janë thjesht

personale...Është fjala për prof. dr. Nuri Abdiun, Mësues i Popullit, mësues i mijëra mësuesve dhe pse jo, i disa dhjetra profesorëve. ”

Mbi të gjitha prof. dr. Nuri Abdiu është njeriu i së ardhmes. Ai do të mbahet mënd:

Si një ndër themeluesit e shkollës së sotme, moderne, psikologjike shqiptare që ka përgatitur kuadro dhe për këtë shkollë në Shqipëri e në mbarë trojet etnike.

Si një ndër krijuesit e bibliotekës psikologjike për shqiptarët kudo që jetojnë.

Ai është nismëtar i studimit të kësaj fushe në vendin tonë.

Ai do të kujtohet si i pari që futi në kurrikulat e universiteteve shqiptare studimin si lëndë e veçantë të Historisë së Mendimit Psikologjik Shqiptar.

Si kryetar i Shoqatës së Intelektualëve Dibranë.

Si njeriu që organizoi e mori pjesë e dha kon-tribut në dhjetra aktivitete, sesione shkencore, simpoziume e kongrese shkencore brenda e jashtë Shqipërisë

Si njeriu që nxorri nga duart e veta me qindra e mijra kuadro për arsimin e kulturën.

Do të kujtohet përherë si një edukator i pal-odhur i brezit të ri.

Do të mbahet mend në kujtesën e njerëzve si respektues dhe zhvillues i traditës kombëtare dhe mbi bazën e saj, si njeri i së ardhmes, një njeri vizionar që shihte larg.

Mbi të gjitha ai do të kujtohet për ndihmesën që ka dhënë në rritjen, zhvillimin e konsolidimin e armatës së mësuesve si dhe për kontributin e dhënë në fushën e psikologjisë në planin teorik e praktik...

Kudo ai ka punuar me devotshmëri e ndërgjegje të lartë profesionale, për të cilat do të mbahet mend gjithmonë.

Veçanërisht e madhe është ndihmesa në psikologjinë kombëtare, si dhe për një figurë çelës të Rilindjes, babain e rilindasve, siç është Hoxha Hasan Tahsini.

Për mbi gjysëm shekulli ai ka qënë mësues, profesor i psikologjisë dhe ka ligjëruar në Uni-versitetet e Shkodrës, Tiranës, Prishtinës, Tetovës etj. brënda e jashtë Shqipërisë dhe është bërë një autoritet i kësaj fushe krahas akademikëve Bedri Dedja, Hamit Beqja, Pajazit Nushi etj.

Profesor Nuriu ka meritën se”ka zbuluar” dhe një sërë personalitetesh “të reja”, që vlejnë si për historinë e mendimit psikologjik shqiptar ashtu edhe atë filozofik shqiptar si Gabriele Bukola, Branko Merxhani, Isuf Agjah Korça etj.

Siç e ka përcaktuar akademiku i dëgjuar Bedri Dedja, duke dhënë thelbin e tij”Profesor Doktor Nuri Abdiu do të mbetet një “Kalorës i Psikologjisë”, ku ai gjatë gjithë jetës përqëndroi forcat e veta si më-sues i devotshëm e shkencëtar i shquar.

Respekt e nderim për njerëz e personalitete të tilla kaq të shquar të Kombit tonë e më gjërë! Emri dhe vepra e tyre s’ka mort kurrë!

Përjetime dhe meditime që na japin mësimë të gjithëve

(Vijon nga faqja 18)

Ai është Mësues i Popullit dhe njeriu i nderuar në sytë dhe në mendjen e të gjithë ish-nxënësve të shkollës pedagogjike. Dhe ata janë qindra.

Drejtor Zenel Sula ka qenë dhe është shpirtmadh. Drejtor Zeneli pranoi në shkollën pedagogjike nxënës me probleme të atëhershme biografike, por të shkëlqyer në mësimë. Në libër përmend emra konkretë. Shpirtmadhësinë e tij e kam provuar edhe vetë. Mbjaj mend që isha mërzitur e doja të shkoja në shtëpi, në fshat, në Vleshë për dy ditë. Trokita dhe hyra në drejtori. Drejtoria m’u duk zyrë shumë madhështore: një tavolinë e madhe, abazhur, kolltuqe. Unë shihja për herë të parë kolltuqe e abazhur. Me gjysmë zëri i kërkova leje drejtorit. “Të shkosh”, - më tha me të parën, pa më pyetur për ç’arsye. Për mua ajo leje atëherë ishte shumë më tepër se leje. Dhe shkova. Por u vonova sepse ra borë e madhe. Kur jam kthyer, drejtori nuk më ka thënë asgjë për vonesën.

Libri mban titullin “Përjetime, meditime”. Përjetimet janë të bu-kura. Meditimet janë të mëdha. Janë meditime që na japin mësimë të gjithëve ne. Ato kanë të bëjnë me jetën, me moralin, me dijen, me shoqërinë e me individin. Kësisoj, libri nuk është vetëm për familjen e të afërmit e profesorit, as vetëm për Zerqanin që ai e do aq shumë, as vetëm për krahinën e tij. Është për të gjithë.

Nuk e kisha ditur që profesori ishte dhe është besimtar. Feja dhe shkenca, - citon autori, - mund të na japin tablo që plotësojnë njëra-tjetrën. Është ideale që këto tablo të mbijetojnë në trurin e njerëzve të dijes dhe të mendimtarëve të shekullit XXI. Dhe: “Asnjë

filozofi, - citon autori Dostojevskin, - nuk ka mundur t’ua kalojë mësimëve të fesë për edukimin moral të njeriut”. Janë citime aq mbushamendëse. Profesori flet shumë për kërkesat shpirtërore të njeriut. I lumtur je kur ke harmoni me vetveten dhe me të afërmit, - thotë profesori. Në fillim mund veteten, pastaj armikun, - citon autori. Dhe më tej: Fati ynë varet nga vlerat tona morale. Normat morale i kanë rrënjët në fjalët e Zotit. Sa më poshtë të jetë morali, aq më të përhapura do të jenë idetë e këqija. Që të shpëtojmë nga të këqijat, duhet të bashkojmë të drejtat e liritë me vlerat morale tradicionale, ashtu siç i paraqesin fetë dhe vetëdija e popullit. Dostojevski dhe Niçe, - citon autori, - kanë thënë: “Lejueshmëria e gjithçkaje të çon në mohimin e Zotit dhe kjo do të thotë se ka vdekur morali”. Janë mësimë të vyera për gjithkënd.

Një enciklopedist si profesor Zenel Sula, domosdo do të dijë të citojë libra të mëdhenj dhe njerëz të mëdhenj. Ai citon shpesh nga Kur’ani. Kur tregon se si kishte mundur të gjente e të lexonte “Një mijë e një netët”, citon Shekspirin e madh për vlerën e tyre: “Para tyre, talenti im nuk mjafton as për dymbëdhjetë net”. Citimi për diturinë është një fjalë e urtë persiane: “Dituria është një taxh i artë; po e vure në kokë, mund të shkosh ku të duash”. Ja edhe Dostojevski: “Djalli lufton kundër Zotit. Fusha të betejës janë zemrat e njerëzve”. Citohen edhe shumë të tjerë: Francis Kolins, Angela Merkel etj.

Në libër shihet kultura e lartë gjuhësore e autorit. Por edhe kultura gjuhësore e zerqanasve në bisedat e bendet e tyre. Po. Ata kanë edhe bende shumë të holla; kanë edhe humor shumë të hollë. Edhe si egërshanë të duken nga ato që tregon profesor Zeneli.

Unë kam pasur rastin të kisha drejtor shkolle njeriun tjetër të

ditur të Zerqanit – Selim Alliun. Dhe jam munduar të mësoj shumë nga këta dy të ditur – nga profesor Zeneli e nga drejtor Selimi. Kam përsëri rastin të them që në shkrimet për Mësuesin e Popullit, Selim Alliun, (libër i Sami Shehut), shkrimi i profesor Zenel Sulës ishte i spikatur.

Një kapitull më vete në libër është: “Për vete e për familjen”. Por profesori nuk vetëlavdërohet. Mjaftohet vetëm me: “Them se kam qenë nxënës i kompletuar (shih përdorimin e fjalës *them*). Në vitin 1976 u transferova në Tiranë, punova shumë vite në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës”. E transferuan me pa të drejtë nga Tirana në fshatin Kurdari të Matit. Por profesori nuk bën asnjë koment për këtë, kur mund të bënte, madje, shumë. Sepse është në dinjitetin e tij dhe në fisnikërinë e tij që të mos merret me të tjerët. Për të është i mjaftueshëm citimi nga një filozof i shquar: “E kaluara e njeriut i ngjan një trëndafili, i cili është i bukur, por ka edhe gjemba”. Në këtë kapitull autori flet për familjen, për fëmijët, për nipat e për mbesën e shumëpritur, së cilës i ka kushtuar një vjershë të bukur.

Siç thotë zonja e tij e nderuar, Sania, profesor Zeneli ka një mal me shkrime nga puna e veprimtaria e tij e madhe në shkollën pedagogjike, në Ministri, në shtëpinë botuese “Naim Frashëri” etj. Me siguri do t’i botojë. Dhe ia duam. I duam.

Unë thashë diçka për librin e profesor Zenelit dhe për profesor Zenelin. Pak kam thënë. Mund të kisha thënë shumë më tepër. Si unë, edhe shumë të tjerë. Dhe ky do të ishte libri për Zenel Sulën. Dhe do të titullohej “Ç’thonë të tjerët për profesor Zenelin”. Sepse njerëzit e mëdhenj nuk flasin për vete, edhe pse flet puna e tyre. Prandaj duhet të flasin të tjerët për ta.



PANAIRI I LIBRIT I AUTOREVE DIBRANE

Botimet M&B në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Peshkopi,
në kuadër të zhvillimit të edicionit të 20-të të Odës Dibrane,
do të organizojnë në Peshkopi në datat 2-5 Tetor 2014,
PANAIRIN E LIBRIT TË AUTORËVE DIBRANË.

Ftohen autorët dhe Shtëpitë Botuese që të marrin
pjesë me botimet e tyre në këtë festival.

Afati maksimal i pranimit
është data 20 shtator.

Autorët që do të sjellin botimet e tyre,
të na dërgojnë me email
një jetëshkrim të shkurtër
deri në 100 fjalë si dhe
botimet me të cilat
dëshirojnë të marrin
pjesë në panair.

Për më shumë informacion:

Tel. (04) 22 33 283

069 20 68 603

068 65 08 441

067 30 73 265

E-mail:

mdbotime@gmail.com

Mbështesin panairin:

Libraria Fleta - Peshkopi

Gazeta Rruga e Arbërit

